

MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR
INSTITUTI PËR MBROJTJEN E NATYRËS DHE MJEDISIT TË KOSOVËS

S T U D I M

***MBI ARSYESHMËRINË E SHPALLJES SË TERRITORIT
TË BJESHKËVE TË NEMUNA
PARK NACIONAL***

Prishtinë, 2003

Studimi mbi arsyeshmërinë e shpalljes së territorit të Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional është punuar në Institutin për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit të Kosovës në Prishtinë. Në hartimin e tij morën pjesë:

- Dr.Sc. Esad Dauti, profesor ordinar në FSHMN, Departamenti i Biologjisë
- Dr. Sc. Esat Hoxha, profesor ordinar në FSHMN, Departamenti i Biologjisë
- Dr. Sc. Ruzhdi Pllana, profesor ordinar në FSHMN, Departamenti i Gjeografisë
- Dr. Sc. Vahdet Pruthi, profesor ordinar në FSHMN, Departamenti i Gjeografisë
- Hysen Shabanaj, ing. i pylltarisë
- Sabit Restelica, ing. i teknologjisë, drejtor në IMNMK
- Mr.sc.Valbona Dabinovci, biolog, koordinatore në IMNMK
- Mr.sc. Elez Krasniqi, biolog, bashkëpunëtor profesional në IMNMK
- Ylber Sherifi, biolog, shef i sektorit për zonat e mbrojtura në IMNMK
- Nazmi Shkodra, jurist në MMPH
- Hamdi Hoti, agronom, bashkëpunëtor profesional në IMNMK
- Qenan Maxhuni, biolog, bashkëpunëtor profesional në IMNMK
- Halime Hajra, gjeologe, bashkëpunëtor profesional në IMNMK
- Adnan Elshani, kimist, bashkëpunëtor profesional në IMNMK
- Riza Hajdari, biolog, bashkëpunëtor profesional në IMNMK
- Tafë Veselaj, biolog, bashkëpunëtor profesional në IMNMK
- Fadil Bajraktari, gjeograf, bashkëpunëtor profesional në IMNMK

PËRMBAJTJA

1. **HYRJE**
2. **PARARENDJA E MBROJTJES**
 - 2.1. Zonat që deri më tash gëzojnë status mbrojtjeje
 - 2.2. Baza juridike
 - 2.3. Kategoritë e Menaxhimit të Zonave Mbrojtura sipas IUCN
 - 2.4. Objektivat
 - 2.5. Kriteret dhe funksionet e Parkut Nacional
 - 2.5.1. Kriteret themelore për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional
 - 2.5.2. Funksionet e Parkut Nacional
3. **POZITA GJEOGRAFIKE DHE MADHËSIA E TERRITORIT**
 - 3.1. Pozita gjeografike
 - 3.2. Madhësia dhe kufijnjtë e territorit të Bjeshkëve të Nemuna
 - 3.3. Popullësia dhe vendbanimet
4. **NATYRA E BJESHKËVE TË NEMUNA**
 - 4.1. Karakteristikat gjeomorfologjike
 - 4.2. Karakteristikat gjeologjike
 - 4.3. Karakteristikat hidrogjeologjike
 - 4.4. Karakteristikat pedologjike
 - 4.5. Veçoritë klimatike
 - 4.6. Veçoritë hidrologjike
- 4.7. **BIODIVERSITETI**
 - 4.7.1. Flora dhe vegjetacioni i Bjeshkëve të Nemuna
 - 4.7.2. Veçoritë Faunistike të Bjeshkëve të Nemuna
5. **TURIZMI**
 - 5.1. Vlerat turistike të Bjeshkëve të Nemuna
 - 5.1.1. Turizmi stacionar
 - 5.1.2. Turizmi vikend- shetitës
 - 5.1.3. Turizmi tranzitor
 - 5.2. Gjuetia dhe peshkataria
 - 5.3. Udhëzime për ruajtjen e turizmit në Bjeshkët e Nemuna
6. **PYJET PYJET DHE SIPËRFAQET PYJORE**
 - 6.1. Resurset pyjore
 - 6.2. Radhitja vertikale e bashkësive pyjore
 - 6.3. Gjendja e tanishme e pyjeve dhe masat e propozuara
7. **Literatura**

1. HYRJE

Shekulli që po e lëmë pas, ka përjetuar ndryshime të konsiderueshme, për sa i përket rritjes së ndikimit të njeriut në mjedisin jetësor, si rrjedhojë e ritmeve të larta të rritjes së popullsisë në shkallë botërore dhe revolucionit tekniko- shkencor. Zhvillimi i hovshëm i industrisë dhe i ekonomisë botërore, pati edhe rrjedhoja negative në natyrë ku vlen të përmenden: ngrohja globale, hollimi i shtresës së ozonit, vdekja e pyjeve, zhdukja e llojeve etj. Këto bëjnë që të prishet baraspesha ekologjike e planetit duke dëmtuar funksionimin normal të tij.

Mbrojtja e vlerave burimore dhe e vlerave më pak të ndryshuara natyrore bëhet nëpërmes të shpalljes së tyre zona të mbrojtura dhe të kategorizuara sipas rëndësisë së këtyre vlerave. Sipas IUCN(*Unionit botëror për konservimin e natyrës*) ekzistojnë gjashtë kategori të menaxhimit të Zonave të Mbrojtura. Parqet Nacionale bëjnë pjesë në kategorinë e dytë dhe përgjithësisht janë zona të gjera që ruhen dhe menaxhohen për mbajtjen e ekosistemeve, edukim dhe rekreacion (shlodhje, argëtim).

Territori i Bjeshkëve të Nemuna i plotëson të gjitha kriteriumet e rëndësishme për shpalljen e tij Park Nacional. Këto janë para se gjithash: hapësira e territorit, format dhe dukurit, viset natyrore burimore dhe të ruajtura, vlera të posaqme estetike peizazhore, mundësitë për punë shkencore- hulumtuese, vlerat kulturore, arsimore, edukative dhe posaqërisht mundësitë e mëdha natyrore për zhvillimin e aktiviteteve rekreative e turistike.

Përmbajtjet e posaqme të këtij territori i përbëjnë format morfologjike, bjeshkët e larta , luginat, grykat kanjonike , akullnajat, me lumenjtë si Bistrica e Pejes, Deçanit, Ereniku, Shushica, Drini i Bardhë me ujvara, shpellat si ajo e Radavcit , liqej si dhe botë të pasur e të shumëllojshme bimore dhe shtazore.

Tërë kjo begati natyrore i dallon Bjeshkët e Nemuna për kah bukuria, karakteristikat e veta dhe vlerat specifike natyrore dhe si i tillë duhet të jetë nën përkujdesje dhe mbrojtje të posaqme.

Në këtë studim prezentohen aspekte preliminare të arsyeshmërisë së shpalljes së Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional, ndërsa që do të vazhdojnë aktivitetet për përfshirjen e hollësishme në identifikimin e vlerave të përgjithshme të këtij territori.

2. PARARENDJA E MBROJTJES

2.1. Zonat që deri më tash gëzojnë status mbrojtjeje

Deri më tani disa zona dhe objekte natyrore në territorin e Bjeshkëve të Nemuna gëzojnë status mbrojtjeje. Ato janë të mbrojtura sipas ligjit për mbrojtjen e natyres („GZK“ nr. 44/76) dhe ligjit për mbrojtjen dhe zhvillimin e vlerave natyrore dhe vlerave të krijuara me pune të ambientit të njeriut („GZK“ nr. 39/88). Konform këtyre ligjeve zonat dhe objektet natyrore janë të kategorizuara dhe të mbrojtura si: rezervate strikte të natyrës, rezervate të natyrës, monumente të natyrës dhe parqe memoriale. Përveq zonave dhe objekteve natyrore të mbrojtura (Tab.1.), ekzistojnë edhe një numër i konsideruar i zonave dhe objekteve të propozuara për mbrojtje, numri i të cilave përditë e më shumë po rritet.

Tab.1. Zonat dhe objektet e mbrojtura deri më tani në territorin e Bjeshkëve të Nemuna

Zona/ objekti	Sipërfaqja në ha	Viti i vënies nën mbrojtje	Rëndësia e mbrojtjes	kategoria
Maja e Ropsit	25	1955 nr.277/55	Rëndësi botanike me llojet e ruajtur të molikës, bredhit, pishës dhe ahut	Rezervat bimor Ia
Kozhnjari	161	1955 nr. 337/58	Rendësi faunistike, rezervat ku jeton dhia e egër (<i>Rupicapra rupicapra L.</i>)	Rezervat shtazor Ia
Malet e Prilepit	0.92	1963 nr. 05-6/9/63	Rëndësi botanike,përbërje e paster e panjës malore (<i>Acer heildreichii</i>)	Rezervat bimor Ia
Gubavci	38	1959	Rëndësi botanike, jeton lloji endemo-relikt boshtra (<i>Forsythia europeae</i>)	Rezervat bimor Ia
Gryka e Rugovës	4301	1988	Rëndësi gjologjike, hidrologjike, pejsazhore, speleologjike, botanike	Monument natyre III
Burimi i Drinit të Bardhë dhe shpella e Radavcit	89.94	1983, GZK 2/83	Rëndësi hidrologjike, gjeologjike, speleologjike, pejsazhore,	Monument natyre III

2.2. Baza juridike

Baza juridike për shpalljen e Bjeshtëve të Nemuna Park Nacional qëndron në Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit e konfirmuar me rregulloren 2003/9, ku thuhet: “ Zonat me vlera të veçanta natyrore, që janë me interes ndërkombëtar, kombëtar, regjional dhe komunal për Kosovën, gëzojnë mbrojtje të veçantë me ligj” (*Neni 33 pika 1 e kapitullit IV*).

Ndërsa mbrojtja dhe ruajtja e tërësishme e natyrës, shfrytëzimi i qëndrueshëm i vlerave natyrore, kategorizimi i zonave me vlera të veçanta sipas Konventave relevante të ndërkombëtare, procedurat e vënies nën mbrojtje, mbrojtja e llojeve të rralla dhe të rrezikuara të florës dhe faunës, regjimi i mbrojtjes sipas shkallës së kategorizimit, mënyra e menagjimit të tyre, pjesëmarrja e publikut në vendimarrje mbi natyrën si dhe mbikëqyrja profesionale e zonave me vlera të veçanta të natyrës, rregullohen me ligj të veçantë (*Neni 33 pika 2 e kapitullit IV*).

Masat për ruajtjen e diversitetit biologjik në Kosovë të cilat implementohen nga Instituti për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit të Kosovës në kuadër të AKMM (*Agjencia e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit*) përshkruhen në *nenin 34 pika 1 kapitulli IV*.

Funksionet për mbrojtjen ndaj diversitetit biologjik nga ana e Institutit për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit të Kosovës në kuadër të AKMM, përfshihen pa kufizim (*neni 34 pika 2 e kapitullit IV*).

Po ashtu dispozitat nga “Ligji mbi mbrojtjen e vlerave natyrore dhe vlerave të krijuara me punë të ambientit të njeriut” (“GZK” 39/88), janë në fuqi deri në aprovimin e ligjit të ri për mbrojtjen e natyrës. Sipas këtij ligji Parku Nacional është “ rajon me vlera të ruajtura natyrore, të krijuara dhe estetike të cilat kanë rëndësi kulturore- arsimore, shkencore, estetike dhe turistiko- rekreative”.

Në Parkun Nacional mund të lejohen vetëm veprimtaritë me të cilat nuk rrezikohet burimi i botës bimore dhe shtazore, vlerat hidrografike, gjeomorfologjike, gjeologjike, kulturore si dhe vlerat e peizazhit të Parkut Nacional si dhe veprimet me të cilat mirëmbahet ose vendoset ekuilibri natyror. Veprimtaritë ekonomike dhe veprimtaritë tjera në territorin e Parkut Nacional duhet të ushtrohen vetëm në pajtim me planet dhe programet e Parkut Nacional.

Mënyra e mbrojtjes, rregullimit dhe shfrytëzimit të Parkut Nacional rregullohet me planin hapësinor të Parkut Nacional të cilin e nxjerr Kuvendi i Kosovës. Me këtë plan përcaktohet rezhimi mbrojtës dhe zonat e mbrojtjes.

2.3. Kategoritë e Menaxhimit të Zonave të Mbrojtura sipas IUCN*

I	<i>Rezervë Strikte Natyrore / Rezervat shkencor</i>	Përgjithësisht janë zona të vogla pak ose aspak të shqetësuara nga njeriu që ruhen dhe menaxhohen për qëllime shkencore dhe mbrojtjen e botës së gjallë.
II	<i>Park Kombëtar</i>	Përgjithësisht janë zona të gjera që ruhen dhe menaxhohen për mbajtjen e ekosistemeve, edukim dhe rekreacion (shlodhje, argëtim).
III	<i>Monument Natyre</i>	Zonë me përmasa të vogla që mbrohet e menaxhohet për ruajtjen e karakteristikave dhe dukurive të veçanta natyrore ose historike.
IV	<i>Zonë e Menaxhimit të Habitatave dhe Llojeve / Reservat Natyror i Menaxhuar</i>	Zonë e mbrojtur për ruajtjen e llojeve dhe habitateve përmes një menaxhimi të përshtatshëm.
V	<i>Pejsazhe tokësore dhe detare të mbrojtura</i>	Zonë e mbrojtur dhe e menaxhuar kryesisht për mbrojtjen e pejsazheve dhe rekreacion (shlodhje, argëtim). Kjo kategori përfshin pjesë toke/ deti në pronësi në pronësi publike ose private dhe qendra banimi, Brenda të cilave zhvillohen aktivitete, si bujqësia, pemtaria, pylltaria, peshkimi etj. Qëllimi është që të ruhet cilësia e pejsazheve dhe bashkveprimi harmonik i aktivitetit të njeriut në to, si dhe diversiteti biologjik që ato përmbajnë.
VI	<i>Zonë e mbrojtur e Resurseve të Menaxhuar/ Rezervë e Resurseve</i>	Zonë e mbrojtur dhe e menaxhuar për një përdorim të qëndrueshëm të resurseve natyrore

* IUCN- Unioni Ndërkombëtar për Konservimin e Natyrës

2.4. Objektivat

Territori i Bjeshkëve të Nemuna i propozuar për Park Nacional karakterizohet me vlera specifike të larta natyrore dhe si i tillë meriton një kujdes të posaçëm. Qëllimet e synuara nga shpallja e Parkut Nacional janë:

- Shfrytëzimi i qëndrueshëm dhe mbrojtja e hapësirës pyjore, florës, faunës dhe të gjitha vlerave të tjera, si dhe marrjen e masave për sanimin e ekosistemeve labile,
- Ndërtimin e planifikuar dhe rregullimin e hapësirës për përgatitjen e vendbanimeve dhe lokaliteteve turistike dhe të uikend zonave,
- Marrja e masave të planifikuara hapësinore dhe të tjerave për diferencimin funksional hapësinor të vendbanimeve të cilat mund të kenë ndikim në territorin e Parkut Nacional,
- Shfrytëzimi racional i vlerave natyrore, hapësirës dhe eliminimi i pasojave të dëmshme,
- Shfrytëzimi racional dhe sipas destinimit të sipërfaqeve bujqësore, tokave pyjore, të pyjeve, kullosave dhe pasurive të tjera natyrore në atë territor,
- Mundësimi i punëve shkencore, arsimore, kulturore, edukative dhe punëve të tjera profesionale në pajtim me konceptet bashkëkohore në zhvillimin e Parkut Nacional,
- Zhvillimi i sistemit unik të trafikut dhe lidhmëria e tij me sistemin e trafikut të Kosovës,
- Përgatitja e hapësirës me sistemin përkatës komunal dhe infrastrukturës tjetër varësisht nga shfrytëzimi funksional dhe nevojat e lokaliteteve,
- Realizimi i qëllimeve të përgjithshme të zhvillimit ekonomik dhe social,
- Përcaktimi i statusit mbrojtës të tërë territorit të Parkut Nacional dhe rregullimi i rezhimeve mbrojtëse përbrenda Parkut Nacional,
- Përputhja e vlerave funksionale dhe aktiviteteve të Parkut Nacional me konceptet zhvillimore të Komunave dhe të tërë Kosovës.

2.5. Kriteret dhe funksionet e Parkut Nacional

Për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna park nacional është me rëndësi caktimi i kriterëve dhe funksioneve përkatëse. Sipas ligjit mbi mbrojtjen e natyrës parqet nacionale bëjnë pjesë në hapësira me vlera të posaqme natyrore të cilat duhet mbrojtur, rregulluar dhe shfrytëzuar racionalisht.

2.5.1. Kriteret themelore për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional

- Territori i propozuar për Park Nacional shtrihet në sipërfaqen prej 50 000 (62 000) ha dhe përbën një tërësi natyrore hapsinore.
- Në territorin e propozuar për Park Nacional egkzistojnë disa zona burimore natyrore të ruajtura dhe vlera të tjera siq: Gryka e Rugovës, burimi i Drinit të Bardhë dhe shpella e Radavcit, rezervati i forzicies në majën e Gubavcit etj. Me shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional këto hapsira ndërlidhen në një tërësi natyrore.
- Bukuritë specifike natyrore dhe vlerat e këtij territori, posaqërisht të Grykës së Rugovës ,zënë vend të rëndësishëm në vlersimet komperative të vlerave të pejsazhit,atraktivitetit të viseve natyrore specifike.Kjo i jep këtij territori vlera të jashtzakonshme estetike dhe prjetime më teper se cili do territor tjrter në vend.Në të vertet vlera e tillë e këtij territori,e në radh të parë e Grykës së Rugovës në kanijonin e Bistricës së Pejës, në kushtet e Parkut Nacional dhe me realizimin e kushteve tjera do të krijonte mundësi të jashtzakonshme par vizita masovike të Parkut Nacional,e posaqërisht per turistet tranzitor mandej per ekskurzionet e vizitat e shumta të nxënësve e studentëve.
- Territori i propozuar në masen më të mirë plotson edhe kriteriumin i cili kërkohet që Parku Nacional të ket rol të rëndësishëm shkencor, kulturor dhe edukativ. Tiparet e shumta natyrore burimore, deri më tani nuk janë hulumtuar në masë të duhur nga aspekti shkencorë. Parku Nacional duhet të krijoj kushte per punë të mëtejme shkencore-hulumtuese. Rolin kulturor të Parkut Nacional, duhet ta perjeton çdo vizitor me të hyrë në Parkun Nacional, gjë që do të ndikon me kultivimin e traditave kulturore të këtij territori, posaqërisht komuniteti lokal të cilat mbesin në kuadër të Parkut Nacional. Po ashtu edhe roli edukativ i Parkut Nacional Bjeshkët e Nemuna mund të zhvillohen dhe kultivohen nepërmjet organizimit të ligjeratave mbi

karakteristikat dhe vlerat si të Parkut Nacional ashtu edhe të territoreve të gjëra për Kosovën si tërësi.

- Njëri prej kriteriumeve më të rëndësishme për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional është vlera turistike, rekreative e territorit. Të gjitha studimet dhe projektet e gjertanishme tregojnë se ky territor ka kushte të jashtëzakonshme për zhvillimin e formave të shumta të aktiviteteve turistike, rekreative në stinën e dimrit ashtu edhe në të verës. Kushtet natyrore dhe pozita gjeoqarkulluese të këtij territori japin mundësi të jashtëzakonshme për zhvillimin e të tri formave themelore të turizmit: turizmit stacionar (dimror, veror), tranzitor dhe uikend-shetitës, duke marrë parasysh klimën e pershtatshme në lartësinë e cila iu përgjegjet kushteve për këtë lloj turizmi. Kushtet natyrore siq janë konfiguracioni i terrenit, denivelimi i terrenit për shtigje të skitarisë, mbulesa e bores, kualiteti i bores dhe gjatësia e mbajtjes së saj, etj, bëjnë të mundur në shumë lokalitete zhvillimin e qendrave sportive dimërore. Për disa lokalitete është bërë valorizimi i terrenit dhe janë përcaktuar mundësitë potenciale të zhvillimit. Turizmi stacionar veror (pushimi shëndetësor, gjuetia etj) mund të zhvillohen në objekte të posaqme por në radhë të parë do të shfrytëzohen objektet e destinuara për turizmin dimëror. Turizmi vikend-shetitës deri më tani nuk ka qenë në masë të duhur. Shkas për këtë është para së gjithash mungesa e përmbajtjeve dhe përgaditjeve përkatëse të lokaliteteve për këtë lloj rekreacioni. Me ndërtimin e qendrave dimërore sportive dhe me rregullimin e lokaliteteve të posaqme për këtë lloj forme të turizmit do të mundësohen vizita masovike dhe interesimi shumë më i madh për qëndrimin ditë në natyrë.

2.5.2. Funkzionet e Parkut Nacional

Mbrojtja e Mjedisit

Territori i propozuar për Park Nacional vise të tëra të begatshme me vlera të shumta estetike. Ky funksion përfshin ruajtjen e ekosistemeve më markante të zonës si dhe rariteteve të natyrës. Mbrojtja e tyre nuk nënkupton ndalimin e shfrytëzimit të vlerave natyrore por që shfrytëzimi të bëhet në pajtim me konceptet e zhvillimit të qëndrueshëm të zonës. Si bazë për përcaktimin e zonave sipas shkallës mbrojtëse janë: vlerat ekologjike, gjeomorfologjike, biodiversiteti, vlerat e peizazheve natyrore, vlerat kulturore dhe ndërtimore si dhe karakteristikat hapësinore e funksionale.

Turizmi

Territori i propozuar për Park Nacional posedon me kushte të jashtëzakonshme të zhvillimit të aktiviteteve turistike- rekreative e posaqërisht për sporte dimërore por edhe për pushim dhe rekreacion të qytetarëve gjatë tërë vitit. Motivet kryesore të zhvillimit janë para se gjithash mundësia e zhvillimit të turizmit stacionar dimëror veqanërisht të disiplinave të ndryshme të skitarisë. Kushtet e volitshme klimatike, lartësia dhe koha e mbajtjes së mbulesës së borës bëjnë të mundur zhvillimin e periudhës mjaftë të gjatë të shfrytëzimit të terreneve për skijim.

Mirëpo edhe për zhvillimin e turizmit veror (si pushimi dhe rekreacioni, ekskursionet, vikend turizmi) ka kushte të mira. Kësaj duhet shtuar edhe mundësitë e shumta për shvillimin e gjuetisë dhe peshkatarisë.

Funksioni kulturor

Bukuritë natyrore dhe raritetet, veshja karakteristike, doket dhe zakonet, vallja e afirmuar e Rugovës e njohur edhe në botë paraqesin përjetim të jashtëzakonshëm kulturor për çdo vizitor. Ka një numër të madh të objekteve të vjetra të kultit si dhe monumente me rëndësi historike nga luftrat çlirimtare të popullatës autoktone.

Funksioni shkencor

Territori i propozuar për Park Nacional ka tipare të shumta burimore të ruajtura që paraqesin objekte mjaftë interesante për hulumtime shkencore dhe për njohjen e ligjshmërive të zhvillimit të natyrës. Këtu para se gjithash vlen për llojet endemike, relikte dhe endemo-relikte të florës dhe të faunës. Po ashtu në zonën e Bjeshkëve të Nemuna janë evidentuar lloje të arnenit *Pinus heildreichi* me dimensione jashtë normales së tyre si dhe vjetërsi deri në 1000 vjet. Këto paraqesin fakte të konsiderueshme për aspektin shkencor të mbrojtjes.

Funksioni edukativ

Bjeshkët e Nemuna paraqesin vend mjaftë të përshtatshëm për aktivitetet konkretizuese edukative. Pasuria me lloje autoktone, endemike dhe endemorelikte të florës dhe të faunës , si dhe historia e bujshme e kësaj ane mund të jenë kontribut i rëndësishëm në procesin edukativ të rinisë shkollore dhe pjesës së re të popullatës.

Kultivimi dhe shfrytëzimi i qëndrueshëm i pyjeve dhe kullotave

Pyjet dhe kullotat zënë mbi 80 % të sipërfaqes së propozuar për Park Nacional e që paraqesin një potencial të madh. Shumica e pyjeve ka funksion për prodhimtarinë e masës drunore por edhe mbrojtës. Parku Nacional do të kontribuojë ekonomizimit por edhe eksploatimit racional të pyjeve të bazuar në bazat ekonomike pyjore. Kufizimi rigoroz i eksploatimit të pyjeve do të koncentrohet në rezervatet strikte të natyrës të cilat zënë një sipërfaqe të dukshme të territorit.

Territori i propozuar karakterizohet me kullosa të pasura që prej kohësh që prej kohësh shfrytëzohen për kullotjen e bagëtisë sidomos gjatë periudhës verore. Të njohura dhe të numërta janë tëbanet e Rugovës.

Funksioni i shfrytëzimit të tokës bujqësore

Toka bujqësore ne territorin e parkut nacional ka rendësi të madhe për mbajtjen e vendbanimeve dhe popullsisë në këtë hapsirë. Tokat bujqësore mundë të shfrytëzohin veqanërisht në prodhimet eko-bujqësore.

Zhvillimi i qëndrueshëm i vendbanimeve dhe popullsia

Vendbanimet dhe popullsia kanë rol të madh në zhvillimin e Parkut Nacional Bjeshkët e Nemuna. Është e rëndësishme që në Parkun Nacional të rregullohen vendbanimet dhe të përmirësohen kushtet e jetesës së popullsisë në bazë të zhvillimit të qëndrueshëm të Parkut Nacional. Në fshatra duhet të ngritet infrastruktura rrugore, PTT, ujësjells, kanalizimi, pastrimi i ujërave dhe shpërndarja e rrjetit efektiv elektrik.

3. POZITA GJEOGRAFIKE DHE MADHËSIA E TERRITORIT

3.1. Pozita gjeografike

Bjeshkët e Nemuna paraqesin një zonë malore në pjesën Veri-perëndimore të Kosovës që kanë vazhdimësi në pjesën veriore të Shqipërisë dhe Jug-Lindje të Malit të Zi.

Bjeshket e Nemuna në pjesën periferike Perëndimore të Kosovës zbresin gati vertikalisht në Rrafshit të Dukagjinit. Duke u ngritur vertikalisht nga Rrafshi i Dukagjinit, masivi i madh i Bjeshkëve të Nemuna ofrojnë pamje madhështore dhe paraqesin potencial të madh turistik.

Bjeshket e Nemuna në Kosovë kanë një shtrirje në drejtim veri-jug me gjatësinë afro 50 km, ndërsa gjerësia e tyre nuk e kalon 26 km.

Bjeshkët e nemuna prehen nga luginat e thella e tërthore, shpesh në formë kanjonike të Bistricës (Lumbardhit) të Pejës, Deçanit, Erenikut.

Masivi malor i Bjeshkëve të Nemuna ndahet në tri pjesë:

Pjesën veriore e përbëjnë malet që ndodhen në veri dhe verilindje të Bistricës (Lumbardhit) të Pejës, e cila butësisht fillon në Malin e Thatë mbi Fushëgropën e Dukagjinit dhe Moknën. Prej Moknës, ky brez malor shmanget në drejtim të jugperëndimit dhe shkon deri te Maja e Re (1812m), e nga këtu zgjatet në përdim dhe vazhdon përmes Majes Pogled (Shiqimi, 2155m) në Zhleb me Majen e Rusolisë (2381m). Këtij grupi malesh, më tutje në përdim i takojnë edhe Shtedimi (2272 m), Lajla (2400 m), Mali i Shishkës, me Majën e Hasanit (1871 m), Mali i Begut me Majën e Velekutit (2015) dhe Pokleni (1376).

Pjesën Qendrore e përbëjnë malet ndërmjet Bistricës (Lumbardhit) të Pejës dhe Deçanit: Koprivniku me Krshin e Çvrlenit (2460m), Bjeshkët e Strelcit me Majën e Strelcit (2377m), Qafa e Nekut dhe Mylishevcit. Më në përdim, kësaj pjese i takojnë Malet e Lumbardhit me Majen Guri i Kuq (2522 m), Malet e Nexhinatit (2341) dhe Staraci (Plaku, 2426 m).

Pjesa jugore shtrihet në jugpërdim të Bistricës së Deçanit dhe përbëhet nga Malet e Deçanit, Malet e Vokshit (1641), Bjeshka e Junikut me Majën Rrasa e Zogut (2296), Gjeravica (2656 m), Bogiçevica (2103m), Maja e Ropës (2505m), Maja e Qenit (2406m) dhe Marjashi (2530m).



Bjeshkët e Nemuna me lartësinë, strukturën e relievit, ndërtimin gjeologjik, elementet klimatike dhe botën organike na perkujtojnë Alpet.

Bjeshkët e Nemuna dallohen me një numër të madh të majave të larta mbi 2000m, dhe majen absolute më të lartë të Kosovës Gjeravica (2.656m). Morfologjia e Bjeshkëve të Nemuna cilësohet me shpate të thepisura, me lugina të thella, me gryka të ngushta dhe me pragje të shumta, që paraqesin bukuri të rralla natyrore jo vetëm në Kosovë por edhe në Evropë.

3.2. Madhësia dhe kufinjtë e territorit të Bjeshkëve të Nemuna

Sipërfaqja e propozuar për Park Nacional të Bjeshkëve të Nemuna është 62.488.00 ha dhe paraqet 5.7 % të sipërfaqës së Kosovës. Territori i Parkut Nacional shtrihet në 4 Komuna: Pejë me 32.500 ha, Deqan 22.000 ha, Istog 5065 ha, dhe Gjakovë 2833 ha.

Fig.1 . Sipërfaqja në ha. e Parkut Nacional Bjeshkët e Nemuna sipas Komunave



Në pjesën jugore të Bjeshkëve të Nemuna kufiri i propozuar për Park Nacional fillonë nga vend i qujtur Kamenicë e cila gjendet në territorin e Shqipërisë në afërsi të qafës së Morinës (1.85 km). Pastaj kalon në drejtim veri-lindje në afërsi të burimev të përrockave të Mulliqit në pjesen te qujtur Shkoza duke përcjell izohipsen ndermjet 600 deri 700 m, deri në pjesën ndërmjet fshatit Mulliq dhe Batushë duke filluar të kthehet nga veri-perëndimi, dhe përcjellë izohisen 600 dhe 700 m të lartsisë mbidetare deri në mes fshatit Batush dhe Koshar.

Kufiri vazhdon në drejtim të veri-lindjës deri në afërsi të fshatit Gjocaj në izohipsen 680 dhe 700 m, pastaj vazhdon në mes izohipseve 600 dhe 700 m, në perëndim të fshatit Junik dhe Vokshë në vendin e qujtur Shkoza. Kufiri vazhdon në veri të fshatit Vokshë në izohipsen 650 m, pastaj vazhdon në drejtim të fshatit Pobërgj në afërsi të vendit të qujtur Variq në izohipsen 730 m. Pastaj vazhdon në veri në mes fshatit Pobërgjë dhe Hulaj, dhe shkojë në drejtim të veriut deri mbi Patralkanen e Deqanit përkatsishtë në afërsi të shtratit të Bisticës së Deqanit në izohipsen 680 m. Pastaj kufiri fillonë të shkojë në drejtim verilindje dhe vazhdon deri ne përroi e Bahovce në afërsi të vendit të qujtur Kodra e Qavza në izohipsen 700 m lartësi mbidetare. Kufiri vazhdonë në veri–lindje duke përcjellë izohipsen 700 m deri në Gryken e Strellcit, pastaj vazhdon në veri në mesë izohipses 600 dhe 700 m, përkatsishtë në pjesen perëndimore të fshatit Lubeniq afër kodresë të qujtur Ridenicë e deri të Kroni i Lubeniqit. Kufiri pastaj vazhdon në veri deri të vend i qujtur Otrzi ku gjendet kufiri në mes të fshatit Lubeniq dhe Zagër, kufiri vazhdon në veri–perëndim duke përcjellë izohipsen 600 dhe 700 m, mbi fshatin Bellopojë të (panda). Pastaj kufiri fillonë në drejtimin veri–perëndim të fshati Zatra dhe në pjesen e poshtme të Kodrës të qujturë Gubovc dhe vazhdonë nga veri-perëndimi deri në Lumin e Bisticë ne Grykë të Pejës, afër vendit të ujësjellsit së Pejës, duke përcjellë izohipsen 550 dhe 600 m. Kufiri vazhdon në drejtimin ver-lindje, në pjesen perëndimore të fshatit Lëvoshë përkatsishtë duke përcjellë izohipsen në mesë 700 dhe 800 m, të lartsisë mbidetare, duke u lëshuar në pjesen e poshtme të kodrës së quajtur Maja e Zezë, deri të Lumi i Shushicë në pjesen perëndimore të fshatit Brestovik përkatsishtë të penda e cila është ngritur për pengimin e erozionit në Lumin Shushicë, dhe fillon ngritja e theksuar e masivit malorë, në afërsi të gurthyësit Gretamarketë, në izohipsen 650 dhe 700 m. Kufiri pastaj vazhdon në perëndim të fshatit Sigë dhe Novosellë në vëndin e qujtur Qarrishtë në izohipsen 700 dhe 750 m. Kufiri pastaj fillon të shkojë në drejtimin veri-perëndim në afërsi të lagjës Burunt dhe vazhdon në perëndim të fshatit Radavcë (në afërsi të Burimit të Drinit të Bardhë) në izohipsen 550 dhe 600 m. Pastaj vazhdon në drejtim veri-perëndimore mbi fshatin Jabllanicë e Madhe afër staneve të vendi i qujtur Fjershta në izohipsen 900 m, pastaj kufiri fillon të kthehet në verilindje duke përcjellë izohipsen në mesë 800 dhe 900 m, në pjesen e qujtur Gllavicë në drejtim të Jabllanicës së Vogël në afërsi të vendit i qujtur Kroni i Doqit (ne të majtë gjindet Lugu i Shpellës) .

Nga Krojë i Doqit kufiri fillon të kthehet në drejtim të lindjës deri në pjesen veriore të fshatit Kaliqan në afërsi të Lagjes së Cakutajve në vendin e qujtur Kërshi i Sokolit në izohipsen 950 m. Kufiri vazhdon të shkojë mbi fshatin Studenicë në vendinë e qujturë Kodra e madhe e Studenicës, në izohipsen 800 dhe 900 m, dhe vazhdonë në drejtimë të Leskovikut dhe shkon deri të vend i qujtur Kërshi i Zi. Kufiri vazhdon në drejtimë të lindjes në pjesen e poshtme të kodres Mlakishtë në izohipsen 650 dhe 700 m dhe shkon në veri mbi vendbanimin Lubozhdë.

Kufiri vazhdon kah veri-lindja deri të përroji i Dragiqit në mes të kodrave Cernovin dhe Caculjan, pastaj kufiri fillon të kthehet në veri, përgjat përronit të Dragiqit e deri në kufirin me Serbinë.

3.3. Popullsia dhe vendbanimet

Në territorin e Bjeshkëve të Nemuna të propozuar për Park Nacional, ekzistojnë një numer i vendbanimev qe perfshihen teresisht ose pjesrisht në kuader të parkut Nacional Bjeshkët e Nemuna.

Popullsia e Parkun Nacional përbehet nga banorët e perhershme komuniteti vendor, të cilet mirren me veprimtari të caktuar si: bujqësi, pylltari, dhe popullësia e përkohshme e cila përkosishtë qendron në Parkë, dhe i shfrytzojnë terrenet sportive, kullotat dhe burimet tjera natyrore.

Në territorin e propozuar për Park Nacionalë Bjeshket e Nemuna hynë gjithësejt 18 fshatra me 4354 banorë (sipas regjistrimit të vitit 1981).

Gryka e Rugovës ka sipërfaqe 197 km², ose 32 % të teritorit së Komunës së Pejës dhe me 2449 banorë. Dendësia mesatare e popullsisë është 13 banorë në Km², (sipas regj. të vitit 1981).

Popullsia e Grykës së Rugovës qe nga viti 1948 e deri në vitin 1971 ka pasur një rritje të vogël në numer, kurse pas vitit 1971 është zvogluar edhe më shumë. Prej vitit 1948 deri në vitin 1971 numri i banorëve është rritur në 163 persona, ndërsa nga vitit 1971 gjerë në vitin 1981 numri i banorëve është zvogluar për 979 banorë, por edhe pas vitit 1981 numri i banorëve është gjithnjë duke u zvogluar.

Migrimet e popullsisë nga ky territor janë pasojë e mos zhillimit ekonomik, sipërfaqja e vogël e tokës bujqësore, mungesa e infrastruktures. Keto kanë ndikuar në migrimin e popullsisë, ku disa fshatra po mbesin pa banorë dhe kryesisht po zbresinë në viset më të ulëta të Kosovës.

Nga mesatarisht 241 banorë për fshat, këto fshatra bejnë pjesë në grupin e fshatrave më të vogla të Kosovës, numri i banorëve lëvizë nga 9 banorë në (Bellej) dhe deri në 1431 banorë (Irzniq II) si fshati më i madhë i Parkut Nacional Bjeshkët e Nemuna (sipas vitit 1981).


Lidhëshmeria administrative e vendbanimeve në Gryken e Rugovës është e ralizuar në dy bashkësi lokale në Drelaj më 7 fshatra dhe në Haxhaj me 6 fshatra.

Në Bjeshkët e Nemuna dominojnë kryesisht, vendbanimet qe i përkasinë tipit të fshatrave të shpërndara. Karakteristikë tjetër e vndbanimeve, është ai i vendbanimeve të përkohshme ose i tabanëve të barinjëve qe kanë karakter sezonalë.

Tab.3. Numri i vendbanimeve dhe i popullsisë që hyjnë në hapësirën e Parkut Nacional Bjesbkët e Nemuna

Nr.	Emri i vendbanimit	Numri i banorve (sipas regj.të vitit 1981)	Komuna
1	Haxhaj	89	Pejë
2	Bogët	167	Pejë
3	Jashanicë	176	Pejë
4	Dugaivë	128	Pejë
5	Koshutanë	247	Pejë
6	Pepiq	159	Pejë
7	Drelajt	259	Pejë
8	Rekë e Aliaagës	329	Pejë
9	Malajt	190	Pejë
10	Shtupeq i Madhë	303	Pejë
11	Llazbollpaq	73	Pejë
12	Shtupeq i Vogel	38	Pejë
13	Lipë	71	Pejë
14	Cerovërhë	220	Pejë
15	Bellej	9	Deqan
16	Gjocaj	215	Deqan
17	Irzniq II	1431	Deqan
18	Koshar	250	Gjakovë

Fig.2. Përqindja e popullsisë në Parkut Nacional Bjesbkët e Nemuna



4. NATYRA E BJESHKËVE TË NEMUNA

4.1. KARAKTERISTIKAT GJEOMORFOLOGJIKE

Bjeshkët e Nemuna paraqesin njërin nga masivet malor më të mëdhenj, më kompleks, më interesant dhe më të bukur të Ballkanit dhe më gjerë.

Bjeshkët e Nemuna kosovare fillojnë në JP të Gjakovës (Shishmani i Bokës-Qerret) dhe vazhdojnë në VL deri afër Mitrovicës. Kufiri lindor i tyre është fushëgropa e Dukagjinit.

Nga luginat tërthore, shpesh me formë kanjonike, të Bisticës (Lumbardhit) të Pejës e Deçanit, pjesa kosovare e masivet malor të Bjeshkve të Nemuna është ndarë në tri pjesë:

Pjesën e parë (veriore) e përbëjnë malet që ndodhën në veri dhe verilindje të Bisticës (Lumbardhit) të Pejës, e cila butësisht fillon në Malin e Thatë mbi Fushëgropën e Dukagjinit dhe Mognën. Prej Mognës, ky brez malor shmanget në drejtim të jugperëndimit dhe shkon deri te Maja e Re (1.812), e nga këtu zgjatet në perëndim dhe vazhdon përmes Majes Pogled (Shiqimi, 2.155m) në Zhleb me Majen e Rusolisë (2.381m). Këtij grupi malesh, më tutje në perëndim i takojnë edhe Shtedimi (2.272 m), Lajla (2.400 m), Mali i Shishkës, me Majën e Hasanit (1.871 m), Mali i Begut me Majën e Velekutit (2.015) dhe Pokleni (1.376).

Pjesën Qendrore e përbëjnë malet ndërmjet Bisticës (Lumbardhit) të Pejës dhe Deçanit: Koprivniku me Kërshin e Çvrlenit (2.460m), Bjeshkët e Strelcit me Majën e Strelcit (2.377m), Qafa e Nekut dhe Mylishevcit. Më në perëndim, kësaj pjese i takojnë Malet (Bjeshkët) e Lumbardhit me Majen Guri i Kuq (2.522 m), Malet e Nexhinatit (2.341) dhe Staraci (Plaku, 2.426 m).

Pjesa e tretë shtrihet në jug dhe jugperëndim të Bisticës së Deçanit dhe e përbëjnë Malet (Bjeshka) e Deçanit, Malet (Bjeshka) e Vokshit (1.641), Bjeshka e Junikut me Majën Rrasa e Zogut (2.296), Gjeravica (2.656 m), Bogiçevica (2.103m), Maja e Ropës (2.505m), Maja e Qenit (2.406m) dhe Marjashi (2.530m).

Malet, luginat, grykat, kanjonët, shpellat etj., janë elementet morfologjike kryesore të cilët përcaktojnë fizionominë e pejsazheve të Bjeshkve të Nemuna..

Në morfologjinë e Bjeshkve të Nemuna janë të sintetizuara gati të gjitha proceset vepruese të faktorëve endogjen dhe ekzogjen, gjatë të kalurës gjeologjike.

Relievin e Bjeshkve të Nemuna, si një kompleks gjeomorfologjik, e karakterizojnë forma të shumta dhe të ndryshme- tektonike, glaciale, fluviale, të nivacionit, karstike dhe të denudacionit. Këto forma, gjenetikisht të ndryshme, shpesh herë kombinohen dhe plotësohen në mes vedi duke i dhënë pejsazhit të Bjeshkve të Nemuna një pamje të veçantë me cirçe, lugina të akullnajave, morena , liqenj glacial etj.) si pasojë e glaciacionit intenziv të pleistocenit.

Pjesët e kompleksit malor të Bjeshkve të Nemuna që përbëhen kryesisht nga shkëmbinj rreshpor dhe magmatik, karakterizohen me një pejsazh më të butë dhe arkitekturë më të qetë të relievit, me shpatije të pjerrta, por në vazhdimsi njera me tjetrën , me komplekse barishtore dhe pyjore si dhe me bollëk të burimeve dhe rrjedhjeve ujore. Te disa nga këto male, disa nga majat e tyre janë shkëmbore dhe pa vegjetacion. . Për nga pasuria dhe llojllojshmëria me elementet estetiko-dekorative (pyjet, kullosat, liqenjtë etj.) dhe me pamjen e mrekullushme nga majat e larta, veçohen së tepërmi Bogiçevica, Gjeravica dhe Koprivniku.

Pjeset e Bjeshkve të Nemuna , të përbëra kryesisht nga shkëmbinjtë karbonatik-gëlqeror, meremere e dollomite (Mokna, Zhlebi etj.), kryesisht janë shkëmbore, të zhveshura ose me vegetacion të dobët dhe pa burime dhe rrjedhje ujore.. Karakterizohen me pejsazhe shumëkontrastore, me forma karstike, me lugina shpesh herë të thelluara e anë shumë të pjerrta dhe me maja të mprehta (thikta).

Bjeshkët e Nemuna janë të disecuar nga një rrjet i lugjeve (luginave, „valovi“) të akullnajave , luginave lumore, cirçeve etj. Gati të gjitha luginat janë të tipit kompozit, me zgjerime erozionale të formuara në shkëmbinjtë rreshpor dhe ngushtica (gryka, kanjone) të thelluara në gëlqeror. Luginat e akullnajave karakterizohen me anë të pjerrta dhe fund të rrafshët.

Formimi i fizionomisë parësore të relievit (paleorelievi) të Bjeshkve të Nemuna është bërë nga proceset tektonike , e cila më vonë është ndryshuar nga procese më të reja tektonike dhe faktor të ndryshëm egzogjen. Nga proceset tektonike rrudhosëse janë formuar malet më të larta të këtij kompleksi. Maja e Gjeravicës e cila paraqet një tepe të një antiklinali, mandej paraqitja e rreshpeve të paleozoikut në nivele të ndryshme hipsometrike dhe e gëlqerorëve në shpatijet e rrëpinjta të Bisticës së Deçanit si dhe të antiklinalit të ndërlikuar të Koprivnikut dhe Maleve të Strelcit, janë fakte që tregojnë për prejardhjen tektonike parësore të këtij kompleksi malor. Edhe pjesë të rrjedhjeve ujore paradeluviale janë paradisponuar nga faktorët tektonik (prishjet tektonike) ose nga kontaktet në mes vedi të shkëmbinjve të ndryshëm. Rast i tillë është ai i Bisticës të Pejës, e cila një pjesë të rrjedhjes së saj e ka thelluar në rreshpet kristalike, në sinklinalin ndërmjet Poklenit dhe Koprivnikut, ndërsa në pjesën e sipërme të Grykës së Rugovës, e ka thellua në kontaktin e gëlqerorve me rreshpet. Edhe disa pjesë të rrjedhjes së Bisticës Deçanit janë paradisponuar nga këta faktor.

Shenja (mbetje) që tregojnë mbi egzistimin e dikurshëm të luginave lumore paradeluviale, pjesërisht të paradisponuara nga faktorët e tektonikës parësore, në të cilat më vonë kanë kaluar akullnajat, vërehen në luginën e Lumit Sushicë, mbi fshatin Brestovik dhe më pastaj takohen edhe në formë të rrafshinave fluviudenudacionale në lartësi të ndryshme në Poklen, Koprivnik dhe Nexhinat (2000-2200), Hajlës (1.700-1.800 m) etj. Shembuj të tillë hasen edhe në luginën e Bisticës të Deçanit.

Fizionomia e neorelievit (relievit të ri) të Bjeshkve të Nemuna është formuar kryesisht nga proceset glaciale, fluviale dhe karstike, nga të cilat janë krijuar numër i shumë i formave të ndryshme glaciale (cirçe, lugina të akullnajave, morena etj), fluviale (lugina lumore, kanjone, gryka, terraca lumore, kone të derdhjes, vorrbulla në shkëmbinjtë e shtratit etj) si dhe karstike (shpella, humnera, hurdha – gropa karstike etj.).

Në Bjeshkët e Nemuna , gjatë pleistocenit, ka egzistuar regjioni më i madh i akullzimit në Ballkan. Në regjionet burimore të lumenjëve paraglacial , gjatë kohës glaciale janë formuar cirçe të mëdha nga të cilat akullnajat kanë lëvizur përgjatë shpatijeve malore. Akullnaja më e madhe ka qenë ajo e tipit luginor në ujëmbledhsin e Bisticës të Pejës, shumë e ndërlikuar dhe e degzuar që ka zbritur deri te Fusha e Pejës, dhe ka pasur një gjatësi prej 25 km.

Në ujëmbledhsin e Bisticës të Pejës egzistojnë cirçet dhe luginat e akullnajave më të bukura. Në kreshtën Maja e Nexhinatit janë formuar dy cirçe në lartësi prej 1900-2000m. I pari është krijuar në gëlqerorët e triasikut dhe karakterizohet me reliev karstik. Anët e cirkut janë shumë të pjerrta, ndërsa fundi është i rrafshët, me pjerrtësi në drejtim të veriut, në të cilën është deponuar material morenik. Cirku vazhdon në luginën e akullnajës, në të cilën është krijuar Liqeni i Kuçishtës, e cila më tutje vazhdon për në veri. Lugina e akullnajës më e bukur e këtij ujëmbledhsi është Lugu i Shkodrës e cila

fillon nga një cirk me kreshta të ulta nga gëlqerorët dhe me fund të thelluar në rreshpe kristalike. Lugu i Shkodrës, përmes tri kaskadave (shkallëve) ka zbritur në drejtim të Bistricës së Pejës.

Në veri të Gurit të Kuq kanë egzistuar tri akullnaja me tri cirçe të renditura në formë gjysmërrethi. Luginat akullnajore të Gurit të Kuq poashtu, përmes kaskadave (shkallëve) kanë zbritur në drejtim të Bistricës të Pejës.

Në Malet e Strelleit janë dy cirçe me luginat e akullnajave. Nën Majën Çavrle (2.360 m) është cirku i cili është i rrethuar nga shkrepat gelqeror të lartë 100-150m. Nga ky cirk, në drejtim të veri-veriperëndimit vazhdon lugina e akullnajes e cila zbret në luginën e lumit të Miloshevcit. Nën Majën e Strelleit (2.377) është dobët i ruajtur një cirk dhe një luginë e akullnajës.

Në regjionin burimor të Bistricës së Deçanit është formuar akullnaja luginore e degëzuar, e dyta për nga madhësia, e gjatë afër 20 km. Në Malet e Decanit janë ruajtur mbetjet nga format relievore glaciale të përfaqsuara nga cirçet dhe lugjet (luginat) e akullnajave. Janë të ruajtur cirçet nën Majën e Gjeravicës, në pjesën përfundimtare. Në të vërtetë këto paraqesin pjesën burimore të Bistricës së Kozhnjerit. Në ujëmbledhsin e Erenikut ka egzistuar akullnaja e gjatë 14 m, ndërsa në ujëmbledhsin e Bistricës së Loçanit akullnaja e gjatë 12 km. Në Rusoli dhe Zhleb është formua akullnaja mbulesore (e platos) e tipit karstik, me shumë gjuhë të akullnajave luginore. Në Mokne e vetmja akullnajë luginore ka egzistuar në Lumin e Zi, ndërsa rreth majeve malore kanë egzistuar cirçet dhe akullnajat e varura.

Format tipike të relievit glacial, të zhvilluara në bazamentin e ndërtuar nga shkëmbinj të karbonatik, në masë të madhe janë modifikuar dhe deformuar, kështu që sot hasen vetëm fragmentet e tyre. Më së shumti dhe më së miri janë ruajtur fragmentet e formave glaciale në pjesët burimore të Bistricës së Deçanit dhe Erenikut .

Objekte me bukuri të lartë dhe më rëndsi si gjeomonumente paraqesin cirçet për rreth Gjeravicës dhe Bistricës së Kozhnjerit, me 10 liqenjë glacial dhe një numer të madhë të bësave (bedemeve) të materialit morenik, blloçet karakteristike të shkëmbinjve si dhe cirku i ndërtuar në bazamentin karbonatik i Nexhinatit, me liqenin e madh dhe të vogël.

Nga veprimtaria e lumenjve paraglacial dhe atyre postglacial, në luginat e akullnajave janë krijuar luginat lumore , zakonisht të tipit kompozit. Këto lugina i kanë krijuar Bistrica (Lumbardhi) i Pejës dhe Deçanit, Lumi i Kozhnjerit, Ereniku etj.. Si lugina me bukuri të rrallë veçohen lugina e Bistricës së Deçanit dhe e Erenikut, ndërsa si bukuri natyrore e veçantë me motive impulsive gjeomorfologjike veçohen Gryka e Rugovës dhe e Sushicës.

Gryka e Rugovës është gryka më e bukur e më atraktive e Kosovës, prej Pejës e deri në Bjelluhë, në gjatësi prej afër 22 km, e thellë dhe me shpate të pjerrta shkëmbore dhe fund (shtratë) të ngushtë. Në pjesën e poshtme ,në gjatësi prej afër 6 km, është e thelluar në shkëmbinjë gelqeror (mbi 1200 m thellësi) në formë të kanjonit tipik, shpate gati vertikale që drejt zbrezin në shtratin e ngushtë të lumit. Burimet ujore karstike në lartësi afër 30 m në shpatet e luginës dhe derdhja e tyre në formë ujëvarash, rrjedhjet e shpejta të ujit si dhe vorbullat (thellimet rrethore në shkëmbinj të shtratit –„kazanat“) ia shtojnë edhe më tepër atraktivitetin Grykës së Rugovës.

Edhe pse në Bjeshkët e Nemuna përhapja e shkëmbinjve karbonatik (gëlqeror, mermere etj), ky regjion nuk është tipik karstik, sepse proceset karstike sipërfaqore nuk janë të zhvilluara intenzivisht, për shkak të lartsive të mëdha dhe relievit të thepisur.

Megjithate, në Bjeshkët e Nemuna janë prezente gati të gjitha format karstike- vorrbullat (hurdat) karstike, lugjet, humnerat dhe shpellat.

Nga format karstike për nga rëndësia veçohet Shpella e Radavcit, me hyrje në lartsi 750 m, nga e cila fillon kanali kryesor i cili degëzohet në kanalet anësore. Në shpellë janë zbuluar galeri, salla, kada, liqenj etj. Pjesa më e madhe e shpellës është e stolisur me draperi dhe stalagmite e stallagmite.

Në Grykën e Rugovës dhe Bisticës të Deçanit egzistojnë shpella dhe zgavrza në anët e thikta të luginës, në ato pjesë të cilat janë të ndërtuara nga shkëmbinjte gëlqeror.

4.2. KARAKTERISTIKAT GJEOLOGJIKE

Bjeshkët e Nemuna karakterizohen me një ndërtim të ndërlikuar gjeologjik. Në ndërtimin gjeologjik të këtij regjioni marrin pjesë shkëmbinjte e ndryshëm magmatik, metamorfik e sedimentar të moshës palezoike, triasike e jurasike si dhe në masë më të vogël edhe sedimentet liqenore neogjenike dhe depozitimet liqenore e kontinentale të kuaternarit.

SHKËMBINJTË E PALEOZOIKUT

Shkëmbinjte e Paleozoikut ndërtojnë kryesisht regjionin e Maleve të Deçanit, Gjeravicës, Kozhnjerit, Majës Ropës dhe rajonet e rrjedhjeve të sipërme të Bisticave (Lumbardheve) të Deçanit, Kozhnjerit dhe Lloçanit, deri te Bjeshkët e Lumbardhit, në veri. Shkëmbinjte e paleozoikut, në masë më të vogël, paraqiten edhe në anën e majtë të Bisticës (Lumbardhit) të Pejës, në regjionin e Shtupelit të Madh dhe Lumit të Allagës.

Shkëmbinjte e paleozoikut që ndërtojnë këtë regjion përfaqsohen nga shkëmbinjte magmatikë bazik të metamorfizuar dhe rreshpeve kristalike me shkallë të ulët të metamorfizimit.

Shkëmbinjte magmatik bazik – gabro dhe diabaze të metamorfizuara ndërtojnë një regjion të vogël të terrenit rreth Gjeravicës dhe paraqesin shkëmbinjte më të vjetër të kompleksit shkëmbor të Paleozoikut.

Metamorfitet e Paleozoikut janë të përfaqësuar nga rreshpet epidot-aktinolite, rreshpet klorit-sericite, filitet, argjilloshistet dhe ranorët, kalkshistet, mermeret dhe gëlqerorët kristalor.

Rreshpet epidot-aktinolite dhe epidot –kloritike (rreshpet e gjelbërta) ndërtojnë rajonin e Majës së Kurvallës dhe Maleve të Deçanit. Përveç epidotit dhe aktinolitit, në përbërjen e tyre marrin pjesë edhe kloriti, karbonatet, plagjioklazi, kuarci etj. Kanë ngjyrë të gjelbërt (jeshile). Janë rreshpor e ngandonjiherë masiv. Përshkohen (ndërpriten) nga damar të bardh kuarci.

Rreshpet klorit-sericitike paraqiten në formë të thjerrzave, ndërshtresave dhe zonave të vogla në kuadër të rreshpeve të gjelbërta. Një zonë e këtyre rreshpeve paraqitet në lindje të rreshpeve të gjelbërta, me shtrirje veri-jug ndërmjet Bisticës (Lumbardhit) të Deçanit dhe Bisticës së Lloçanit,

duke ndërtuar pjesët më lindore të Maleve të Deçanit. Këto rreshpe janë të përbëra nga kuarci, pllagjiokllazi, sericiti, kloriti dhe karbonatet dhe mineraleve aksesori si apatiti, zirkoni etj. Shpesh herë karakterizohen nga një rreshpizim tejet i theksuar dhe janë të katakllazuar. Këto rreshpe janë të vendosura mbi rreshpet e gjelbërta.

Filitet dhe argjilostitet kanë ngjyrë të përhimtë të mbyllët dhe të përhimtë deri në të gjelbërtë Përbëhen nga kuarci, sericiti, kloriti, materia argjillore, apatiti, zirkoni, turmalini etj.

Gëlqerorët kristalor, mermerët dhe kallkshistët paraqiten në nivele të ndryshme të rreshpeve paleozoike të sipërpërmendura, në formë të thjerrave dhe masave të parregullta të ndryshme (Bagdash etj).

Shkëmbinjtë e Paleozoikut, gjegjësisht të devonian –karboniferit, paraqiten edhe në Çakorr, Grykën e Rugovës, Lumin e Allagës dhe Lumin Sushicë. Përfaqsohen nga mermerët dhe kallkshistët, kuarçitet, argjiloshistët dhe ranorët etj.

SHKËMBINJTË E TRIASIKUT

Pjesa më e madhe e terrenit të Bjeshkëve të Nemuna është e ndërtuar nga shkëmbinjtë e moshës triasike (Bjeshkët e Lumbardhit, Gryka e Rugovës, Hajla etj.)

Triasiku është i përfaqësuar nga një kompleks i nduardurshëm dhe i ndërlikuar i shkëmbinjëve sedimentarë, magmatik dhe metamorfik dhe i përbërë nga shkëmbinj të ndryshëm siq janë ranorët, brekçiet, konglomeratet, gëlqerorët, dollomitet, diabazet, gabrot, peridotitet, kuarçkeratofiret, granitet dhe ndonjiherë edhe rreshpet kristalike.

Në depozitimet e triasikut të poshtëm-mesëm të pjesës veriore të Bjeshkëve të Nemuna mbizotrojnë faciet karbonatike, ndërsa në pjesët jugore ato sedimentare-vullkanogjene ndërsa triasiku i sipërm në tërë regjionin është i përfaqësuar nga facia e gëlqerorve dhe dollomiteve. Edhe pse janë dokumentuar me fosile triasiku i poshtëm, i mesëm e i sipërm, veç e veç në Bjeshkët e Nemuna, veçimi i triasikut të poshtëm nga i mesëm shpesh është i pamundur.

Triasiku i poshtëm

Triasiku i poshtëm është i konstatuar, dhe ka qenë i mundur veçimi i tij, në pjesët veriore të Bjeshkëve të Nemuna- në grykën e Rugovës, në Majen e Nexhinatit, Majen e Strellicit, Shtupelin e Madh dhe të Vogël, Bogë, Shkrel etj., dhe është i përfaqësuar nga seria karbonatike-ranore dhe facia e kllastiteteve (konglomeratet kuarcore, brekçiet, ranorët dhe argjilitet)

Seria e triasikut të poshtëm e zbuluar në shtratin e Bisticës së Pejës, në pjesën e sipërme të grykës Rugovës është e vendosur (shtruar) nën gëlqerorët e triasiku të mesëm dhe është e përfaqësuar nga ranorët argjiloro-mikor, argjilitet karbonatike dhe rërore dhe gëlqerorët e mermerizuar rreshpor, me

ngjyrë të zezë dhe paraqitje të fosileve të foraminifereve. Në Grykën e Rugovës paraqitet edhe seria klastike.

Në regionin e Majës së Nexhinatit , mbi shkëmbinjtë e Paleozoikut (filite etj.) janë të mbivendosura shtresat e triasikut të poshtëm- gëlqerorë mermeror pllakorë ngjyrë të zezë, gëlqerorët të mermerizuar , masiv e brekçioz, me ngjyrë të kuqrremtë dhe të bardhë dhe në fund gëlqerorët mergelorë dhe rëror, pllakor e brezor , me ngjyrë të verdhë, përhimtë etj, me paraqitje të makrofosileve.

Edhe në Majën e Strelcit është zbuluar seria e triasikut të poshtëm, e ngjajshme me atë të Majës së Nexhinatit, me ndryshim se këtu paraqiten edhe argjilitet,ranorët, konglomeratet kuarcore dhe diabazët

Triasiku i poshtëm-mesëm (i pa ndarë)

Shkëmbinjtë e triasikut të poshtëm-mesëm (i pa ndarë, sepse nuk ka qenë e mundur të veçohet i poshtëmi nga i mesmi) janë të përfaqësuar nga seria vullkanogjeno-sedimentare, me thjerza të gëlqerorve e dollomiteve dhe masa të serpentiniteve, diabazeve, graniteve dhe kuarçporfireve dhe ndërtojnë terrenet duke filluar nga Batusha , në jug, e deri te Maja e Strelcit, në veri (Malet e Junikut , Vokshit , të Strelcit etj).

Ndërmjet Gjeravicës dhe Rrasës së Zogut, mbi rreshpet e gjelbërta të paleozoikut, paraqiten filitet, argjilloshistet, kallkshistet dhe mermerët, me masa të serpentiniteve dhe diabazeve, të moshës triasik i poshtëm-mesëm.

Në regionin e Deçanit dhe Junikut mbizotrojnë ranorët argjilloro-mikor kokër mesëm dhe kokërrtrash në serin e triasikut poshtëm-mesëm.

Në serinë vullkanogjeno-sedimentare paraqiten edhe masa të serpentiniteve dhe diabazeve, ndërsa te Juniku edhe masa të graniteve dhe kuarçkeratofireve.

Në rreshpet dhe ranorët e formacionit sedimentaro-vullkanogjen paraqiten edhe thjerrza të dimensioneve të ndryshme të mermereve, brekçieve mermerore (afër Manastirit të Deçanit), kallkshisteve dhe dollomiteve. Në mermere dhe brekçie mermerore janë gjetur konodonte.

Triasiku i mesëm

Shkëmbinjtë e triasikut të mesëm ndërtojnë pjesë të konsiderushme të Bjeshkëve të Nemuna (Gryka e Rugovës, Zhlebi, Hajla etj).

Triasiku i mesëm është i zhvilluar , përveq në serinë vullkanogjeno-sedimentare (në këto raste nuk ka qenë e mundur të veçohet nga triasiku i mesëm) edhe në facien e gëlqerorëve dhe brekçieve (kati anizian), facien vullkanogjeno-sedimentare të Grykës së Rugovës (kati Ladinian) dhe facien e gëlqerorve dhe dollomiteve masive (anizian bashk me ladinianin).

Facia e gëlqerorëve dhe brekçieve (anizian) është e zhvilluar në rajonin e Majës së Nexhinatit, Grykën e Rugovës, Majen e Strelcit, Hajllë, Zhleb, Çakorr etj.

Në Majen e Nexhinatit ,shtresat e triasikut të poshtëm kalojnë më sipër në serinë e triasikut mesëm (anizian)- gëlqeror pllakor dhe brezor me ngjyrë të zezë dhe më lartë vijojnë ata brekçioz pllakor, ngjyrë të kuqremt, me fosile të amoniteve dhe ortoceraseve.

Në Grykën e Rugovës paraqiten gëlqerorët e përhimtë masiv dhe mbi ta gëlqerorët e kuq dhe brekçiet me fosile të amoniteve (anizian). Mbi këta gëlqerorë shtrihen shtresat e formacionit sedimentaro-vullkanogjen (kati ladinian).

Në rajonin e Majes së Strellcit paraqiten gëlqerorë brekçioz të kuqremt, të ngjajshëm me ata të Majës së Nexhinatit.

Formacioni sedimentaro-vullkanogjen i Grykës së Rugovës. Përveq facies të gëlqerorëve të kuqremtë me amonite dhe facies të gëlqerorve dhe dollomiteve , në triasikun e mesëm është veqar edhe seria e pa metamorfizuar sedimentaro-vullkanogjene (kati ladinian), depozitimet e së cilës paraqiten në formë tënjë brezi të ngusht në Grykën e Rugovës. Kjo seri përbëhet nga rreshpet karbonatike dhe rërore, me ngjyrë të përhimtë e të gjelbërtë, argjilitet dhe mergelet fletzor dhe pllakor, me ngjyrë të gjelbërt, të përhimtë, të zezë dhe të kuqremtë, dhe mandej vijojnë ranorë të lojlojshëm e më pak konglomerate, thjerza të gëlqerorve kristalor, stralle dhe shpesh edhe paraqitje të masave të vogla të diabazeve e serpentiniteve.

Në Hajlë, Zhleb etj., kati ladinian është i përfaqësuar nga shkëmbinjë gëlqeror-dollomitor koralor dhe gëlqeror mikrokristalor dhe gëlqeror me thjerrza dhe ndërshtresa të stralleve, me fosile të radiollarieve. Spongia etj.

Facia e gëlqerorëve dhe dollomiteve masive dhe shtresëzor , me ngjyrë hiri (anizian dhe ladinian të pa veçuar, gjegjesisht triasik i mesëm i pa ndarë) është i zhvilluar në Grykën e Rugovës, Lubeniç, Zhleb, Hajlë etj.

Në Grykën e Rugovës dhe Prronin e Milishevcit paraqiten gëlqerorët dhe dollomitet masiv, në të cilët është thelluar një pjesë e kanjonit të kësaj procke si dhe janë krijuar anët shkëmbore të thikta veriperëndimore të Koprivnikut

Triasiku i sipërm

Shkëmbinjte e triasikut të sipërm janë të zhvilluar në facien e gëlqerorëve dhe të dollomiteve shtresor, shtresëtrash dhe masiv, me ngjyrë të përhimtë dhe të kuqremtë. Paraqiten në regionin e Koprivnikut, Bjeshkës së Lumbardhit, në fillim të Kanjonit (Grykës) së Rugovës, në Malin e Thatë etj. Në këta shkëmbinjë paraqiten fosile të megalodonteve, foraminifereve, algjeve etj.

Në shkëmbinjte e triasikut të sipërm bëjnë pjesë edhe shkëmbinjte granitoid të Bjeshkve të Nemuna , të cilët ndërtojnë një regjion relativisht të gjërë në rrjedhjet e sipërme të Bisticës së Deçanit, Bisticës Kozhnjerit, Maja e Ropës e më pak në Gjeravicë dhe afër Junikut. Mendohet se këto granite nuk janë formuar në rrugë magmatike, por me granitizimin në vend të shkëmbinjve sedimentar dhe metamorfik. Këta shkëmbinjë janë përfshirë nga proceset intenzive tektonike dhe për këtë janë të kataklazuar dhe shpesh herë janë të shëndrruar në milonite dhe filonite.

SHKËMBINJTË E JURASIKUT

Shkëmbinjtë e Jurasikut paraqiten kryesisht në formë të formacionit diabaz-strallor të Jurasikut mesëm-sipërm. Ky formacion është i veqar në shumë vende në Grykën e Rugovës (Kuçishte etj) dhe në shpatijet lindore të Zhlebit, në kontakt me fushgropën e Dukagjinit, në formë të një brezi, duke filluar nga Brestoviku , nëpër Vrellë e deri mbi Istok (Burim).

Formacioni diabaz-strallor i Jurasikut mesëm-sipërm, në këtë regjion përfaqsohet me një llojllojshmëri të madhe të shkëmbinjve sedimentar, magmatik e metamorfik.

Nga sedimentët, në këtë formacion më së shpeshti paraqiten ranorët kuarcor, strallet, argjilitet, sugrauvakat, gëlqerorët rëror dhe mergelor, ndërsa mergelet, alevrolitet, grauvakat dhe ranorët arkoz janë më të rrallë.

Shkëmbinjtë magmatik në këtë formacion paraqiten në formë të intruzivev të vogla, derdhjeve dhe damarëve, me trashësi mbi 40-50 m. Dominojnë shkëmbinjtë e asociacionit spilit-keratofir: spilitet dhe variolitet, diabazet, melafiret, keratofirët, porfiritet dhe tufët porfirike. Shumë rrallë paraqiten si të veçuar edhe gabrot dhe serpentinitet.

SHKËMBINJTË E NEOGJENIT

Sedimentët e neogjenit paraqiten në pjesët më lindore të regjionit të Bjeshkëve të Nemuna, në kontakt të këtij masivi me fushgropën e Dukagjinit. Përfaqsohen nga sedimentët e miocenit dhe pliocenit.

Sedimentët e miocenit

Sedimentët e miocenit paraqiten rreth Pejës dhe në Majën e Zezë deri te Brestoviku. Përfaqsohen nga sedimentët zhavorrike-rërore me fragmente të mëdha dhe bloçe të gëlqerorve të triasikut dhe shkëmbinjve të formacionit diabaz-strallor.

Sedimentët e pliocenit

Sedimentët e pliocenit, që i takojnë fushëgropës së Dukagjinit, paraqiten në kontakt me formacionin diabaz-strallor, prej Radavcit e deri te Vrella. Përfaqsohen nga konglomeratet bazale, ranorët, sedimentet zhavorrike-rërore, rëra dhe argjilla me lignit.

SEDIMENTET E KUATERNARIT

Sedimentet më të reja të regjionit , sedimentet e kuaternarit kanë përhapje të madhe në pjesën përfundimtare të fushëgropës së Dukagjinit dhe në vetë masivin e Bjeshkëve të Nemuna. Në regjionin e Bjeshkëve të Nemuna paraqiten materiale të morenave , deluvione, “dete të gurëve“, mbulesë e fragmenteve të thepisura të shkëmbinjve(rrëgallë) etj., ndërsa në fushëgropën e Dukagjinit paraqiten sedimentet liqenore (zhavorr dhe rëra), sedimentet limno-glaciale, sedimentët e teracave lumore dhe aluviale, proluvionet dhe deluvionet.

Materialet glacialo-morenike janë krijuar gjatë deluviumit. Perfaqsohen nga fragmente të dimensioneve të ndryshme të konglomerateve kuarcore, gëlqerorëve, mermereve, rreshpeve të ndryshme paleozoike, stralleve,rërave dhe argjillave etj. Këto sedimente janë ruajtur më së miri në cirqe dhe lugina të akullnajave.

Në rajonin e Majës së Ropës, Gjeravicës, Koprivnikut, Bogiqevicës etj. janë grumbulluar blloqe të mëdha , kryesisht të shkëmbinjve kompakt të diabazeve, graniteve,konglomerateve kuarcore, gëlqerorëve dhe të mermereve të ashtuquajtura “dete të gurëve“.

Sedimentët deluviale janë prezente në të gjitha shpatijet malore (Junikut, Koprivnikut etj.) dhe janë të përfaqsuara nga materiale të ndryshme për nga granollumetria dhe përbërja petrografike.

Rrëgallat janë prezente në të gjitha shpatijet e pjerrta shkëmbore të majeve malore në Gjeravicë, Maja e Ropës, Rrasa e Zogut , Koprivnikut etj. Kanë formë të freskorës dhe përbëhen nga copzat shkëmbore të thepisura të dimensioneve të ndryshme.

Sedimentet limno-glaciale janë konstatuar në rrethinën e Deçanit dhe përbëhen nga copat dhe blloçet e konglomerateve kuarcore, rreshpeve paleozoike, graniteve, diabazeve dhe kuarciteve.

Sedimentët liqenore të pjesës përfundimtare të fushëgropës së Dukagjinit përfaqsohen nga argjillat rërore-zhavorrike, zhavoreve e rërave .

Depozitimet aluviale janë formuar në ujërrjedhjet e Bisticës (Lumbardhit) të Pejës, Deçanit dhe Lloçanit dhe janë të përfaqsuara nga rërat, zhavorret dhe materiali argjillor.

4.3. KARAKTERISTIKAT HIDROGJEOLIGJIKE

Përbërja gjeologjike e Bjeshkve të Nemuna ka kushtuar karakteristika hidrologjike të ndërlukuara të saj. Përveq litologjisë, në karakteristikat hidrologjike kanë ndikuar edhe sasia e madhe e të reshurave, por edhe një shkallë e ulët e infiltrimit (përveq në gëlqeror) si dhe zhvillimi kryesisht i porozitetit të çarjeve dhe karstifikimit në shkëmbinjë, gjë që ka kushtuar edhe formimin kryesisht të akuifereve të çarshmerisë dhe çarshmërisë-karstike. Vetëm në materialet e dezintegruara të shkëmbinjve (deluvione, rrëgallë, morena) janë formuar akuifere intergranulare.

Në bazë të karakteristikave hidrogeologjike, në Bjeshkët e Nemuna mund të veçohen:

- Shkëmbinjë kompakt të moshës palezoike dhe mesozoike, duke eliminuar gëlqerorët e mermerët, të përfaqësuar nga rreshpet kristalike dhe formacioni diabaz strallor, në të cilët janë formuar akuifere të ujërave nëntoksor të tipit të çarshmërisë, ujëzbrazja (drenimi) e të cilëve bëhet kryesisht përmes burimeve me debit deri në 0,5 l/sek., e më rrallë me debit më të lartë. Terene më akuifere të tipit të çarshmerisë janë pjesë të rajoneve të Kozhnjerit, Maleve të Deçanit, Kuçishtës, Lumi i Allagës, Malet e Vokshit etj.
- Shkëmbinjë magmatikë (gabrot dhe granitet) dhe serpentinitet etj. Paraqesin shkëmbinjë me veti të dobëta akumuluese të ujërave nëntoksorë, në të cilët janë formuar akuifere të ujërave nëntoksor të tipit të çarshmërisë, të cilët drenohen (shkarkohen) përmes burimeve me debit ujqor prej 0,01- 1,0 lit/sek. Terene me karakteristika të këtilla hidrogeologjike janë pjesë të rajoneve të Gjeravicës, Belopojës etj.
- Gëlqerorët, mermeret e dollomitet paraqesin shkëmbinj me karakteristika të larta ujëlëshuese (kolektorë) në të cilët janë formuar akuifere karstike të përmasave të ndryshme deri në ato tejet të mëdha, me debit ujqor deri në disa dhjeta litra /sek. Terene me karakteristika të tilla hidrogeologjike janë pjesë të rajoneve veriore të Bjeshkve të Nemuna, ku masat e shkëmbinjve karbonatik kanë përhapje dhe trashësi të madhe, siq janë disa terene përgjatë rrjedhjes së Bisticës (Lumbardhit) të Pejës, të Zhlebit, terenet gëlqerore mbi Istok (Burim), Vrellë etj. Këto akuifere karstike të masave karbonatore të Zhlebit, Malit të Thatë etj., drenohen (zbrazën) përmes burimeve të fuqishme karstike (gurrave), në prerjet erozionale të kontakteve të shkëmbinjve karbonatik (kolektorit) me shkëmbinjë e formacionit diabaz-strallor (izolator), përgjatë buzëz(anës) perëndimore të fushgropës së Dukagjinit, në formë të Burimit të Radavit, Vrellës dhe Istokut (Burimit) etj., me debit ujqor prej disa dhjeta lit/sek.

Burimet të ujërave nëntoksor të akuifereve karstike të disa pjesëve të rrjedhjes së Bisticës (Lumbardhit) të Pejës, akuifere më të vogla se ato më lartë përmendura, janë me debit ujqor të lartë vetëm në pjesët e poshtme të rrjedhjes së saj. Burime të tilla janë Uji i Zi, Burimet e fuqishme në kilometrin e tretë të rrugës Pejë Çakorr, disa burime ujqore të varura në Grykën e Rugovës etj.

- Masat e mermereve , të ndërfutura në rreshtet e paleozoikut , në disa pjesë të Kozhnjerit, të burimit të Bistricës Deçanit etj., përfaqsojnë shkëmbinjë kolektor të ujërave nëntoksor, të cilët drenohen përmes burimeve të cilat karakterizohen me debit deri në disa litra/sek.
- Depozitimet e materialeve të morenave, „deteve të gurëve“ dhe deluvioneve karakterizohen me akuifere të tipit intergranular, të cilët shkarkohen (drenohen) përmes burimeve me debit ujqor prej disa litra në sek, ose përmes burimeve difuzive (shpërndarse) dhe kullimeve të ndryshme nga pjesët e shkëmbinjve të dezintegruar. Terene që kanë karakteristika të këtyra hidrogjeologjike janë pjesët veriore të Gjeravicës, rrjedhja ujore e sipërme e Erenikut, Rajoni i Bjelluhës, Livadhet e Shabanit, Prroni i Lubeniqit etj.
- Sedimentet aluviale të Bistricës së Pejës dhe Deçanit paraqesin akuifere, të tipit intergranular, të rëndësishme të ujërave nëntoksor, ndërsa ato të rrjedhjeve të vogla nuk paraqesin ndonjë interes në këtë aspekt

Rajonet hidrogjeologjike të vequara më lartë , të karakterizuara me tipe të caktuara të akuifereve, nuk kanë veti të njejta hidrogjeologjike në tërë shtrirjen e tyre. Edhe përmbranda vetë këtyre rajoneve , veqohen pjesë të terrenit që kanë karakteristika që ndryshojnë nga karakteristikat e përgjithshme hidrogjeologjike të rajonit. Shpesh herë në të njejtin rajon hidrogjeologjik të veqar janë të zhvilluar disa lloje të akuifere të tipeve të ndryshme.

Më poshtë janë paraqitur përshkrimet litologjike dhe karakteristikat hidrogjeologjike të disa lokaliteteve që karakterizohen me burime të ujërave nëntoksor:

- Në rajonin e Prroit të Milishevës, ku masat e gëlqerorëve shtrihen mbi serinë e rreshteve kloritike, paraqiten burime të ujërave nëntoksor, me debit edhe deri në 10 lit/sek. Disa nga këto burime janë të kaptuara në mënyrë primitive.

- Në rajonin nga Hokaj e deri te Gryka e Rugovës , në regjionin përgjatë luginës së Bisticës së Pejës, paraqitet një ndrrim i njëpasnjishëm në mes vedi i shkëmbinjve të ndryshëm të paleozoikut, kryesisht i rreshpeve me gelqerorë, drenimi i të cilëve bëhet përmes burimeve ujore me debit deri në 0,3 lit/sek.

- Në kilometrin e tretë nga Peja, në rrugën për Çakorr, egziston një zonë e gjërë e burimeve (gurrave) të fuqishme të ujërave nëntoksor të tipit të kontaktit (kontakt i gëlqerorëve me dollomite dhe shkëmbinjë tjerë). Në anën e rrugës, në lartësi prej 25 m, gjendet një gurrë ujore me debit prej afër 50 lit/sek. Dhe afër saj edhe disa tjera me debite më të vogla prej 10-40 lit/sek. Një nga këto burime është i kaptuar në formë të kroit me debit afër 7 lit/sek.

- Në Rajonin e Kozhnjer -Deçanit, në livadhin e Zrellit, egziston një kaptazh primitive, me debit prej afër 0,5 lit/sek e formuar në materialet e dezinteguara të rreshpeve dhe filiteve. Afër 1,5 km mbi akumulimin retenziv të HE „Kozhnjerit“, nën një rrëpinë të gëlqerorëve , nga ana e majtë e rrugës , buron një gurrë karstike ujore me debit afër 10 lit/sek. Uji që buron nga kjo gurrë vazhdon të rrjedh në formë të rrjedhjes ujore për disa dhjeta metra , në mënyrë që mëpastaj të humbet në humnerë. Për gjatë luginës së Bisticës së Deçanit paraqiten disa dalje ujore nga proluvionet, të formuara mbi sedimentet paleozoike, si dhe disa burime ujore me debit të vogël deri në 0,4 lit/sek., disa nga të cilat janë të kaptuara. Përndryshe ujërat e Bisticës së Deçanit formohen kryesisht nga burimet në rrejdhen e sipërme të saj.

- Në rajonin e Fushës së Bardhë (Belopolës) paraqiten disa burime të vogla, me debit deri 0,5 lit/sek, në kontaktet e shkëmbinjve të formacionit diabaz –strallor, dhe burime të vogla ujore difuze në fragmentet shkëmbore të dezinteguara mbi serpentinite.

- Në rajonin e Taraboshit paraqiten burime të vogla në gëlqerorë e serpentinite si dhe në kuarцитet e metamorfizuara, disa nga të cilët janë kaptuar.

- Rajoni i Nexhinatit, edhe pse me burime ujore me debit të vogël, megjithatë, për shkak të prezencës së madhe të shkëmbinjve karbonatik dhe liqenjve egzistues , paraqet një regjion të rëndësishëm nga aspekti i ujërave nëntoksor.

- Regjioni i Rashka Dolit (Karsti i Lagur) paraqet një regjion të pasur me ujëra nëntoksor, me burime të shpeshta, me debit deri në 2,0 lit/sek.

- Në rajonin e Gjeravicës , prej karullës, përgjatë luginës së Erenikut, paraqiten kontaktet e gëlqerorëve me rreshpet paleozoike, përgjatë të cilave në mënyrë difuze paraqiten rrjedhje

ujore që derdhen në Erenik, në formë të prrockave të përhershme ose të përkohshme. Burimet karakterizohen me debit të vogël, deri në 0,1 lit/sek..

Rajoni i Karstit të Zi, i ndërtuar kryesisht nga shkëmbinj gabroid, karakterizohet me ujëmbajtje të lartë dhe drenohet pjesërisht nëpërmjet burimeve të Erenikut si dhe burimeve tjera , me debit prej 0,5-4,0 lit/sek.

- Rajoni përreth Gjollës është i ndërtuar kryesisht nga gëlqerorët, brekçiet gëlqerore etj dhe karakterizohet me burime të numërta me debit deri në 2,5 lit/sek.
- Në Goruzhdec, në rrënzën e një shpati, një gjysmë rrethi prej afër 10 m, paraqitet një burim difuz ujqor, debiti i tërsishëm i të cilit është afër 7 lit/sek dhe ka një ujë tejet kualitativ.

Në fund mund të konkludohet, se edhe pse Bjeshkët e Nemuna në një masë të madhe janë të ndërtuara nga shkëmbinjtë karbonatik dhe kanë burime relativisht të numërta, shumë pjesë të tereneve të tyre janë të varfura nga aspekti i ujërave nëntoksor, për shkak se drenimi (shkarkimi) i sasisë kryesore të ujërave nëntoksor të akuifereve karstike grandioze të këtij regjioni, bëhet përmes gurrave të fuqishme karstike në shpatijet lindore të Bjeshkve të Nemuna (Radavc, Vrellë, Burim etj), përgjatë kontaktit të gëlqerorëve me serinë diabaz-strallore, si pika më të ulta të shkëmbinjve izolator.

4.4. KARAKTERISTIKAT PEDOLOGJIKE

Në Bjeshkët e Nemuna , për shkak të përbërjes litologjike të nduardurshme, klimës karakteristike dhe vegjetacionit, janë zhvilluar edhe lloje të ndryshme të tokave.

Në Bjeshkët e Nemuna , si substrat në të cilin janë zhvilluar tokat kanë shërbyer depozitimet morenike dhe koloviumi, diabazet , gabrot, granitet, brekçiet gëlqerore, gëlqerorët, dollomitet dhe rreshpet kristalike.

Klima ka luajtur një rol të rëndësishëm në krijimin e këtyre tokave. Klima është mvarur nga lartësia mbidetare dhe faktorit vjetor të reshurave të shiut. Mvarsisht nga këta faktor, klima deri në lartësi prej 1200 m ka karakter humid, ndërsa mbi këtë lartësi fiton karakterin perhumid.

Vegjetacioni është poashtu faktor i cili ka ndikuar në krijimin e tokave. Është i kushtzuar nga substrati, klima, pozita dhe madhësia e masivit. Në brezin më të ultë lartsinor janë pyjet e gështenjës së butë, me të cilat shpesh është i përzier edhe ahu. Në viset më të larta (1.200-1400m) në pyjet e ahut ngandonjiher përzihet edhe bredhi, me ç rast është krijuar një brez i përzier i pyjeve të ahut-bredhit. Sa më shumë që rritet lartësia mbidetare aq më tepër mbizotrojnë halorët, kështu që pas brezit kalues të pyjeve të përziara formohet brezi i hormoqit , si në shkëmbinjtë silikat ashtu edhe në gëlqeror. Në këtë lartësi, ose edhe më lartë nga brezi i hormoqit, në gëlqeror paraqiten pyjet e arnenit ndërsa në shkëmbinjtë silikat pyjet e rrobullit. Në lartësi edhe më të mëdha, me arnenin mbaron vegjetacioni pyjor ose mbi të paraqiten pyjet e kërlekës.. Në këtë brez të pyjeve të pishave, e shpesh herë edhe ndërmjet tyre, paraqitet brezi i kullosave të maleve të larta- suvatet.

Me rritjen e lartësisë, krahas ndrrimit të tipit të vegjetacionit, ndrojnë edhe llojet e tokave në Bjeshkët e Nemuna. Një brez i caktuar të vegjetacionit , me korigjim të disa specifikave për shkak të ndikimit të substratit gjeologjik, i koreospondojnë edhe tipe të caktuara të tokave.

Në brezin kodrinor me pyje të gështenjës së butë të Bjeshkëve të Nemuna , mbi shkëmbinjtë silikatë janë zhvilluar varietete të ndryshme të tokave acide ngjyrë gështenje. Nëse në këtë brez, me gështenjen paraqitet edhe dushku, atëherë ky lloj i tokave bëhet më skeletor e nëse është përzier ahu,

atëher komponenta skeletore zvoglohet dhe aciditeti është më i ultë. Në pyjet e pastra të dushkut, janë krijuar varietetet e tokave gështenje acidike skeletore.

Karakteristikat e tokave në pyjet e ahut në rend të parë mvaren prej karakterit të substratit. Në shkëmbinjtë gëlqerorë janë krijuar tokat gështenje në gëlqeror, ndërsa në shkëmbinjtë silikatë tokat gështenje acidike. Tokat gështenje acidike podzolike paraqiten në pyjet e ahut me lëmyshqe.

Me rritjen e lartësisë dhe ndrrimin e karakteristikave bioklimatike, në brezin e ahut-bredhit sasia e humusit në tokë rritet dhe për këtë janë krijuar tokat humusore gështenje acidike dhe humusore (renkeret). Mbi gëlqerorët kompakt të brezit të ahut-bredhit, formohen tokat e tipit terra fusca (tokat ngjyrë të verdhë).

Në lartësinë mbidetare prej 1.400-1.900 m, në pyjet e përziera të ahut dhe hormoqit, ahut –bredhit-hormoqit, të bredhit – hormoqit si dhe të hormoqit, në shkëmbinjtë acid silikat janë krijuat tokat podzolike ngjyrë gështenje. Tokat podzole geshtenje janë karakteristike edhe për pyjet e rrobullit .

Redzina gëlqerore acide është karakteristike për brezin pyjor më të lartë- për brezin e kërlekës.

Varietetet e ndryshme të redzinave gëlqerore ose të tokave silikate humusore (me stadet A-C) janë karakteristike për regionet me kullosat e maleve të larta-suvatet.

Substratet kryesore mbi të cilat janë zhvilluar tokat e Bjeshkve të Nemuna janë : substrati mbi gëlqeror, mbi serpentine dhe mbi shkëmbinjë silikatë.

Në shkëmbinjtë gëlqeror janë krijuar tipe të ndryshme të tokave: sirozemi (tokat gurore), protoredzina dhe tokat e zeza organogjene, të fazës fillestare, mandej redzina organogjene, redzina organogjene në karbonate (redzina e vërtetë) me shumë varietete, terra fusca etj.

Në serpentinite tokat nuk kanë ndonjë përhapje të madhe dhe në këtë substrat janë të zhvilluara sirozemi, redzina serpentimore-tokë silikate humusore dhe tokat ngjyrë gështenje në serpentinite. Pjellëshmëria prodhuese e tokave në serpentinite variron prej asaj të dobët (sirozema) deri me vlerë diçka më të rritur të saj.

Në shkëmbinjtë silikat, për shkak të llojlojshmërisë së tyre litologjike, janë formuar tipe të shumta dhe të llojlojshme të tokave: sirozemi, renkeret , renkerët ngjyrë gështenje, tokat humusore acide , podzolet e gështenjta etj. Edhe në këto toka pjellshmëria e tyre ndryshon, duke u rritur te tipet e fundit. Tokat e formuara në substratin silikat karakterizohen me pjellshmëri më të lartë të përgjishshme, në krahasim me tokat e dy substrateve tjera.

PËRFUNDIM

Bjeshkët e Nemura me pejsazhet e tyre atraktive, me një numër të madh formash të ndryshme morfologjike, ndërtim gjeologjik specifik dhe akuifere dhe burime ujore nëntoksore të ndryshme, me llojlojshmëri të tokave dhe një gjeotrashigimi të rëndësishme ,paraqesin një regjion që gjithësesi duhet mbrojtur dhe shfrytzuar për qëllime ekonomike ,turistike, shkencore dhe edukative.

Format e shumta dhe të llojlojshme morfologjike- cirqet, morenat, luginat e akullnajave, grykat, kanjonet, shpellat dhe pejsazhet atraktive rilievore mund të shfrytzohen për qëllime turistike, shkencore dhe edukative.

Shkëmbinjtë e llojlojshëm të paleozoikut (ordovik,silur, devon, karbon) paraqesin shkëmbinjtë më të vjetër të Kosovës perëndimore. Shkëmbinjtë e moshës triasike, me llojlojshmërinë e tyre litologjike dhe paleontologjike, dhe me prerjet natyrore në të cilat mund të përcillet zhvillimi i tërë triasikut, kanë rëndësi të veçantë shkencore dhe edukative. Blloçet shkëmbore të dimensioneve grandioze, të formuara nga proceset egzogjene, paraqesin edhe atraksion turistik.

Burimet e llojlojshme të ujërave nëntoksor, shpesh me derdhje në formë të ujëvarjeve si dhe gurrat e fuqishme karstike (Radavc, Vrellë, Burim etj), përveq rëndësisë së tyre shkencore dhe edukative, kanë edhe rëndësi për furnizim me ujë të këtij regjioni.

Gjeotrashigimia e laramishme dhe e begatshme e Bjeshkëve të Nemuna paraqet një komponentë të rëndësishme si në aspektin shkencor e edukativ, poashtu edhe në ate turistik. Mirëpo, për

eksploatimin optimal të saj për qëllimet e cekura, është e nevojshme që në të ardhmen të inicohet një studim (2-3 vjeçar), me ç'rast do të bëhet inventarizimi, studimi, klasifikimi, vlerësimi dhe valorizimi i gjeomonumenteve të Bjeshkëve të Nemuna.

Duke u bazuar në vlerat e elementeve karakteristike të cekura në këtë tekst , si dhe vlerat tjera të llojllojshme me të cilat disponon (klima, biodiversiteti, pyjet, lumenjtë liqenjtë etj.) , Bjeshkët e Nemuna duhen të organizohen dhe mbrohen urgjentishtë në formë të “Parkut nacional – Bjeshkët e Nemuna“

4.5. VEÇORITË KLIMATIKE

Qëllimi i këtij vështrimi studimor është identifikimi i vlerave të veçanta klimatike dhe hidrike të Bjeshkëve të Nemuna për mbështetje të iniciativës për shpallje Park Nacional. Në identifikimin e objekteve dhe dukurive me vlerë të gjeo-trashëgimisë është nisur nga parimet e përgjithshme se ato duhet të jenë të cilësisë shumë të larët dhe që ruajtja e tyre të jetë në gjendje të mirë.

Në arsyetimin profesional-shkencor për Iniciativën për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional paraqiten të dhëna preliminare të realitetit klimatik dhe hidrik me rëndësi për hapësirën që do të vehet nën ruajtje dhe mbrojtje, por edhe si objekte e dukuri atraktive natyrore.

Vlersimi i karakteristikave klimatike dhe hidrike me rëndësi për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional në këtë Raport është bazuar në : veçorit fizike të vlerave klimatike dhe hidrike, funksionalitetin, rëndësinë, shkallën e ruajtjes dhe rrezikueshmërisë së tyre .

Analiza e funksionalitetit të vlerave klimatike dhe hidrike, ka rëndësi jo vetëm për mbrojtjen e vlerave ekologjike , por edhe për vet faktin e aftësisë së funksionimit të Parkut Nacional. Paradispozitat klimatike dhe hidrike të Parkut Nacional Bjeshkët Nemuna cilsohen me veti polifunksionale dhe mundësojnë zgjedhje optimale të problemeve fundamentale të ruajtjes, mbrojtjes, regullimit hapësinor dhe shfrytëzimit racional të resurseve natyror.

Kushtet Klimatike

Analiza dhe vlersimi i klimës dhe elementet klimatike në veçanti është e domosdoshme jo vetëm në raport me kërkesat e veprimtarive njerzore që drejtëpërdrejt varen nga to, por edhe në qasjen komplekse apo të veçanta të mbrojtjes dhe ruajtjes së vlerave natyrore. Është e nevojshme të theksohet se çdo investimi shoqëror në aktivitete të ndryshme ekonomike, sukcesi i të cilave varet edhe nga faktorët klimatik, duhet t'i paraprijnë edhe analizat dhe vlersimet adekuate klimatike.

Parametrat klimatike të kompleksit malor Bjeshkët e Nemuna mund të vlersohen nga aspekti i pozitës klimatike, rolit të kushteve orografike si faktor klimëformues, vlerave mesatare dhe ekstreme të elementeve klimatik, ndikimi i klimës në katëzimin e vegjetacionit, formsimin e pejsazheve autentike, si komponent e ekosistemeve, dukurive dhe hapësirave me vlerë të vaçant si dhe rëndësia rekreativo-turistike e klimës (aspekti biomedicinal). Duke u nisur nga fakti se elementët dhe faktorët e bazës natyrore qëndrojnë në ndërvarësi të ngushtë dhe bashkëveprim të ndërsjellë, klasifikimi i tyre në faktorë abiot dhe biot në këtë studim për iniciatëven për shpallje të Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional duhet trajtuar si të kushtëzuar.

Bjeshkët e Nemuna në bazë të pozitës gjeografike, përthyeshmërisë vertikale e horizontale të relievit dhe evolucionit morfo-klimatik paraqet ekosistem malor specifik. Për shkak të sipërfaqës së madhe hapsinore, drejtimit të shtrirjes dhe disecimit nga rrjedhat ujore Bjeshkët e Nemuna formojnë një malësi komplekse. Kështu kompleksi malor Bjeshkët e Nemuna diferencohen me larysi të theksuar të kushteve klimatike, morfo-hidrike dhe biodiversitet. Bjeshkët e Nemuna me rolin e tyre orografik ndikojnë që në një hapësirë relativisht të vogël të krijohen tipe të ndryshme klimatike. Njohja e kushteve mikroklimatike ka rëndësi të madhe jo vetem për egzistencën dhe zhvillimin e bimëve e shtazëve, por edhe për jetën dhe veprimatrin e njeriut.

Në Bjeshkët e Nmunana, të ndikuara nga kushtet klimatike sub-alpine dhe alpine, është ruajtur flora dhe vegjetacioni subpolar duke e renditur atë në provincë të veçantë alpiko-nordike fitogjeografike dhe ekologjike të lartë. Njohje e kushteve paleoklimatike, e sidomos gjatë glacialit të fundit në rrethanat e ndikimit të elementeve mediterane, ka rëndësi shkencore për kuptimin e krijimit të llojeve të reja-neospecia si fektor identifikues me rëndësi për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional. Proceset historike të zhvillimit të botës organike(begatia floristike dhe e vegjetacionit) qëndrojnë në ndërvarësi të

madhe me proceset historike në botën inorganike, në rend të parë të kushteve klimatike, hidrike dhe gjeomorfologjike. Larysia e madhe vertikale dhe horizontale e botës organike(flora, vegjetacioni, fauna, fitocenoza dhe ekositemeve) në Bjeshkët e Nemuna në rend të parë kushtëzohet nga pozita dhe ndryshimet e theksuara të klimës dhe elementeve klimatik.

Në analizat e faktorëve fiziko-gjeografike, reliefi si faktor klimëformues ka rëndësi të veçant. Roli i relievit shfaqet mbi të gjith elementet e motit dhe klimës. Përthyeshmëria e theksuar vertikale e Bjeshkëve të Nemuna kushtëzon ndryshime të dalluara të elementeve klimatike me rritjen e lartësisë mbidetare. Në kompleksin malor Bjeshkët e Nemuna të parapar për shpallje Park Nacional shtrihet një numër i madh i majeve malore me lartësi mbidetare mbi 2000m: Gjeravica-2656 m, Maja e Rops – 2502 m, Maja Rusolisë- 2381m, Kurvalla-2303m, Maja e Strellcit-2377m, Maja e Qenit –2406m, Koprivnik(Kërshi i Çverlës)-2460m, Marjashi(Bogdash)-2530m, Nexhinati-2341m, M. Lumbardhit- 2522m, Hajlla-2400m, Gusan-2539m, kota 2130m, Maja e Bajrakut-2078m, Mali Kozhnjer - 2107m etj..

Meqenëse, pjesë të rëndësishme të Bjeshkëve të Nemuna kanë qenë të përfshira nga akullzimi i kuaternarit, e sidomos të fazës së fundit-vyrmit, ato marrin pjesë në ndodhit më enigmatike të evolucionit gjeomorfologjik, klimatik, hidrologjik dhe biologjik të Ballkanit dhe Evropës. Njohja e kushteve paleoklimatike dhe paleoekologjike ka rëndësi të veçant shkencore për spjegimin e rethanave aktuale floristike dhe të vegjetacionit. Nga ky aspekt Bjeshkët e Nemuna mund të trajtohen si një “laborator” natyror për kërkime shkencore.

Veçori kryesore e klimës të Bjeshkëve të Nemuna është roli i faktorit orografik në tipizimin klimatik. Kështu në një hapësirë relativisht të vogël, të kapëshme edhe për syrin e njeriut, çartë vërehen efektet klimatike në zonimin vertikal të pejsazheve. Një numër i konsideruar i majeve malore, shpateve të tyre dhe kunorave të Bjeshkëve të Nemuna shtrihen mbi kufirin e sipërm klimatik të pyjeve i cili për kushtet tona gjeografike është përafërsisht 1900 m(ana e djath e Bisticës së Kozhnjerit), 2000m (Bjeshka e Baballoqit),1990m (pjesa juperendimore e Bjelluhës) sipas të dhenave të hartave topografike. Ky kufi fitogjeografik nuk është fikse, por oscilon sepse përveç lartësisë mbidetare, ndikohet edhe nga faktor tjerë klimatik. Në bazë të hulumtimeve në terren është konstatuar se me veprimet e faktorit antropogjen kufiri i sipërm i pyjeve po shënon trende të uljes.

Pyjet si tipi më i zhvilluar i vegjetacionit , janë rezultat të kushteve specifike të klimës, por njëherit ato ndikojn në ndryshimin e kushteve klimatike dhe mikroklimatike të asociacineve të tyre dhe rrethinës. Mbi zonën(katin) e pyjeve , në shpatet e buta malore, sipërfaqet e sheshuara dhe pllajat shtrihet brezi(kati) klimatik i kullotave (suvateve) malore. Mirëpo, sipërfaqe të kullotave malore shtrihet edhe në çeltina malore nën kufirin e sipërm të pyjeve. Kullotat malore të Bjeshkëve të Nemuna, të ndikuara nga tiparet e relievit, kushteve klimatike dhe pedogjene, vlersohen si kullotat më langëshmëri më të mirë në

Gadishullin Ballkanik. Mbi brezin (katin) e kullotave shtrihet brezi i zhveshur guror e shkëmbor ku në kushtet e klimatit të ashpër zhvillohen procese specifike relievformuese dhe peisazhe të veçanta.

Bjeshkët e Nemuna cilësohen me sasi më të madhe të reshjeve atmosferike dhe numër më të madh të ditëve me reshjetë (mbi 130 ditë). Mirëpo, Bjeshkët e Nemuna po ashtu cilsohen edhe me pjesëmarrje të madhe të reshjeve atmosferike në formë bore. Deri sa në pjesët e ulëta të Kosovës mesatarisht paraqiten 20-30 ditë me reshje bore në Bjeshkët e Nemuna, varësisht nga lartësia mbidetare, paraqitën 40-80 ditë. Mbulesa e borës në Dukagjin mesatarisht zgjat 40 ditë, kurse në Bjeshkët e Nemuna varësisht nga lartësis mbidetare prej 60-210 ditë. Bjeshkët e Nemuna, në bazë të kushteve topografike dhe reshjeve atmosferike në formë bore, disponojnë me vlera potenciale të mëdha për zhvillimin e sporteve dimrore dhe turizmit malor. Është e njohur se sportet dimërore në shkallë të caktuar të zhvillimit turistik zënë vend të rëndësishëm menjëherë pas turizmit bregdetar me motive tërheqëse për visita masovike. Këto janë elemente komplementare të rëndësishme për valorizimin dhe funksionimin e Parkut Nacional Bjeshkët e Nemuna.

Elementet kryesor klimatik në kompleksin malor Bjeshkët e Nemuna kanë këto vlera :

Diellosj, sipas gjërësisë gjeografike, lartësisë mbidetare dhe shkallës së vrërësive diellosj reale në kompleksin malor Bjeshkët e Nemuna është përafërsisht 44% e vlerës potenciale (4459 orë me diell). Kjo vlerë ndryshon nga rreza malore (1945 orë) deri në afro 2200 orë me diell në lartësit mbidetare mbi 2000m.

Temperatura, vlera mesatare vjetore e temperaturës të ajrit në zonën rrezë malore është rreth 10.2°C, kurse në lartësi mbi 2000 rreth 5°C, amplitudat vjetore zvoglohen me rritjen e lartësisë mbidetare nga 21.3°C, në rrënzën malore, deri në 17°C, në pjesët më të larta, muaji më i ngrohtë është koriku kurse më i ftohtë janari.

Reshjet atmosferike, lëkundën nga 1000 mm në zonën rrezë malore deri në 1500 mm në terrenet mbi 2000m, duke arritur vlerën maksimale në skajin perëndimor të pjesës burimore të Bistricës së Deçanit. Mbulesa e borës në lartësit mbidetare mbi 2000 m zgjatë afërsisht 60% të vitit. Mbulesa e borës, zgjatja dhe koha e paraqitjes është jashtëzakonisht e favorshme me sporte dimërore. Në këtë mënyrë reshjet e bollshme të borës paraqiten si element komplementar për aktivitet polifunksionale në Bjeshkët e Nemuna.

Erërat, rrezë dhe kompleksin malor i Bjeshkëve të Nemuna cilsohet me rastisje relative të madhe të qetësive (calm), por vlera e tyre zvoglohet me rritjen e lartësisë mbidetare. Drejtimi i erërëve në shkallë të lartë është i paradisponuar me morfologjin e relievit. Në pjesën më të madhe të Bjeshkëve të Nemuna frekuencë më të theksuar kanë erërat nga kahu perëndimor, jugperëndimor dhe verilindor. Në përgjithësi

komponenta verilindore e erërave ka frekuencë më të madhe dimrit, kurse ajo jugperëndimore verës dhe në vjeshtë.

Në përgjithësi mund të konstatohet se kompleksi malor Bjeshkët e Nemuna kanë kushte të volitshme të klimës malore me ndryshime vertikale të theksuara që shprehet në katëzimin vertikal të vegetacionit, krijimin e ekosistemeve të ndryshme, formimin e pejsazheve pitoreske, krijimin e begatisë ujore dhe cilësohet si klimat i shëndetshëm.

Valorizimi i elementeve e kushteve klimatike për qëllime konkrete si dhe shfrytëzimin e motiveve të Bjeshkëve të Nemuna për zhvillimin e sporteve dimërore dhe forma tjera të aktiviteteve njerëzore do të bëhet në suaza të Planit hapësinor të Parkut Nacional.

4.6. VEÇORITË HIDROLOGJIKE

Ujërat në kompleksin malor të Bjeshkëve të Nemuna nga aspekti i mbështetjes së Inicativës për shpallje të Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional mund të trajtohen si :

- resurse natyrore
- si dukuri ose objekte unike me vlera atraktive burimore
- si pjesë përbërëse ose komponentë e ekosistemeve, objekteve, dukurive dhe hapësirave me vlerë të vaçantë për mbrojtje.

Në këtë vlerësim theksohen kryesisht veçoritë tipike hidrike që shërbejnë si faktor identifikues me rëndësi të veçantë për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional.

Në Bjeshkët e Nemuna egziston një rrjet i dendura i rrjedhave ujore që shkarkojn ujërat në Drinin e Bardhë- ujëmbledhësi e detit Adriatik. Përveq burimit të Drinit të Bardhë, pjesa dërmuese e sipërfaqes së Bjeshkëve të Nemuna drenohet nga degët e djathta të tij: Sushica, Bistrica e Pejës, Bistrica e Deçanit, dhe Ereniku. Nga ana e majtë e Drinit të Bardhë, ujërat nga pjesa lindore e Bjeshkëve të Nemuna drenohen nga lumi Istog. Mirëpo, një pjesë e vogël e sipërfaqës së Bjeshkëve të Nemuna, në skajin

verilindor-Mokna, të parapara për Park Nacional drenohet nga degët e djathta të lumit Ibër-ujëmbledhësi i Detit të Zi.

Rrjedhat ujqore në kompleksin malor Bjeshkët e Nemuna cilësohen me pjerrësi të madhe të shtratit të lumit, lugina të ngushta me shpate anësore të pjerrëta deri të thikta (kanjonike), rrjedhje të shpejta, shtrat të mbuluar nga rëra, zhavori, zaje dhe blloqe gurësh, kurse anëve të shtrati të lumit në masën shkëmbore paraqiten thellime korozive. Lumenjtë kryesisht kanë prurje të mëdha ujqore, fuqi të mëdha autopurifikuese, turbullimi më i shpesht i ujit paraqitet në vjeshtë (maksimumi vjeshtor i reshjeve të shiut) dhe pranverë (shkrirja intenzive e borës) si dhe dukurive ekscesive të rrebesheve të rreshjeve. Luginat lumore të ngushta, në potese të caktuara në formë konjonike, kryesisht janë të kalueshme dhe krijojnë mundësi të mira për zhvillimin e trasaveve lokale të komunikacionit deri në thellësi të kompleksit malor. Këto paradispozita natyrore janë shumë me rëndësi për shfrytëzimin e potencialeve të resursëve natyror që ofrojnë, mirëpo, në shkallë të lartë rrezikojnë edhe vlerat e pa mbrojtura.

Bistrica e Pejës është degë e djathtë e Drinit të Barrdhë dhe ka një sipërfaqe të përgjithshme të pellgut lumor prej 503.3km², kurse në Bjeshkët e Nemuna 264 km², ose 52.4%. Rrjedhja e sipërme e Bistricës së Pejës deri në qytetin e Pejës në tërësi ka karakter të rrjedhjes malore dhe përfshin më tepër se rreth gjysmën e sipërfaqës së Bjeshkëve të Nemuna të parapara për Park Nacional.

Bistrica e Deçanit, po ashtu është degë e djathtë e Drinit të Bardhe e cila drenon sipërfaqe të rëndësishme të Bjeshkëve të Nemuna të parapara për Park Nacional. Nga sipërfaqja e tërësishme e pellgut ujëmbledhës prej 278 km², rreth 114 km² ose 41% e pellgut gjendet në hapësirën malore të paraparë për Park Nacional.

Në kompleksin malor të paraparë për Park Nacional shtrihet gadi në tërësi pellgu ujëmbledhës i rrjedhjes Sushica (17 km²), dhe pjesa burimore e Erenikut. Kurse nga pjesa lindore e Bjeshkëve të Nemuna nga sipërfaqet e parapara për Park Nacional drenojnë ujërat gurrat e fuqishme karstike e “Radavit”, “Vrellës” dhe “Istogut” dhe disa procka torrenciale që shkarkojnë ujë në lumin e Istogut.

Në tërësi pjesa e kompleksit malor të Bjeshkëve të Nemuna të paraparë për Park Nacional cilësohet me sasi më të madhe të reshjeve atmosferike, koficient më të lartë të rrjedhjes dhe vlerë më të madhe të modulit të prurjeve ujqore në Kosovë (20-45 l/s/km²) në Kosovë.

Vlerësimi i karakteristikave natyrore hidrike me rëndësi për shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional në këtë Raport është bazuar në: veçoritë fizike të vlerave hidrike, funksionalitetin, rëndësinë dhe shkallën e rrezikueshmërisë të vlerave hidrike që do të vehen nën mbrojtje.

Në kompleksin malor Bjeshkët e Nemuna të paraparë për shpallje Park Nacional paraqiten vlera të shumta hidrike që cilësohen me rëndësi të paraqitje, atraktivitet dhe tipare tjera të rëndësishme që i plotësojnë kushtet ndërkombëtare si elemente komplementare të parkut nacional. Në këtë tërësi natyrore shtrihen

lumenjë tipik malor, me rënje dhe energji të madhe, gryka të ngushta vende vende kanjonike, shtretër me rërë, zaje, zhavor dhe blloqe gurrësh, gurra të fuqishme karsstike: Vrella–Istog (1400-4500l/s), Vrella-Vrellë (1800-2000l/s), Gurra e Radavcit (1900-6500 l/s), Uji i Barrdhë-Pejë, Uji i Zi-Pejë, Vrella e Gubavcit-Pejë, Vrella e Lubeniqit-Lubeniç, Vrella e Jasiqit-Jasiç, Vrella e Livadheve të mëdha-Jasiç, Vrella e Isposnicës (Bistrica e Deçanit), Vrella e Belajes (Bistrica Deçanit), Vrella e Junikut (Junik), Vrella (Haxhaj) etj.

Analiza e funksionalitetit të vlerave natyrore klimatike dhe hidrike, ka rëndësi jo vetëm për mbrojtjen e vlerave ekologjike , por edhe për vet faktin e aftësisë së funksionimit të Parkut Nacional. Parku Nacional Bjeshkët e Nemuna ka paradispozita natyrore shumë funksionale (polifunksional) duke mundësuar zgjedhje optimale të problemeve fundamentale të mbrojtjes, regullimit hapësinor, shfrytëzimit racional të resurseve natyror dhe zhvillimit të qëndrueshëm të Parkut Nacional dhe rajonit në tërësi.

Në Bjeshkët e Nemuna mesatarisht gjatë vitit bien prej 1000 mm deri në 1500 mm dhe paraqet zonën me reshje më të mëdha në Kosovë. Reshjet e larta atmosferike krijojnë një potencial të madh të ujërave të freskëta. Potenciali i madh uhor i Bjeshkëve të Nemuna ilustron faktin se evapotranspiracioni vjetor, si komponentë kyçe e bilancit uhor, ka vlerë të vogël. Brezi malor i Bjeshkëve të Nemuna paraqet zonën kryesore e cila ushqen me ujë Drinin e Barrdh. Sipas vlersimeve preliminare në zonën malore të Bjeshkëve të Nemuna formohen mesatarisht afro 30 m³/s . Sipërfaqja e propozuar për park nacional e Bjeshkëve të Nemuna zënë afro 500 km² ose afro 12 % të sipërfaqës së tërësishme të pellgut ujëmbledhës të Drinit të Barrdh, por në te formohen afro 49% të prurjeve ujore në vendmatjen hidrometrike Vermicë, në dalje të Drinit të Barrdhë nga Kosova. Ky fakt tregon begatin e madhe me ujë të Bjeshkëve të Nemuna. Në saje të këtyre ujërave në pjesën veriore të Dukagjinit janë ndërtuar sistemet e vjetra ujitëse me kthim të ujit me rënje të lirë. Vlerësohet se këto sistemet ujitëse janë më të vjetrat në pjesën qendrore të Ballkanit. Ndryshimet esenciale klimatike dhe hidrike në kompleksin malor Bjeshkët e Nemuna mund të kenë pasoja të paparishkuara jo vetëm për humbjen e vlerave të papërsëritshme natyrore, por edhe për tërë rejonin agrar jashtëzakonisht produktiv dhe popullatën e saj.

Ujërat e Bjeshkëve të Nemuna formohen nga gurrat dhe rrjedhat autoktone. Ato janë ujëra domicile dhe vlersohen si ujëra të freskët me cilësi të lartë. Meqense nevojat për ujëra të freskëta në Kosovë po rriten në mënyrë rapide, ruajtja dhe mbrojtja e potencialeve ujore të Bjeshkëve të Nemuna ka rëndësi strategjike për vendin. Mbrojtja, ruajtja dhe shfrytëzimi racional më i sigurtë mund të realizohet me shpalljen e Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional. Ujërat e kompleksit malor të Bjeshkëve të Nemuna të parapar për shpallje Park Nacional, kryesisht janë të rujtura në gjendje burimore. Rrjedhat ujore të Bjeshkëve të Nemuna nga aspekti ihtiologjik paraqesin fenomen të rrall natyror. Rrethana të favorshme për ruajtjen e cilësisë së lartë të ujit qëndrojnë në faktin e numrit të vogël të vendbanimeve, banorëve dhe

nivelit të ulët i aktiviteteve ekonomike. Pra kompleksi malor Bjeshkët e Nemuna të paraparë për Park Nacional cilësohen me dy tipare karakteristike: begatia e madhe me ujëra të freskëta dhe kualiteti i lartë. Çregullimi i mëtejshëm i gjendjes burimore të kompleksit malor Bjeshkët e Nemuna të paraparë për Park Nacional do të thotë rrezikimi i potencialeve të mëdha të resursve ujor, cilësisës dhe ekosistemeve eksituese ujore.

Raritetet hidrike, kompleksi malor Bjeshkët e Nemuna cilsohet me dukuri e objekte të rralla hidrike të papërsëritshme, me shtrirje të kufizuar hapsinore dhe të rujtura në gjendje burimore. Mirëpo, rritja e hovshme e nevojave për ujë gjithnjë e më tepër po ndikon në rritjen e shkallës së rrezikimit të tyre. Rëndësi të veçantë, si raritetet natyrore dhe burime potenciale të ujit, janë gurrat karstike : Burimi i Drinit të Barrdhë në Radavc, vrella e Istogut dhe vrella në fshatin Vrellë. Burimi karstike i Drinit të Badhë në Radavc përveç prurjes së madhe ujore, që e cilson atë në rradhen e gurave më të njohura karstike në Gadishullin Ballkanik, cilsohet edhe me ujëvarjen më të madhe në Kosovë. Çdo intervenim në lidhje me shfrytëzimin e potencialeve ujore në këtë gurrë karstike duhet të jetë nën mbikëqyrjen e Institutit për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit të Kosovës.

Në kompleksin malor të Bjeshkëve të Nemuna paraqitet një numër i madhë i liqeneve me origjinë glaciare të njohur në mënyrë popullore si “sytë e maleve”. Liqenet për nga gjeneza e tyre kanë rëndësi të madhe shkencore dhe edukative. Edhe pse kryesisht gjenden në gjendje burimore ato dallohen me ndieshmërinë e tyre të madhe ndaj veprimeve të pa kontrolluara të njeriut, prandaj duhet të vehen nën ruajtje dhe mbrojtje rigoroze. Në shpatet shkëmbore të luginave lumore në sektorët grykor dhe kanjonik paraqiten disa ujëvarje pitoreske , kurse pranë shtratit të lumnejëve thellime korozive.

Potenciali hidroenergjetik i rrjedhave ujore në Kosovë në përgjithësi është i vogël, mirëpo, vlersohet se Drini i Barrdh disponon me potencialet më të mëdha hidroenergjetike. Gurrat dhe degët e Drinit të Barrdh të cilat formohen në kompleksin malor të Bjeshkëve të Nemuna disponojnë me paradispozita natyrore për ngritjen e mini hidrocentraleve me fuqi instaluese me rëndësi lokale. Në ujërat që drenohen nga kompleksi malor që parashihet të shpallet Park Nacional janë ngrit tre mini hidrocentrale :

- HE “ Kozhnjer “ 6.4 M
- HE “ Radavc” 0.28M
- HE “ Istog” 0.46M

Egzistojn projekte ideore për ngritjen edhe të hidreocentraleve tjera në rrjedhat ujore që formohen në kompleksin e Parkut Nacional.

Qëllimet e veçanta për ruajtjen dhe mbrojtjen e ujërave në kompleksin malor të paraparë për Park Nacional janë :

- zhvillimi i papenguar i proceseve dhe kushteve hidrike në pjesën më të madhe të kompleksit malor të mbrojtur
- zhvillimi i papenguar i ekosistemeve akuatike
- ripërtirja e gjendjes natyrore të ekosistemeve akuatike të dëmtuara ose degraduara
- ruajtja dhe ripërtirja e rezeravave natyrore të ujërave
- ruajtja dhe mbrojtja e objekteve e dukurive të veçanta si raritete hidrike: gurrat karstike, liqenet glaciale, ujëvaret, humbujërat-ponorët etj.

Pas shpalljes së Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional do të bëhet studimi i detajuar i kushteve hidrike dhe do të përcaktohen kriteret dhe masat e përkujdesit ndaj fenomeneve e dukurive hidrike me vlerë të veçant (në zonat e mbrojtura strikte, zonat e përkujdesjes dhe zona e zhvillimit)

4.7. BIODIVERSITETI

Në artikullin 2 të Konventës për Diversitetin Biologjik (Rio de Zhaneiro, Qershor 1992) Biodiversiteti përkufizohet:

“Ndryshueshmëria midis organizmave të gjallë që jetojnë në ekosistemet tokësore, detare dhe ekosisteme të tjera ujore dhe komplekset ekologjike, në të cilat ato bëjnë pjesë; kjo përfshin diversitetin brenda llojit, midis llojeve dhe ekosistemeve”

Me fjalë të tjera, termi diversitet biologjik shpreh numrin dhe gjithë larminë e organizmave të gjallë në Planet. Brenda këtij termi përfshihet diversiteti i gjeneve, llojeve dhe ekosistemeve që janë produkt i një procesi evolutiv prej më se 3 miliardë vjet. Njerëzimi dhe mbijetesa e tij varet nga ky diversitet biologjik. Në këtë kuptim termi diversitet biologjik është sinonim i termit “ Jeta në planet”.

4.7.1. FLORA DHE VEGJETACIONI I BJESHKËVE TË NEMUNA

Bjeshkët e Nemuna janë ndër masivet malore më karakteristike të Ballkanit për sa i përket begatëshmërisë floristike dhe vegjetative.

Në Kosovë ky masiv malor përfshinë një regjion të gjërë duke filluar nga rrjedha e lumit Ibër në veri e deri te Qafa e Morinës në jug, ndërsa në lindje kufizohet me pjesët rrafshinore të Dukagjinit. Bjeshkët e Nemuna edhe pse janë mjaft të reja krahasuar me disa masive malore të Evropës, paraqesin një kompleks të ndërlikuar i përbërë prej maleve të larta ku 9 maje malore arrijnë lartësi mbidetare edhe mbi 2000 metra, ndërsa Guri i verdhë, Marjashi, Ropsi dhe Gjeravica edhe mbi 2500 metra.

Bjeshkët e Nemuna përmes grykave të lumenjve Lumbardhi i Pejës dhe i Deçanit janë të ndara në tri grupe. Grupin e parë e formojnë bjeshkët të cilat shtrihen në veri dhe verilindje të Lumbardhit të Pejës ku marrin pjesë Zhlebi, Maja e Rusolisë, Hajla, Bjeshkët e Begut, Maja e Hasanit, Shtedimi etj. Grupin e dytë e formojnë bjeshkët në mes të Lumbardhit të Pejës dhe atij të Deçanit ku përfshihen Koprivniku, Leçinati, Bjeshkët e Strellcit dhe të Lumbardhit, etj. Grupin e tretë e formojnë bjeshkët në mes të Lumbardhit të Deçanit deri në kufi me Shqipërinë ku marrin pjesë Bjeshkët e Deçanit dhe Junikut (Gjeravica, Ropsi, Marjashi, Kurvalla etj.).

Edhe pse në aspektin hapsinor Bjeshkët e Nemuna i takojnë regjionit me klimë kontinentale, këto janë edhe nën ndikimin e klimës mesdhetare, përkatësisht submesdhetare e cila depërton përmes luginës së Drinit të Bardhë, kështu që në pjesët e ulta të këtij masivi malor paraqitet klima e modifikuar mesdhetare, ndërsa në pjesët më të larta ajo tipike alpine. Ky gërshetim i klimës submesdhetare dhe asaj kontinentale kanë krijuar një kompleks të ndërlikuar të kushteve ekologjike që kanë mundësuar paraqitjen dhe ekzistencën e florës dhe vegjetacionit të begatshëm dhe të llojllojshëm me prani të formave drunore, shkurre dhe barishtore ndër të cilat një numër i konsideruar i tyre janë relikte, endemorelikte dhe endemike autoktone, të Ballkanit dhe Evropës. Në këtë aspekt Bjeshkët e Nemuna paraqesin masivin malor më të begatshëm në Ballkan me prani të mbi 1000 llojeve deri më tani të hulumtuara, edhe pse ky numër nuk është definitiv meqenëse hulumtimet duhet vazhduar edhe mëtej. Pos kësaj, në këtë numër nuk janë të përfshira hulumtimet për myshqet, likenet dhe kërpudhat.

Në aspektin e shtrirjes vertikale të vegjetacionit pjesën më të madhe të masivit malor të Bjeshkëve të Nemuna në pjesën e poshtme e përfshinë vegjetacioni gjetherënës, në atë të epërme ai halor, ndërsa mbi kufirin e epërm pyjor gjendet vegjetacioni i kullotave dhe livadheve si dhe ai alpin. Në pyjet gjetherënëse dominojnë ato të dushkut dhe ahut, ndërsa në ato halore të bredhit, hormoqit, rrobullit dhe arnenit.

Vegjetacioni (mbulesa bimore) kuptohet si një mozaik i ndërlikuar dhe kompleks i bashkësive bimore të cilat në hapësirë ndryshohen pak a shumë në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me ndryshimet e kushteve të ambijentit (klimës (makro, mezo dhe mikroklimës), relievit, përbërjes gjeologjike, përbërjes pedologjike si dhe kushteve hidrologjike. Kështu, vegjetacioni i Bjeshkëve të Nemuna ka pësuar ndryshime gjatë procesit të gjatë të zhvillimit historik të tij. Të gjitha llojet bimore të cilat e mbijetuan

periudhën e akullnajave së bashku me lloje të reja të krijuara pas diluviumit, sot ndërtojnë bashkësi bimore (fitocenoza) të ndryshme ku disa prej tyre janë karakteristike për Bjeshkët e Nemuna.

Vegjetacioni i Bjeshkëve të Nemuna mund të kategorizohet në tre breza kryesor:

1. Brezi i ulët malor,
2. Brezi i mesëm dhe
3. Brezi i lartë malor.

Brezi i ulët malor është i përfaqësuar me aleancën Carpinion betuli illyrico – podolicum. Pyjet mezofile të *abut* dhe *bredhit* të cilat janë të zhvilluara në tokat bazike, neutrale apo pak a shumë acidike, i takojnë nënaleancës së Evropës Juglindore *Abieti – fagenion moesiacaе*.

Në kuadër të Bjeshkëve të Nemuna bëjnë deri më tani janë konstatuar këto asociacione:

1. *Ass. Abieti – Fagetum moesiacaе*,
2. *Ass. Fagetum subalpinum scardo – pindicum*,
3. *Ass. Picetum abietis bertisceum montanum*,
4. *Ass. Picetum abietis bertisceum subalpinum*,
5. *Ass. Eulfenio – Pinetum peucis*,
6. *Ass. Pinetum peucis typicum*,
7. *Ass. Pinetum heldreichii bertisceum*,
8. *Ass. Eulfenio – Pinetum mugo*,
9. *Ass. Bruckenthalio – Juniperetum*,
10. *Ass. Nardetum subalpinum montenegrinum*,
11. *Ass. Salicetum herbaceae balcanicum*,
12. *Ass. Pinguiculo – Narthecium scardici*,
13. *Ass. Carici Crepidetum dinaricae*,
14. *Ass. Festucetum albanicae* dhe
15. *Ass. Senecio – Rumicetum alpini*.

Ass. Abieti – Fagetum moesiacaе është i zhvilluar mirë dhe përfshinë brezin prej 1300 – 1500 m. l. mb. Në disa lokalitete mungon *bredhi*, por kjo në të vërtetë paraqet një dukuri sekondare që erdhi si rezultat i veprimit negativ antropogjen.

Ass. Fagetum subalpinum scardo – pindicum lajmërohet në zonën subalpike mbi 1500 m. Dhe në disa raste paraqet zonën e fundit të pyllit. Pylli i ahut subalpike është zhvilluar në formë zonale ku atakohet me fitocenoza të *bredhit*, hormoqit, arnenit dhe arnenit të bardhë deri te zona e kërlekës.

Ass. Picetum abietis bertisceum montanum zhvillohet zakonisht në zonën e ahut ose në zonën e ahut të përzier me *bredh*. Në shumë vende hormoqi dhe *bredhi* zgjerohen dhe luajnë rol dominues.

Ass. Pinetum abietis bertisceum subalpinum shtrihet në lartësi mbidetare 1600 – 1800 m. Kjo fitocenoza ka pamje mjaft impozante dhe në territorin e Bjeshkëve të Nemuna zënë një sipërfaqe të konsiderueshme.

Arneni i bardhë është endem dhe reliket dhe në Bjeshkët e Nemuna është mjaft mirë i prezentuar dhe formon dy fitocenoza: *Ass. Eulfenio – Pinetum peucis* dhe *Ass. Pinetum peucis typicum*. Është i përhapur në ekspozicionin verior dhe verilindor (Gjeravicë). Në këto fitocenoza dominon *arneni i bardhë (Pinus peuce)*, por janë të pranishme edhe *hormoqi* dhe *bredhi*.

Fitocenoza mjaft e rëndësishme që shtrihet në shkëmbinjë gëlqeror në lartësi 1500 – 1800 është *Ass. Pinetum heldreichii bertisceum*. Si edificator dhe bimë dominuese në këtë fitocenoza është *arneni (Pinus heldreichii)*.

Zona më e lartë dhe e fundit e vegjetacionit të pyllit të Bjeshkëve të Nemuna përfaqësohet nga *Ass. Eulfenio – pinetum mugo*. Kjo fitocenoza është mjaft e zhvilluar në shkëmbinjë gëlqeror. Shtrihet nga zona subalpike dhe mund të arrijë deri në mbi 2000 m. l. mb. Është fitocenoza endemorelikte dhe luan rol me rëndësi për ruajtjen e tokës nga erozioni.

Nga klasa *Aspleniatae trichomanis* e cila përfshinë fitocenozat në të çarat e shkëmbinjëve gëlqeror, është i njohur rendi *Amphoricarpetalia bertiscei* me dy aleanca: *Amphoricarpion bertiscei* dhe *Amphoricarpion neumayeri*. Këto fitocenoza janë prezente në nëpër shkëmbinjët gëlqeror të zonës subalpike dhe alpike të Bjeshkëve të Nemuna. Këto fitocenoza janë mjaft interesante dhe në pikëpamje shkencore të rëndësishme, sepse përmbajnë lloje relikte të kohës së terciarit.

Vegjetacioni në shkëmbinjë silikat është më i varfër me lloje dhe është i përfaqësuar me aleancën *Asplenieta – Silenetum lerchenfeldiana*.

Mbi zonën e fundit të pyllit subalpike, sidomos në shkëmbinjë silikat është i zhvilluar *Ass. Bruckenthalio – Juniperetum*. Në toka të zhvilluara mirë të zonës subalpike, pa marrë parasysh përbërjen gjeologjike, është e zhvilluar fitocenoza *Nardetum subalpinum montenegrinum*. Në vende me orteqe të borës të zonës subalpike dhe alpike është e zhvilluar fitocenoza *Salicetum herbaceae balcanicum*.

Në vende kënetore – malore të zonës subalpike dhe alpike të Bjeshkët e Nemuna është e zhvilluar fitocenoza *Pinguicula – Narthecium scardici*, e cila në Bjeshkët e Nemuna është mjaft prezente.

Në kuadër të vegjetacionit të kullosave subalpike dhe alpike të bjeshkëve të Nemuna vend me rëndësi zënë *Ass. Carici – Crepidetum dinaricae* dhe *Ass. Festucetum albanicae*.

Në Bjeshkët e nemuna është i zhvilluar mirë edhe vegjetacioni i tëbanëve (torishteve) i përfaqësuar me *Ass. Senecio – Rumicetum alpini*, i cili shtrihet zakonisht në zonën subalpike.

Në pyjet e dushkut të cilat shtrihen në sipërfaqe të mëdha në lartësi mbidetare prej 300 deri 900 m dominojnë llojet *Quercus cerris (qarr)*, *Quercus frainetto (shpardhi)*, *Quercus pubescens (bungbuta)* dhe *Quercus petraea (bungu)*, por me prani edhe të shumë llojeve tjera drunore, shkurre dhe barishtore. Në pyjet e

dushkut me karakter termofil pos llojeve dominuese te shpardhit, qarrit dhe bungbutës gjendet edhe llojet *Acer pseudoplatanus* (panja e malit), *Acer tataricum* (ulëza), *Acer campestre* (krekëza), *Carpinus orientalis* (shkozë e zezë), *Fraxinus ornus* (frashëri), *Ostrya carpinifolia* (mëllezë), *Pirus communis* (dardha e egër), *Prunus avium* (qershia), *Coryllus avellana* (lajthia), *Crataegus monogyna* (murrizi njëthelbor), *Cornus mas* (thana), *Juniperus oxycedris* (dëllinja e kuqe), *Juniperus communis* (dëllinja e zezë) etj, ndërsa ndër bimët barishtore të cilat janë me shumicë dominojnë llojet *Festuca heterophylla* (bishpelëza gjethendryshme), *Dactylis glomerata* (telishi), *Veronica chamaedrys* (veronika dushkvoqël), *Fragaria vesca* (dredhëza), *Clinopodium vulgare* (klinopodi i rëndomtë), *Helloborus odoratus* (shpendra), *Melica uniflora* (bjelisha njëlulësbe), *Danna cornubiensis*, ndërsa më pak *Viola silvestris* (vjollca e argjend), *Primula vulgaris* (aguliçja e rëndomtë), *Lathyrus niger* (vingjra e zezë), *Lathyrus venetus* (vingjra veneciane), *Aremona agrimonoides* (aremonia si rodbëz), *Trifolium pignatti* (tërfili i Pignjatit) dhe shumë të tjera. Në suazë të këtyre pyjeve karakteristike janë pyjet e pastra ose te përziera të përbëra nga llojet e gjinisë *Quercus* (dushkut) dhe të llojit *Castanea sativa* (gështenjës) si relik i terciarit që shtrihen në mes të Pejës dhe Gjakovës, dhe të *Forsythia europaea* (boshtra) në Gubavc afër Pejës dhe rrethinë të Gjakovës.

Mbi brezin e këtyre pyjeve në lartësi mbidetare prej 600 deri 900 m shtrihen pyjet e dushkut me karakter më tepër mezokseroterm me dominim të llojit *Quercus petraea* (bungut), por edhe me prani të *Quercus cerris* (qarrit), *Pirus communis* (dardha e egër), *Sorbus torminalis* (vodhëviçja), *Acer intermedium* (pafti i Hirkonisë), *Coryllus avellana* (lajthia), *Crataegus monogyna* (murrizi njëthelbor), *Rosa canina* (trëndëfili i egër) etj. si dhe ato barishtore si *Veronica chamaedrys* (veronica dushkvoqël), *Festuca heterophylla* (bishpelëza gjethendryshme), *Helloborus odoratus* (shpendra), *Thymus serpyllum* (listra e hershme), *Lathyrus venetus* (vingjra veneciane), *Convallaria majalis* (lotzonja), *Trifolium pignatti* (tërfili i Pignjatit) dhe shumë të tjera.

Pyjet e ahut apo ahishtet të përbëra nga lloji *Fagus moesiaca* (abu) shtrihen në lartësi mbidetare prej 800 deri 1200m por edhe deri në 1500m. Në pjesën e poshtme këto pyje kufizohen me ato të dushkut, ndërsa në pjesën e epërme me ato të halorëve siç janë bredhi dhe hormoqi por edhe rrobulli duke formuar pyjet e përziera. Në këto pyje pos *Fagus moesica* (abut) si lloj dominues në disa lokalitete mjaft të pranishme janë edhe llojet *Ostrya carpinifolia* (mëllezë), *Quercus cerris* (qarrit), *Quercus petraea* (bungu), *Taxus baccata* (tisi), *Acer intermedium* (pafti i Hirkonisë), *Acer pseudoplatanus* (panja e malit), *Populus tremula* (plepi i egër), *Cornus sanguinea* (thanukla), *Coryllus avellana* (lajthia), *Rosa canina* (trëndëfili i egër) si dhe *Pinus heldreichii* (rrobulli). Në katet e poshtme janë të pranishëm numër i madh i llojeve barishtore numri i të cilëve sipas disa të dhënave sillet rreth 110, ndër të cilat edhe *Anemona nemorosa* (fillikatja e pyllit), *Euphorbia amygdaloides* (qymshtorja si bajame), *Cardamine bulbifera* (kardamini me qepujkë), *Festuca heterophylla* (bishpelëza gjethendryshme), *Geranium robertianum* (kamoroshja e Robertit), *Asperula odorata* (njëgjira), *Stellaria hollostea* (stellaria e pyllit), *Lilium martagon* (zambaku tridhëbota) etj.

Buzë shtratit të prrockave dhe lumenjëve të Bjeshëve të Nemuna me shumicë është i përhapur lloji *Alnus glutinosa* (verri).

Mbi ahishtet shtrihet zona e halorëve ku rolin kryesor e kanë llojet *Abies alba* (bredhit) dhe *Picea abies* (hormoqi). Pyjet e këtyre dy llojeve të halorëve në zonat e shtrirjes së tyre më së shpeshti janë të përziara, por paraqiten edhe si të pastra. Në zonat më të ulta më tepër hasen pyjet e hormoqit, kurse në ato më të larta ato të bredhit. Në pjesën e poshtme të shtrirjes së tyre këto pyje përzihen me ato të ahut, kurse në zonën e epërme me ato të *Pinus heldreichii* (rrobullit) dhe *Pinus peuce* (arnenit). Edhe në këto pyje në katet e poshtme janë të pranishme lloje të shumta të bimëve barishtore.

Brezin më të lartë pyjor i cili arrinë deri në lartësi mbidetare prej 2000 deri 2200 metra e formojnë llojet e halorëve endemorelikt të terciarit *Pinus heldreichii* (rrobullit) dhe *Pinus peuce* (arnenit). Në kufirin e poshtëm këto lloje përzihen me ato të bredhit, hormoqit por edhe të ahut, kurse në atë të epërm me format shkurre të *Pinus mugo* (kërleka), *Juniperus nana* (dëllinja rrëgjuar), *Juniperus intermedia* (dëllinja), *Vaccinium myrtillus* (trashëgra), *Vaccinium uliginosum* (legjithja). Deri më sot janë të determinuara 15 asociacione varsisht prej llojit dominues dhe subdominues. Këto asociacione janë të begatshme me prani të numrit të madh të llojeve barishtore. Ndër llojet barishtore pos tjerash të pranishme janë edhe *Verbascum nikolaii* (barpeshku i pluburosur), *Ēulfenia bleicicii* (vulfenia e Bleçiçit), *Helleborus purpureus* (shpendra purpure), *Luzula luzulina* (luzula si luzul), *Anemona nemorosa* (fillikatja e pyllit), *Festuca heterophylla* (bishtpelëza gjethendryshme), *Saxifraga rotundifolia* (iriqëza gjethe rrumbullakët) etj.

Në kufirin e epërm pyjor pos llojeve të përmendura gjenden edhe *Senecio alpinum* (pulithi alpin), *Rhamus falax* (pjërezja), *Soldanella alpina* (pratisbi alpin), *Lonicera nigra* (lonicera e zezë), *Hieracium alpinum* (këmashna alpine), *Lilium albanicum* (zambaku shqiptar), *Geum bulgaricum* (mëlaka bulgare), *Asperula odorata* (njëgjira), *Luzula nemorosa* (luzula), *Anthemis montana* (syriçja), *Dryas octopetala* (driada tetëpetlash) etj.

Mbi kufirin e epërm të pyjeve është i përhapur vegjetacioni i kullotave parësore dhe dytësore të cilat në masë të madhe janë të degraduara nga veprimi i faktorit zooantropogjen. Në shumicën e tyre sot dominon lloji *Nardus stricta* (xhufka), por me prani edhe të llojeve tjera barishtore ndër të cilat edhe *Centaurea nervosa* (kokoçek), *Polygonum bistorta* (nejca dylëfrytshme), *Dianthus superbus*, *Gentiana graminea* (genciana), *Hypericum quadrangulum* (lulebalsami katër flatërshe) si dhe bashkësitë ku dominon *Dryas octopetala* (driada tetëpetlash) si lloj relikto glacial.

Në pjesët më të larta të Bjeshëve të Nemuna, në zonën e shkëmbinjve është i përhapur vegjetacioni alpin në të cilin dominojnë llojet barishtore një dhe shumë vjeçare të përshtatura kushteve të tilla jetësore. Në këto rajone gjenden edhe mjaft lloje endemike autoktone dhe të Ballkanit.

Në aspektin floristik duke pasur parasysh pozitën e tyre gjeografike dhe kushtet klimatike Bjeshkët e Nemuna karakterizohen me një begatshmëri të madhe të pranisë së llojeve drunore, shkurre dhe

barishtore, ndër të cilat një numër i konsideruar i tyre janë relikte, endemike dhe subendemike. Sipas të dhënave të deritanishme në Bjeshkët e Nemuna janë të pranishme 33 lloje endemike dhe 6 subendemike si dhe mjaft lloje relikte të cilat patjetër duhet të vehen nën mbrojtje rigoroze duke pasur parasysh vlerat e tyre shkencore dhe ekonomike.

Nga llojet relikte të përhapura në Bjeshkët e Nemuna karakteristike janë: *Carpinus orientalis* (shkoza e zezë) e përhapur në kuadër të pyjeve të dushkut dhe ahut. Në Grykën e Rugovës gjenden në ekspozicionin verior, ndërsa në Malin e Thatë, Bjeshkët e Sinajit dhe Lebeniq në ekspozicionin jugor. Në afërsi të Bisticës së Lloçanit së bashku me te paraqitet edhe *Carpinus betulus* (shkoza e bardhë) i cili poashtu është relik i terciarit.

Në hapsirat e Koprivnikut, Zhlebit dhe Mokrës është i përhapur lloji *Acer heldreichii* (panja) si lloj relik i terciarit dhe endemik i Ballkanit. Në pyjet gjetherënëse në shumë vende të Koprivnikut, Kozhnjerit, Grykës së Rugovës dhe mes Deçanit dhe Junikut janë të pranishëm edhe *Acer intermedium* (pafti i Hirkonisë), *Acer tataricum* (ulëza), posaçërisht aty ku është e pranishme edhe *Ostrya carpinifolia* (mëllezë).

Lloji *Taxus baccata* (tisi), poashtu relik i terciarit me shumicë është i përhapur në Lubeniç dhe është nën mbrojtje rigoroze. *Pinus peuce* (arneni) si endemik i Ballkanit është i përhapur në shumë rajone të Bjeshkëve të Nemuna duke formuar pyje të dendura si dhe *Pinus heldreichii* (rrbulli) në Stupel, Maja e Velakutit, Shkovran dhe Stanet e Bellopojës poashtu si relik i terciarit.

Në rajonet në mes të Pejës dhe Deçanit formon pyje të pastra por edhe të përziera me pyjet e dushkut lloji relik *Castanea sativa* (gështenja) që ka një rëndësi të madhe shkencore dhe ekonomike, ndërsa në Gubavc dhe regjionin e Gjakovës gjendet lloji endemorelik i Kosovës dhe Shqipërisë *Forsythia europaea* (boshtra) e cila në Gubavc është nën mbrojtje ligjore. Ky lloj në tërë sipërfaqën e Kosovës ku është i përhapur duhet patjetër të vëhet nën mbrojtje rigoroze duke pasur parasysh rëndësinë e tij sidomos atë shkencore dhe ekonomike.

Në pyjet e dushkut në Rops, Kozhnjer, Baballoq e gjetiu është i pranishëm lloji *Corylus colurna* (lajthia e egër) si lloj i cili patjetër duhet të vëhet në mbrojtje. Poashtu, duhet përmendur edhe praninë e llojit *Pinus silvestris* (pisha e bardhë) në Marjash, Rashkodol dhe Koprivnik si lloj mjaft i rrallë në viset tona.

Bjeshkët e Nemuna i begatojnë edhe llojet endemike barishtore autoktone dhe të Ballkanit me vlera të larta shkencore, farmaceutike etj. të përhapura më së shumti në viset e larta malore të zonës subalpine dhe alpine.

Në kuadër të llojeve endemike vlenë të përmendet se në Bjeshkët e nemuna vetëm në zonën alpikë dhe subalpikë janë prezente 128 lloje endemike të Ballkanit.

Ndër llojet endemike të Kosovës në Bjeshkët e Nemuna janë edhe *Sempervivum kosaninii* (burgulli i Koshaninit) në Bogiçevicë, Leçinat, Plloçicë, Dervish Kom, *Cephalaria pastricensis* (cefalaria e Pashtrikut) në

Bjeshkët e Lumbardhit, Zhleb dhe e cila është në rrezik të zhdukjes, *Astragalus fialae* (*arrithja e Fialit*) në Bjeshkët e Lumbardhit, *Aconitum pentheri* (*akoniti i Rusolisë*) në Zhleb dhe Rusoli, *Rubus ipecensis* (*manaferra e Pejës*) në Gubavc (në rrezik të zhdukjes), *Saxifraga scardica* (*iriqëza e Sharrit*) në Leçinat dhe Koprivnik (lloj i rrezikuar), *Ēulfenia bleicii* (*vulfenia e Bleçiqit*) në Leçinat, Zhleb, Koprivnik dhe Strelc; *Centaurea nervosa* (kokoçeli), *Tblaspi cuneifolium* (*tlaspi*) në Leçinat dhe Gurin e Verdhë, *Thymus roblenae* (*lištra e Rohleries*) në rrethinën e Deçanit, etj.

Pos llojeve endemike autoktone në Bjeshkët e Nemuna janë të pranishme edhe shumë lloje endemike të Ballkanit ndër të cilat edhe *Crepis albanica* (*shmanga shqiptare*) në zonën subalpine të Bjeshkëve të Lumbardhit (e rrezikuar), *Draba korabensis* (*draba e Korabit*) në Gjeravicë, Marjash, Leçinat (në rrezik zhdukjes), *Cerastium dinaricum* (*cerasti dinarik*) në Gjeravicë dhe në rrezik të zhdukjes së plotë, *Sempervivum macedonicum* (*burgulli maqedonas*) në Gjeravicë dhe Dervish Kom (në rrezik të zhdukjes), *Euphorbia montenegrina* (*qumshtorja malazeze*) në Kurvallë dhe Rusoli (në rrezik), *Lilium albanicum* (zambaku shqiptar), *Rumex balcanicus* (*lëpjeta e ballkanit*) në Gjeravicë, *Ranunculus scutatus* (*zhabina shqytake*) në Leçinat, Dervish Kom, Koprivnik, *Geum bulgaricum* (*mëlaka bulgarë*) sidomos në Rusoli, *Viola elegantula* (*vjollca pak e hijshme*) në Rusoli, Leçinat, Kurvallë, *Ligusticum albanicum* (*liguistiku shqiptar*) në zonën alpine, *Fumaria bonopartei* (*lule pllumbi i bonopartes*) në rrethinën e Pejës, *Teucrium arduini* (*arrëzi i Arduinit*) në Grykën e Rugovës etj.

Poashtu, duhet përmendur edhe llojet *Gentiana lutea* (*sanza*) në Gjeravicë dhe Çvrlë (në rrezik të zhdukjes), *Leontopodium alpinum* (*luleylli*) në Koprivnik, Rusoli, Hajl etj., *Potentilla apenina* (*zorëca e apenineve*) në Leçinat dhe Bogiçevicë, *Narthecium scardicum* (*narteci i Sharrit*) etj.

Nga kjo shihet se në aspektin vegetativ dhe floristik në Bjeshkët e Nemuna më të pasura me lloje të rralla dhe endemike janë masivi i Gjeravicës, Leçinatit, Lumbardit, Hajlës dhe Zhlebit.

Arsyetimin e këtij studimi edhe më të fuqishëm e bënë fakti se gati në secilin studim floristik apo vegetativ të kryer në nivel magistrature apo doktorate janë konstatuar dhjetra taksonë të reja për florën e Kosovës por edhe për florën e bjeshkëve të Nemuna.

Për shkak të rrezikut nga zhdukja e tyre në European Red List, UNESCO (1991), Neë York gjenden këto lloje të përhapura në Bjeshkët e Nemuna: *Viola elegantula* (*vjollca pak e hijshme*), *Sempervivum macedonicum* (*burgulli maqedonas*), *Narthecium scardicum* (*narteci i Sharrit*), *Ēulfenia bleicii* (*vulfenia e Bleçiqit*), *Verbascum nicolaii* (*bar peshku i Nikolait*) dhe *Sempervivum kosaninii* (*burgulli i koshaninit*).

Poashtu, për të ruajtur fondin e bimësisë të Bjeshkëve të Nemuna një numër i konsiderueshëm i llojeve drunore, shkurre dhe barishtore për shkak të vlerave të tyre duhet të përfshihen në Librin e Kuq të Kosovës i cili do të hartohet. Ndër to janë edhe *Acer heldreichii* (*panja e bedrahit*), *Taxus baccata* (*tisi*), *Castanea sativa* (*gështenja*), *Juglans regia* (*arra*), *Pinus heldreichii* (*rrobulli*), *Pinus peuce* (*arneni*), *Pinus mugo* (*kërleka*), *Quercus trojana* (*bunbuta*), *Forsythia europaea* (*boshtra*), *Alnus viridis* (*vërrri*), *Achillea clavennae* (*barpezmi çomagë*),

Achillea lingulata (barpezmi gjubëzore), *Aconitum divergens* (akoniti), *Arcostaphylos uva – ursi* (rrusharusha), *Aster alpinus* (asteri alpin), *Centaurea kosaninii* (kokoçeli i Koshaninit), *Cicerbita pancicii* (cicerbita e Pançicit), *Crepis dinarica* (shmanga dinarike), *Cyclamen europaeum* (bukëderri evropian), *Daphne alpina* (xerxolja alpine), *Daphne blagayana* (xerxolja e Blagajit), *Daphne laureola* (dafinëz), *Dianthus superbus* (karafil), *Draba korabensis* (draba e Korabit), *Draba scardica* (draba e Sharrit), *Gentiana lutea* (sanëza), *Gentiana punctata* (sanëza pikaloshe), *Geum bulgaricum* (mëlaka bulgare), *Hesperis dinarica* (hesperi dinarik), *Leontopodium alpinum* (luleylli), *Lilium albanicum* (zambaku shqiptar), *Listera cordata* (listera), *Plantago reniformis* (gjethe si veshkë), *Potentilla montenegrina* (zorëca malazeze), *Primula minima* (agulicja e vogël), *Ribes grossularia* (rrushfrëngu), *Saxifraga aizoon* (iriqëza si thonjëz), *Saxifraga stellaris* (iriqëza yllake), *Scrophyllaria bosniaca* (sarusha boshnjake), *Sempervivum macedonicum* (burgulli maqedonas), *Sedum magellense* (rrushqyqja e Magelenës), *Viola zoysii* (vjollca me shpor), *Ëulfenia bleicii* (vulfenia e Bleçicit) dhe disa të tjera.

Për shkak të rrezikut nga zhdukja disa lloje janë vënë nën mbrojtje rigoroze ndër të cilat edhe *Pinus heldreichii* (rrobulli), *Pinus peuce* (arneni), *Pinus mugo* (kërleka), *Acer heldreichii* (panja e Heldrabut), *Acer intermedium* (pafti i Hirkanisë), *Forsythia europaea* (boshtra), *Taxus baccata* (tisi), *Quercus trojana* (bungëbuta), *Spirea cana* (spirea), *Alnus viridis* (vërr), *Ëulfenia bleicii* (vulfenia e Bleçicit), *Leontopodium alpinum* (luleylli), *Lilium mertagon* (zambaku trithëbota), *Gentiana lutea* (sanëza), *Daphne laureola* (xerxolja dafinëz), *Succisa pratensis* (suciza e livadhit) dhe disa të tjera.

Nga llojet që duhet të jenë në kontroll të shfrytëzimit të tyre janë edhe *Juniperus communis* (dëllinja e zezë), *Vaccinium vitis-idea* (trashëgra rrush-mjedër), *Vaccinium myrtillus* (trashëgra mërsinë), *Sambucus nigra* (shtogu i zi), *Arcostaphylos uva-ursi* (rrusharusha), *Gentiana punctata* (sanëza pikaloshe), *Gentiana asclepiadea* (genciana e asklepit), *Valeriana officinalis* (haraqina mjekësore), *Fragaria vesca* (luleshtrydhja), *Hypericum perforatum* (lulja e balsamit e shpuar), *Potentilla erecta* (zorëca e përpyetë), *Pulmonaria officinalis* (pulmonaria mjekësore), *Atropa beladonna* (helmarina), *Colchicum autumnale* (xhërrokulli vjeshtor), *Primula veris* (agulicja e vërtet), *Thymus sp.* (listra e rëndomtë), *Origanum vulgare* (rigoni i zakonshëm), *Digitalis ferruginea* (lulëtokëza ngjyrëndryshme), *Cyclamen europaeum* (bukëderri evropian), *Solidago virgaurea* (solidaga shufërtë), *Trollius europaeus* (trolli i evropës), *Carlina acualis* (ushonjëza pa kërcell), *Convolvularia majalis* (lotzonja), *Teucrium montanum* (arrëzi malor), *Hepaticanobilis* (hepatika), *Athyrium filix-femina* (atiri fier femër) etj.

Mirëpo, duhet cekur se flora dhe vegetacioni i Bjeshkëve të Nemuna është në rrezik të përhershëm nga shkatërrimi dhe zhdukja si rezultat i veprimit të pakontrolluar të faktorit antropogjen, gjë që mund të sjellë deri te paraqitja e shkreteitirave antropogjene dhe erozioneve me përmasa të mëdha.

Daljet në terren janë realizuar në bashkëpunim konstruktiv në mes të bashkëpunëtorëve profesional të Institutit për Mbrojtjen e Natyrës dhe Mjedisit të Kosovës dhe profesorëve të Fakultetit të Shkencave Matematike Naturore (nga Departamenti i Biologjisë). Terrenet janë realizuar në Burim dhe rrethinën e

tij, në Zhleb, Grykën e Rugovës, Bogaj, Leçinat etj. dhe janë vërtetuar përmasat e veprimit negativ të faktorit antropogjen i cili shprehet përmes prerjeve të mëdha të pyjeve. Poashtu, të dhënat tregojnë se edhe pyjet të cilat i takojnë Komunës së Deçanit janë shumë të atakuara nga prerja ilegale, djegia aksidentale ose me qëllim, sidomos në këto vitet e pasluftës, posaçërisht ato të ahishteve.

Prandaj, shpallja Bjeshtëve të Nemuna për Park Kombëtar është e arsyeshme, sepse në këtë mënyrë do të mundësohet ruajtja dhe mbrojtja e shumë llojeve të cilat përfaqësojnë begati natyrore me rëndësi shkencore, ekonomike, mjekësore, turistike etj.

Natyrisht, për aplikimin e një vendimi të tillë duhet të bëhen hulumtimet e duhura në terren për vlerësimin e gjendjes së florës dhe vegjetacionit, inventarizimi i plotë i llojeve të pranishme dhe arealet e tyre, vlerësimi i dëmtimeve etj. Këto hulumtime kërkojnë një kohë më të gjatë, dalje në terren të ekipeve të specializuara për hulumtime të tilla, përcaktimi i llojeve të rrezikuara dhe atyre të rralla, rreziku i zhdukjes së tyre etj.

4.7.2. VEÇORITË FAUNISTIKE TË BJESHKËVE TË NEMUNA

Territori i Bjeshtëve të Nemuna shquhet për shumëllojshmëri biologjike e peisazhore, falë pozicionit gjeografik, kushteve gjeologjike, pedologjike, hidrologjike dhe karakteristikave të relievit e të klimës. Relievi i thyer dhe vertikalishteti i theksuar ofrojnë kushte për ekzistencën dhe ruajtjen e një numri të madh llojesh bimore dhe shtazore.

Bjeshtët e Nemuna dhe Kosova në përgjithësi nga aspekti faunistik i përkasin rajonit Hollarktik përkatësisht nënrajonit Euro-Siberian. Karakterizohet me një faunë mjaftë të pasur, heterogjene, endemike dhe interesante. Kjo pasuri faunistike e Kosovës e me të edhe e Bjeshtëve të Nemuna, si masivi më i madh në Ballkan, është si rezultat i ndikimeve të shumta të regjionit mesdhetar, eurosiberian dhe atij nordiko-alpin, si dhe ndryshimeve të shpeshta të kushteve ekologjike në të kaluarën.


Në territorin e Bjeshtëve të Nemuna gjenden lloje të gjitarëve dhe shpendëve e që janë mjaft të rralla për rajonin e Ballkanit dhe më gjërë, prej tyre janë relikte, endemike, të kërcënuara nga zhdukja dhe për këtë arsye gjenden në listat dhe në librat e kuq ndërkombëtar.

Në bazë të hulumtimeve të gjertanishme dhe në bazë të shënimeve të literaturës fauna e Bjeshtëve të Nemuna përbëhet prej: 8 lloje peshqish, 13 lloje ujëtoksorësh, 10 lloje zvarranikësh, 148 lloje shpendësh

(sipas disa të dhënave më të reja 175 lloje, ndërsa mendohet të ketë mbi 200 lloje), 37 lloje gjitarësh dhe 129 lloje flutura vetëm nga rendi Lepidoptera.

Llojet më reprezentative të faunës së Kosovës që jetojnë në territorin e Bjeshkëve të Nemuna siç janë: luqerbulli (*Lynx lynx*), ariu i murrëm (*Ursus arctos*), kaprolli (*Capreolus capreolus*), dhia e egër (*Rupicapra rupicapra*), shqiponja perandorake (*Aquila heliaca*), shqiponja e maleve (*Aquila chrysaetos*), faikoi thonjëbardhë (*Falco naummani*), pulëegra (*Tetrao urogallus*) etj, kanë status kombëtar dhe ndërkombëtar të mbrojtur. Ato gjenden në listën e IUCN-së (Unioni botëror për ruajtjen e natyrës), EU-RL (Lista e kuqe Europiane), ËR-RL (Lista e kuqe botërore), LKSH (Libri i kuq i Shqipërisë), LKGJ (Ligji i Kosovës për gjuetinë) etj.

Fig.3. Përbërja e faunës së Bjeshkëve të Nemuna sipas numrit të llojeve



ICHTIOFAUNA (Peshqit)

Territori i Bjeshkëve të Nemuna prehet nga përrenjë të shumtë, kurse rrjedhje kryesore paraqet Bistrica e Pejës e cila i përket rrjedhjes adriatike. Sipas karakteristikës ichtiologjike këto rrjedha i takojnë tipit të ujrave Salmonide, vendbanimi i të cilave përbëhet kryesisht nga popullacioni i dy llojeve të troftës: troftës së përroit (*Salmo trutta m. fario L. dhe Salmo marmoratus C.*)

Të gjithë këto lloje të peshqëve janë banorë të ujërave të rrjedhjeve të epërme të lumit të Pejës, Deçanit, Erenikut kurse në rrjedhat e poshtme më tepër janë të pranishëm peshqit e familjes Ciprinide. Është karakteristike për këto rrjedha të ujit se asnjëherë, as gjatë kohës së thatësive më të mëdha nuk shterrin. Të gjitha i karakterizon rrjedhja e shpejtë e kushtëzuar me pjerrësinë e terrenit. Kur ka reshje të mëdha, shkrirje të borës këta turbullohen dhe bëhen të patejdukshëm. Regjimi i temperaturës së ujrave është relativisht stabil, dhe këto nuk janë të ndotura me ujëra industriale dhe të xeherorëve.

Në bazë të hulumtimeve të deritanishme dhe shënimeve të literaturës në ujrata e Bjeshkëve të Nemuna jetojnë këto lloje peshqish:

trofta e përroit (*Salmo trutta m. fario* L.), trofta (*Salmo marmoratus* C), mushiku i përroit (*Barbus fluviatilis* Ag.), ngjala (*Anquilla vulgaris*), bërcaku (*Squalius cephalus* L.), krapa (*Cyprinus carpio*), mlyshi (*Esox lucius*), krapuliqi.

HERPETOFAUNA

Bjeshkët e Nemuna për nga përbërja e faunës së ujëtoksorëve dhe zvarranikëve paraqesin vendin më të rëndësishëm të Gadishullit Ballkanik. Në bazë të hulumtimeve të gjertanishme herpetofauna përbëhet prej: 23 llojeve dhe atë 13 ujëtoksor dhe 10 rrëshqitës.

Ujëtokësorët (*Amphibia*)

Numri më i madh i ujëtoksorëve është i lidhur për ambientin ujor vetëm në periodën e shumimit dhe të lëshimit të veve, ndërsa periodën tjetër e kalojnë në vende të lagështa siq : nën rrënjë, gjethe të rëna, gropa dhe në vende të tjera ku ka mjaftë lagështi.

Prej ujëtoksorëve me bisht (*Urodela*) prezente është familja e picrrakëve (*Salamandridae*) me 2 gjini dhe 6 lloje. Llojet më karakteristike të familjes Salamandridae janë: picrraku (*Salamandra salamandra*) dhe picrraku i zi (*Salamandra atra*). Në liqenjtë e Drelajve dhe të Leqinatit si dhe në kneta jeton tritoni i vogël (*Triturus vulgaris*) i cili ekskluzivisht është i lidhur për mjedisin ujor. Po ashtu në Bjeshkët e Nemuna jetojnë edhe llojet tjera të kësaj gjinie siq: tritoni i madh (*Triturus carnifex*), tritoni i maleve (*Triturus alpestris*), *Triturus cristatus* (subspec.).

Ujëtokësorët pa bisht (*Anura*), hasen pranë vendeve të lagështa në pyje ose pranë sipërfaqeve të ujit, ndërsa disa lloje të bretëkosave siq janë bishtëfultërzat dhe disa tjerë zhvillohen ekskluzivisht në ambient ujor. Ky rend përfaqësohet nga 5 familje dhe afërsisht me 7 lloje. Familja **Discoglosidae** me llojin bretkosa barkëverdhe (*Bombina variegata*); Familja **Bufo** (*Bufo bufo*), familja **Ranidae** me llojet: bretkosa e

pyllit e kuqërreme (*Rana temporaria*), bretkosa e përrenjëve (*Rana graeca*), bretkosa e madhe e knetave (*Rana ridibunda*) dhe bretkosa kërcimtare (*Rana dalmatina*); familja **Hylidae** me llojin gargaliqi (*Hyla arborea*).

*Këtu duhet veçuar se llojeve të familjes Ranidae siq bretkosës së kuqërreme të pyllit (*Rana temporaria*), bretkosës së përrenjëve (*Rana graeca*) i kanoset rreziku për shkak të gjetisë së pakontrolluar.*

Zvarranikët (*Reptilia*)

Grupin e zvarranikëve në territorin e Bjeshkëve të Nemuna e përbëjnë: 5 familje me 10 lloje. Familja **Testudinæ** me llojet: breshka e pyllit (*Testudo hermani*) dhe breshkujza (*Emys orbicularis*); familja **Lacertidae** me llojet: hardhuca e gjelbër (*Lacerta viridis*), hardhuca e mureve (*Podarcis muralis*) dhe hardhuca e përhimtë (*lacerta agilis*); familja **Anguidæ** me llojin kokëzogëza (*Anguis fragilis*); familja **Viperidae** me nepërken (*Vipera ammodytes*) një prej gjarpërinjëve më helmues, i cili jeton në vendet shkëmbore dhe vendet e tjera të thata. Familja **Colubrinae** pëfaqësohet me dy lloje të gjarpërinjëve johelmues siq gjarpri i madh i ujit (*Natrix natrix*), gjarpri i vogël i shiut (*Natrix tessellata*) të cilët jetojnë përgjatë lumenjëve, përrenjëve dhe vendqëndrimeve të tjera të ujit, si dhe bolla e shtëpisë (*Elaphe longissima*).

*Duhet potencuar se breshkës tokësore (*Testudo hermani*) i cili ka qenë shumë i përhapur në territorin e Bjeshkëve të Nemuna, veçanërisht në mjediset kodrinore dhe lugina, kobëve të fundit i kanoset rreziku nga zhdukja totale.*

ORNITOFUNA (*shpendët*)

Habitatet natyrore të bjeshkëve të Nemuna ofrojnë vendstrehim për shumë lloje të shpendëve, shumë prej tyre janë endemike dhe me status të pa favorshëm ruajtjeje në Ballkan dhe Evropë. Deri më sot janë vrojtuar 148 lloje, por mendohet të ketë mbi 200 lloje. Ruajtja e tyre ka karakter ndërkombëtar, për këtë arsye Bjeshkët e Nemuna janë evidencuar në listat Ndërkombëtare si IBA (Important Bird Area). Numri më i madh i llojeve të shpendëve kanë shtrirje jashtëzakonisht të gjërë prandaj mund të hasen në të gjitha pjesët e Bjeshkëve të Nemuna dhe më gjërë në vendet fqinjë, ndërsa një numër i vogël i shpendëve është i lidhur për lokalitete të ngushta përkatësisht vendqëndrime specifike siq është rasti me gjelin e egër të madh (*Tetrao urogallus*) posaqërisht i përhapur në Kozhnjer, Gjeravicë, Hajle, Rusoli, Shtedim. Në kohët e fundit ky shpend është mjaft i rralluar, është shumë i ndijshëm në zhurmë dhe në praninë e njeriut. Është i regjistruar në librin e kuq. Pastaj *Bonasa bonasia* e cila është konstatuar në Kozhnjer, Mokën, Bjeshkët e Junikut, Majën e Hasanit etj. Gjithashtu i kanoset rreziku thëllëzës gurore (*Alectoris graeca*) e përhapur në

Hajle, Rusoli, Gur të Kuq. Mandej *Perdix perdix* më tepër në lugina të lumenjëve dhe rrafshina, *Coturnix coturnix*, *Phasianus colchicus* etj. Të gjitha këto i takojnë familjes *Phasianidae*. Vlen të përmendet familja *Podicipedidae* me llojet *Tachybaptus ruficollis* dhe *Podiceps cristatus*, mandej familja *Ardeida* me llojin *Ardea cinerea*, familja *Ciconiidea* me llojin *Ciconia ciconia*, familja *Anatidae* me lojin *Anas platyrhynchos*, *Anas querquedula* dhe *Aythya ferina*. Familja *Accipitridae* ku janë shpendë grabitqarë me llojet më të njohura *Gyps fulvus*, *Accipiter gentiles*, *Accipiter nisus* e veqanërisht lloji *Aquila chrysetos* i cili është karakteristik për Bjeshkët e Nemuna, ka trup të fuqishëm dhe fluturim elegant me ngjyrë të zezë të puplave, ka madhësi 76 deri 89 cm, jeton e veqar në male e larta dhe shkëmbinjë të rrëpishëm. Përndryshe është e njohur me emrin shqiponja e malit. Ushqehet me gjitharë të vegjël, zvarranikë, shpendë dhe peshq. Është e përhapur në Bjeshkët e Junikut, Zhleb, mandej te Guri i Kuq, te Liqenati etj. Nga familja *Falconide* gjithashtu grabitqar vlen të përmendet *Falco naumanni*, *Falco tinnunculus*, *Falco subuteo*, *Falco biarmicus* dhe *Falco peregrinus*. Nga familja *Columbidae* llojet *Columba livia*, *Columba oenas*, *Columba pallumbus*, *Streptopelia decaocta*, *Streptopelia tutur*. Si familje tjetër me shumë individë është edhe *Strigidae* me llojet *Otus scops*, *Bubo bubo*, *Athene noctua*, *Strix aluxo* dhe *Asio flammeus*. Familja *Picidae* me llojet *Jynx torquilla*, *Picus canus*, *Picus viridis*, *Dryocopus martius*, *Dendrocopus major*, *Dendrocopus medius*, *Dendrocopus leucotos*, *Dendrocopus lilfordi*, *Picoides tridactylus*.

Duhet theksuar se në mesin e shpendëve që jetojnë në territorin e Bjeshkëve të Nemuna ekzistojnë lloje të cilat janë në regjistrin e Librit të kuq të Evropës, të cilave iu kanoset rreziku sikurse që janë: shqiponja perandorake (*Aquila heliaca*), fajkoi thonjëbardhë (*Falco naumanni*), mbreti i shkurtes (*Crex crex*), drobeja e madhe (*Otis tarda*) etj. Meqë shpendët paraqesin indikator të rëndësishëm për ndotjen e mjedisit me rastin e shpalljes së Bjeshkëve të Nemuna park kombëtar do të krijohen kushte për ruajtjen dhe mbrojtjen e një diversiteti kaq të pasur të ornitofaunës.

Sipas statusit migrator shpendët e Bjeshkëve të Nemuna ndahen në: banuese, shtegtare, kalimtare, endacake dhe dimëruese.

Tab.4.. Përbërja e ornitofaunës së Bjeshkëve të Nemuna në taksone

Rendi	PODICIPEDIFORMES	CICONIIFORMES	ANSERIFORMES	FALCONIFORMES	GALLIFORMES	CHARADRIFORMES	COLUMBIFORMES	CUCULIFORMES	STRIGIFORMES	CAPRIMULGIFORMES	APODIFORMES	CORACIFORMES	PICIFORMES	PASSERIFORMES	Gjithsej
Nr. i familjeve	1	2	1	2	4	1	1	1	1	1	1	3	1	21	41
Nr. i llojeve	2	2	3	17	9	2	5	1	6	1	2	3	10	85	148

Tab.5. Përbërja e ornitofaunës së Bjeshkëve të Nemuna në familje dhe lloje

Familje	Nr. i llojeve	Llojet
PODICIPEDIDAE	2	<i>Tachybaptus ruficollis</i> , <i>Podiceps cristatus</i>
ARDEIDAE	1	<i>Ardea cinerea</i>
CICONIDAE	1	<i>Ciconia ciconia</i>
ANATIDAE	3	<i>Anas platyrhynchos</i> , <i>Anas querquedula</i> , <i>Aythya ferina</i>
ACIPITRIDAE	12	<i>Pernis apivorus</i> , <i>Nefron percnopterus</i> , <i>Gyps fulvus</i> , <i>Circus gallicus</i> , <i>Accipiter gentilis</i> , <i>Accipiter nisus</i> , <i>Accipiter brevipes</i> , <i>Buteo buteo</i> , <i>Aquila belieca</i> , <i>Aquila chrysaetos</i> , <i>Hieraetos pennatus</i> , <i>Hieraetos fasciatus</i>
FALCONIDAE	5	<i>Falco peregrinus</i> , <i>Falco subbuteo</i> , <i>Falco biarmicus</i> , <i>Falco tinnunculus</i> , <i>Falco naumanni</i>
PHASIANIDAE	6	<i>Bonasia bonasia</i> , <i>Tetrao urogallus</i> , <i>Alectoris graeca</i> , <i>Perdix perdix</i> , <i>Coturnix coturnix</i> , <i>Phasianus colchicus</i>
RALLIDAE	1	<i>Crex crex</i>
GRUIDAE	1	<i>Grus grus</i>

OTIDIDAE	1	<i>Otis tarda</i>
SCOLOPACIDAE	1	<i>Actitis hypoleucos</i> , <i>Scolopax rusticola</i>
COLUMBIDAE	5	<i>Columbo livia</i> , <i>Columbo aenas</i> , <i>Columbo palubus</i> , <i>Streptopelia decaocta</i> , <i>Streptopelia turtur</i>
CUCULIDAE	1	<i>Cuculus canorus</i>
STRIGIDAE	6	<i>Otus scops</i> , <i>Bubo bubo</i> , <i>Strix aluco</i> , <i>Athene noctua</i> , <i>Asio otus</i> , <i>Asio flammeus</i>
CAPRIMULGIDAE	1	<i>Caprimulgus europaeus</i>
APODIDAE	2	<i>Apus apus</i> , <i>Apus melba</i>
ALCEDINIDAE	1	<i>Alcedo atthis</i>
MEROPIDAE	1	<i>Merops apiaster</i>
UPUPIDAE	1	<i>Upupa epops</i>
PICIDAE	10	<i>Picus viridis</i> , <i>Picus canus</i> , <i>Dendrocopos mayor</i> , <i>Dendrocopos syriacus</i> , <i>Dendrocopos leucotos</i> , <i>Dryocopus martius</i> , <i>Junco torquilla</i> , <i>Dendrocopos medius</i> , <i>Dendrocopos lifordi</i> , <i>Picoides tridactylus</i>
HIRUNDIDAE	4	<i>Delichon urbica</i> , <i>Hirundo rustica</i> , <i>Ptyonoprogne rupestris</i> , <i>Hirundo daurica</i>
ALAUDIDAE	4	<i>Galerida cristata</i> , <i>Lullula arborea</i> , <i>Alauda arvensis</i> , <i>Eremophila alpestris</i> ,
MOTACILIDAE	5	<i>Anthus campestris</i> , <i>Anthus trivialis</i> , <i>Anthus spinoleta</i> , <i>Motacilla cinerea</i> , <i>Motacilla alba</i>
CINCLIDAE	1	<i>Cinclus cinclus</i>
TROGLODYTIDAE	1	<i>Troglodytes troglodytes</i>
PRUNELIDAE	2	<i>Prunela modularis</i> , <i>Prunella collaris</i>
TURDIDAE	12	<i>Turdus viscivorus</i> , <i>Turdus torquatus</i> , <i>Turdus merula</i> , <i>Monticola saxatilis</i> , <i>Oenanthe hispanica</i> , <i>Oenanthe oenanthe</i> , <i>Saxicola rubetra</i> , <i>Phoenicurus ochrurus</i> , <i>Luscinia megarhynchos</i> , <i>Erithacus rubecula</i> , <i>Turdus philomelos</i> , <i>Saxicola torquata</i>
SYLVIDAE	9	<i>Sylvia atricapilla</i> , <i>Sylvia curruca</i> , <i>Sylvia communis</i> , <i>Phylloscopus collybita</i> , <i>Phylloscopus trochilus</i> , <i>Phylloscopus sibilatrix</i> , <i>Hippolais polida</i> , <i>Regulus regulus</i> , <i>Regulus ignicapillus</i>
MUSCICAPIDAE	3	<i>Muscicapa striata</i> , <i>Muscicapa albicollis</i> , <i>Ficedula parva</i>
AEGITHALIDAE	1	<i>Aegithalos caudatus</i>
PARIDAE	7	<i>Parus palustris</i> , <i>Parus lugubris</i> , <i>Parus montanus</i> , <i>Parus cristatus</i> , <i>Parus ater</i> , <i>Parus caeruleus</i> , <i>Parus major</i>
SITTIDAE	1	<i>Sitta europaea</i>
TICHOPTERIDAE	1	<i>Tichodroma muraria</i>
CERTHIDAE	2	<i>Certhia familiaris</i> , <i>Certhia brachydactyla</i>
ORIOOLIDAE	1	<i>Oriolus oriolus</i>
LANIIDAE	3	<i>Lanius collurio</i> , <i>Lanius minor</i> , <i>Lanius senator</i>
CORVIDAE	9	<i>Garrulus glandarius</i> , <i>Pica pica</i> , <i>Nucifraga caryocatactes</i> , <i>Pyrrhocorax pyrrhocorax</i> , <i>Pyrrhocorax graculus</i> , <i>Corvus monedula</i> , <i>Corvus frugilegus</i> , <i>Corvus cornix</i> , <i>Corvus corax</i>
STURNIDAE	1	<i>Sturnus vulgaris</i>
FRINGILLIDAE	9	<i>Carduelis carduelis</i> , <i>Carduelis cannabina</i> , <i>Carduelis spinus</i> , <i>Carduelis chloris</i> , <i>Coccothraustes</i>

		<i>coccothraustes, Pyrrhula pyrrhula, Serinus serinus, Loxia curvirostra, Fringilla coelebs</i>
EMBERIZIDAE	6	<i>Emberiza citrinela, Emberiza cirius, Emberiza cia, Emberiza hortulana, Emberiza melanocephala, Miliaria calandra</i>
PASSERIDAE	3	<i>Montifringila nivalis, Paser domesticus, Passer montanus</i>

MAMMALOFAUNA (Gjitarët)

Fauna e gjitarëve të Bjeshkëve të Nemuna është e përfaqësuar me forma karakteristike shumica e të cilave janë lloje që jetojnë në tërë gadishullin Ballkanik, kemi këtu taksonë që janë të lidhura ekskluzivisht për vendbanimet e larta malore siç është dhia e egër, pastaj rrëqebulli, mandej lloje që janë të lidhura për pyjet halore, gjethegjëra, për shkurre dhe për ultësira. Grupi më i përfaqësuar i gjitarëve i takon brejtësve (Rodentia) pastaj vijnë ripërtpësit, mishngrënësit etj. Në këtë masiv malor jetojnë edhe taksonë që i përkasin listës së llojeve të rrezikuara në shkallë botërore. Këtu vlen të përmendim ariun e murmë (*Ursus arctos*), rrëqebullin (*Lynx lynx*), dhinë e egër (*Rupicapra rupicapra*), kaprollin (*Capreolus capreolus*), mandej qakalli (*Canis aureus*) etj.

Rrëqebulli (*Lynx lynx L.*) është një macë mjaft e madhe deri në një meter me bisht shumë të shkurtër 18 cm dhe me këmbë të gjata të zhvilluara mirë. Në dimër ka në majën e veshëve një tufë qime të gjata të bardha, po kështu edhe në gushë të cilat kanë një pamje interesante të egër. Ngjyra e qimes së shpinës është e kuqerreme ose ngjyrë tulle, ndërsa pjesa barkore e bardhë. Ngjyra e anës së sipërme ndërpritet me njolla të zeza pak a shumë të dendura. Luqerbulli është banor i përhershëm i pyjeve me trungje të larta.

Vetëm në raste të veqanta në vitet kur nuk ka ushqim të bollshëm atëherë migron në vende të ulëta dhe atë përkohësisht. Ngjitet shumë shpejt nëpër drurë dhe ecë me shpejtësi të madhe. Gjuan në orët e mbrëmjes dhe të mëngjesit. Ushqimi kryesor i luqerbullit janë lepujt, minjtë, shpendtë e ndryshëm, vezët dhe zogjtë e foleve e nganjëherë mund të sulmojë kaprojtë e vegjël, kurse nga bagëtia më shpesh i sulmon qengjat. Bën një jetë kryesisht stacionare (brenda një zone të caktuar) dhe vetëm kur mungon ushqimi bën migrimin në zonat e tjera. Jeton në qifte, kopulacioni bëhet nga fundi i janarit deri në prill, ndërsa mbarsmëria zgjat 63 deri 70 ditë. Femra lind dy deri tre klyshë, rrallë më shumë dhe i ushqen me qumësht deri në tre muaj. Në bashkësi jetojnë deri në një vit. Folenë e ndërton në vende të qeta pyjore në zgavrat e trungjeve. Është shumë i ndijshëm në zhurmë, prania e njeriut e pengon. Tek ne është shtazë e rrezikuar. Mendohet se gjithsej në Bjeshkët e Nemuna mund të jenë deri në 30 individë. Duhet bërë vëzhgime të veqanta për të vërtetuar numrin real të pranisë së tyre. Në të kaluarën kanë qenë më të shumtë por dëmtimi i pyjeve dhe veqanërisht lufta e fundit kanë shkaktuar që ky lloj të jetë i rrezikuar dhe nëse nuk mirren masa adekuate në territorin e Bjeshkëve të Nemuna fauna do të jetë e mangët me këtë lloj të veqantë.

Macja e egër (*Felis silvestris Schreber*) është një lloj me përhapje të kufizuar. Në Evropë është e pranishme në Skotlandë, në gadishullin Pirinej, gadishullin Ballkanik dhe në jug të ish Bashkimit Sovjetik. Tek ne në Bjeshkët e Nemuna është konstatuar në regjionin e Hajlës, Liqenatit dhe posaqërisht në regjionin e Deqanit me numër të kufizuar ekzemplarësh. Ngjyra e gëzofit në përgjithësi është e murme me ton të zverdhur dhe me disa brazda të errëta, poshtë është me ngjyrë më të zbardhur kurse në pjesën shpinore paraqiten dy breza të errët kështuqë nga sipër duket e valëzuar. Bishti i gjatë me 5 deri 6 unaza të zeza transversale. Bën një jetë individuale. Vlen të theksojmë se është mjaft endacake dhe vështirë mund të përcaktohem për arealin e kufizuar. Ushqehet me minjë dhe shpendë. Del për të gjuajtur vetëm natën. Në vitet kur janë të përhapur mjaftë minjtë shpesh i lë zonat pyjore dhe kalon në pjesët e ultësirave dhe mu për këtë mund të konstatojmë që është një kafshë me rendësi të veqantë në përbërje të ekosistemit. Është mjaft e rralluar. Edhe këtë e pengon prerja e pyjeve dhe zhurma. Kopulacioni bëhet në muajin shkurt dhe mars dhe mbarsmëria zgjatë afër 60 ditë. Femra lindë 5 deri 6 këlyshë, zakonisht në këtë kohë ajo i shfrytëzon foletë e kafshëve tjera. Meqenëse lëkura është shumë kualitative në të kaluarën është gjuajtur pa kritere. Kjo kafshë është pothuajse në të gjitha librat e kuqe të shteteve ku është e pranishme. Duhet patur kujdes të veqantë që kësaj kafshe t'ia mundësojmë jetesën në Bjeshkët e Nemuna për arsye se është një begati e rrallë për këtë Park Kombëtar.

Në masivin e Bjeshkëve të Nemuna është e pranishme edhe familja Mustelide siq është *Martes martes L.* dhe *Martes foina L.* Që të dyja këto kafshë janë me rëndësi të veçantë. Në të kaluarën janë gjuajtur pa kritere për shkak të gëzofit të tyre. Numri i zvogëluar i këtyre kafshëve paraqet obligim që edhe këto të gjenden në listen e librit të kuq kështuqë të jenë të mbrojtura me ligj. Që të dyja janë shtazë me aktivitet të natës.

Bukla (*Mustela nivalis L.*) jeton në territorin e Bjeshkëve të Nemuna, më tepër pranë vendbanimeve me aktivitet në muzg dhe natën. Ka madhësinë e miut shtëpiak, trupin e zgjatur ngjyrë të kaftë në të kuqërreme, në pjesën barkore me ngjyrë të bardhë. Ushqehet me minjë dhe shpendë të imtë.

Qelbësi (*Mustela putorius L.*) në Bjeshkët e Nemuna është i pranishëm më tepër në viset moqalike pranë ujit, dimrit pranë vendbanimeve të njeriut, ka aktivitet natën. Nga gjëndrrat anale lëshon një sekret me erë të pakëndëshme. Ushqehet me minjë, uritha, brektoca, rrëshqitësa, peshqi, shpendë etj. Mbarësimin e bart 40 deri 43 ditë, lindë zakonisht katër deri shtatë këlyshë të cilët deri në 36 ditë nuk shohin, pas nëntë muajve bëhen të aftë për frytnim.

Nga familja Canide në Bjeshkët e Nemuna është i pranishëm ujku (*Canis lupus L.*) Ky është një grabitqar me trup të gjatë deri 1 metër. Bishtin gjithashtu e ka të gjatë deri në 50 cm, këmbët e fuqishme deri në 50 cm nga të cilat ato të mbrapmet kanë nga 5 kallo. Pesha te meshkujt arrin deri 75 kg. Qimet i ka të gjata të ashpra dhe me ngjyrë intensive të murme në shpinë, kurse në pjesën barkore me nuanca të bardha. Ka një areal të madh. Në dimër më tepër është në lëvizje. Një nga faktorët përcaktues të përhapjes së ujkut është njeriu, pasi që ky jeton në sajë të kafshëve shtëpiake dhe në radhë të dytë nga dendësia e kafshëve të tjera. Ujku është aktiv mbrëmjeve dhe natën por gjuan edhe ditën. Ushqimi i tij kryesor janë kafshët shtëpiake: dhentë, dhitë, gjedhet, kaprojtë por edhe kafshët e vogla si lepujt, minjtë, bretkocat bile edhe insektet. Ujqit sulmojnë në tufa ose në qifte dhe çdo qift ka një zonë të caktuar gjuetie ku nuk mundën të gjuajnë ujkit tjerë. Fundi i dhjetorit dhe fillimi i janarit përbëjnë periudhën e shumëzimit. Mbarsmëria zgjatë 63 deri 65 ditë. Ulklonjat e reja pjellin 3 – 4 këlyshë kurse ato të vjetrat deri 12 këlyshë. Këlyshët lindin me sy të mbyllur dhe sytë iu qelen pas 10 - 12 ditëve. Pijnë qumësht deri në 45 ditë. Strofkën e ndërtojnë në shpella, rrëzë kënetave, në vende të thata dhe të fshehta. Meshkujt pas procesit të kopulimit nuk e braktisin femrën por qëndrojnë me të dhe ushqejnë së bashku këlyshët. Në vjeshtë këlyshëve u ndërrohen dhëmbët e qumështit dhe fillojnë të gjuajnë së bashku me prindërit. Ujku është një ndër egërsirat që e ka më shumë të zhvilluar luftën për ekzistencë. Këlyshët e dobët dhe të sëmurë i mbysin. Ujqit nuk dëmtojnë njëlloj gjatë stinëve të ndryshme: më pak në dimër dhe më shumë në vjeshtë kur

fillojnë të gjuajnë së bashku me këlysh të rinjë (i mësojnë për gjueti). Dihen raste kur kanë prerë deri në 50 krerë dele. Në raste shumë të rralla e sulmon edhe njeriun. Në Bjeshkët e Nemuna ende nuk i kanoset rreziku i zhdukjes.

Qakalli (*Canis aureus L.*) në Bjeshkët e Nemuna më tepër është i përhapur në grykat e lumenjëve dhe në lugina. Është aktiv natën dhe në muzg, bën lëvizje duke e ndërruar mjedisin me distanca të mëdha, është notues i mire, bën gjurmime duke ndërtuar strofka edhe në mbrendësi të tokës. Është grabitqar i madh, sulmon në tufa.

Dhelpra (*Vulpes vulpes L.*) është mjaftë e përhapur në regjionin e përshkruar dhe atë pothuaj në të gjitha zonat por më tepër është e përqënduar në afërsi të qendrave të banimit me përjashtim të periudhës së lindjes dhe rritjes së këlyshve. Ajo jeton në galeri ku foleja e saj ka një hyrje kryesore dhe disa vrime dalëse në raste rreziku. Ka një përhapje mjaftë të gjërë.

Si kafshë me rëndësi të veçantë që duhet pasur kujdes në mbrojtjen e tyre pasi që numri i tyre është në zvogëlim e sipër, dhe nëse nuk mirren masa mund të zhduken plotësisht nga fauna e Bjeshkëve të Nemuna, janë dhia e egër (*Rupicapra rupicapra L.*) dhe kaprolli (*Capreolus capreolus L.*).

Dhia e egër është një nga kafshët tipike të shkrepave maleve të larta. Ajo ushqehet me bar të zonave alpine, gjethe të ahut, myshqe etj. Bën migrime të ndjeshme e të detyruara nga ushqimi, uji dhe reshjet e mëdha atmosferike (dëbora). Femrat gjatë tërë vitit qëndrojnë në tufa deri në 12 krerë. Për tufën kujdeset dhia më e vjetër dhe më me eksperiencë e cila njih mirë të gjitha shtigjet dhe rrugëdaljet në rast rreziku. Periudha e kopulimit fillon nga muaji nëntor dhe zgjat deri në gjysmën e parë të dhjetorit. Kecat lindin në maj dhe kanë ngjyrë të zezë të shëndritshme, ushqehen me qumësht deri në fund të korrikut, zakonisht lindin një deri në dy keca. Sa i përket kaprollit kjo kafshë jeton më tepër në pyjet gjethegjërë, gjithashtu ushqehet me bar dhe me gjethe. Meshkujt janë të pajisur me brirë. Në pjesën më të madhe të vitit qëndrojnë në bashkësi. Meshkujt e rritur qëndrojnë të veqar nga tufa dhe vetëm gjatë kohës së ndërzimit bashkohen me femrat. Në dimër qëndrojnë në vende të ulëta kurse verës emigrojnë në vende më të larta.

Vlen të përmendim edhe vjedullën (*Meles meles L.*), pastaj derrin e egër (*Sus scrofa L.*) e që të dyja këto kanë përhapje mjaftë të gjërë në Bjeshkët e Nemuna veqanërisht në viset kodrinore ku ka pyje. Aktivitetin e kanë më tepër natën dhe në shumicën e rasteve i bëjnë dëme kulturave bujqësore.

Ariu i murmë (*Ursus arctos*) është bisha më e madhe në Europë. Gjatësia trupore arrin deri në 300 cm, peshon deri në 344 kg, ngjyrën e lëkurës e ka të murme, jeton në pyje të mëdha të dendura, iu ikë vendbanimeve të njeriut, është aktiv kur bie muzgu dhe natën. Noton, ngjitet dhe vrapon mirë, jeton i vetmuar, në vjeshtë shkon dhe pushon në shpella ose në degë të drunjëve. Ushqehet kryesisht me fryte të bimëve drunore, kërpudha, bar, rrënjë, mjaltë e përveq këtyre me të gjitha llojet e shtazëve deri te gjedhi dhe kali. Në kohët e fundit i kanoser rreziku i ekzistencës, numri i tyre është zvogëluar prandaj meritojnë një tretman të veçantë. Në këtë dukuri rol vendimtar ka luajtur prerja e pyjeve, zhurma nga sharrat motorike, prania e njeriut etj. Është i regjistruar në librin e kuq.

Prej brejtësve janë të përhapur minjtë e gjinisë *Apodemus*, *Ratus* mandej dendur është i përhapur lepuri (*Lepus europaeus*), ketri (*Scirius vulgaris*) etj.

Nga grupi i Insektivorëve është mjaft i përhapur edhe urithi (*Talpa europeae*) që jeton duke hapur galeri, mandej mjaft i përhapur është edhe iriqi i zakonshëm (*Erinaceus europeus*) etj.

Lakuriqët (*Hiropterat*) përfaqësohen më dendur dhe atë duke iu falënderuar numrit të madh të shpellave siç është ajo e Radavcit ku jetojnë koloni të dendura të gjinisë *Rhinolophus*, pastaj *Pipistrellus*. Zakonisht Hiropterat jetojnë në koloni me numër të madh individësh. Këtu është e pranishme edhe gjinia *Miopsis* etj. Hiropterat janë të gjitha të dobishme pasi që ushqehen me insekte.

Duke pasur parasysh se Bjeshkët e Nemuna posedojnë një faunë shumë të pasur dhe numër të madh të endemeve është imperativ i kohës që sa më parë kjo trevë të shpallet park kombëtar me ç'rast do të mbahej gjendja faktike faunistike e për disa lloje do të përmirësohej gjendja e tyre. Në vëzhgimet e ardhshme mendojmë që do të paraqesim edhe hulumtimet e reja që do ta begatojnë me lloje të reja faunën e këtij masivi malor.

5. TURIZMI

5.1 VLERAT TURISTIKE TË BJESHKËVE TË NEMUNA

Nga aspekti turistik Parku Nacional Bjeshkët e Nemuna është njera prej teritorëve me interesante në Kosovë dhe më gjërë. Ka vegetacionin më të llojlojshme e të ruajtur pyjorë, me një vargë të llojeve të florës endemike dhe të relikteve të florës, gje që në pikpamje shkëncore e turistike është mjaftë e rëndësishme dhe atraktive. Kjo natyrisht plotëson edhe me karakteristikat morfologjike dhe hidrografike, po ashtu me motive të rëndësishme turistike.

Resurset e përmendura natyrore të Bjeshkëve të Nemuna determinojn në mënyrë positive funksionin rekreativ dhe ekonomik të tyre, barazpeshën ekologjike të bashkësive dhe të strukturave natyrore, gjë që mund të merret si bazë e shëndosh për zgjerimin kualitativ dhe kuantitativ të atraktivitetit që janë në funksion të turizmit dhe për mbajtjen dhe përparimin e këtij mjedisi natyror.

Vetëm përmes turizmit mund të prezentohen edhe propagandohen këto vlera të mbrojtura natyrore, dhe në saje të saj mund të realizohen mjetet e nevojshme për mbrojtje.

Nderlikushmeria e formave të relievit, shpërndarja vertikale, kushtet e përshtatshme klimatike, të mbajturit e gjatë të borës dhe karakteristikat e tjera të shumta të teritorit të Parkut Nacional Bjeshkët e Nemuna, japin mundësi të jashtzakonshme për zhvillimin e aktiviteteve të llojllojshme turistike e rekreative. Hapësira e Parkut Nacional të Bjeshkëve të Nemuna përbënë një tërsi tejet të vlefshme peisazhore të cilën e karakterizojn një sërë lokalitetesh më vlera të llojllojshme natyrore. Tërsin ma atraktive peisazhore dhe turistike e përbëjn pyjet, barishtorët, livadhet, degëzimi i relievit i krijuar më prerjen e një sërë të luginave dhe grykave , lumenjëve dhe përrockave, bjeshkët e thepësura dhe liqejt e shumtë i plotësojn veçoritë e peisazhit dhe siguron përjetim të këndshëm të kësaj natyre të bukur më vlera joshëse të larta turistike. Masivet e larta malore e shkëmbore mbi 2500 m i jep mundësin e shetitjes së alpinistëve . Edhe hapësira prej livadheve me kodrina dhe shpatije dhe atyre alpikë të përshkuar me burime të medha uji, ofrojn mundësi shëtitje dhe rekreacioni. Vlera të larta turistike dhe studimore kan edhe shpellat e shumta siq është Shpella e Radavcit, Karamakazit, shpellat e vogla të princeshës, shpellat përgjatë Gërles së Koshutanit, shpella afer Gurrës së Rutës etj, që në të ardhmen mund të jenë edhe si qendra të studimeve nga spelologet.

Zhvillimi i aktiviteteve turistike-rekreative është i mundur në tri forma themelore; stacionare, vikend-shetitje, dhe transit.

Kushtet natyrore më një përkufizim mundësojn zhvillimin si të turizmit verorë ashtu edhe të atij dimëror.

5.1.1. Turizmi stacionar

Ka karakteristika të qëndrimit më të gjatë në zona të ndryshme të Bjeshkëve të Nemuna qoftë gjatë sezonës veror dhe dimëror.

Turizmi veror: ka kushte shumë të përshtatshme parasegithash, pushimi i familjarëve, punëtorëve, mjekimi shëndetësor, qëndrimi në natyrë të lirë, alpinizmi, gjuetija, peshkimi. Këto kushte mund të zhvillohën në shumë lokalitete e sidomos në Kuqisht dhe në Bogaj. Klima malore gjatë sezonës së verës i favorizon pa rezerv turistet që atje thithin ajrin e pastër dhe stimulus për shëndetin e njeriut. Në përgjithësi kompleksi malor i Bjeshkëve të Nemuna kan Kushte të volitshme të klimës malore më ndryshime vertikale të theksuara të vegjetacionit , ekosistemeve të ndryshme, peisazhet pitoreske, begatija ujore që për turistet paraqetë vertetë klimë të shëndetshëm. Jo vetëm ajri i pastër por edhe prania e një larmije të botës së gjallë që të humb në mendim e meditim e bënë vizitorin vertetë në harmoni në mes vehte dhe natyrën.

Kur të flasim për alpinizmin si degë e bjeshkatarisë gjënë shprehje dhe mundësi të zhvillimit të shkëlqyeshëm në masivin shkëmbor, në regjionin e dyte të bjeshkëve te Nemuna , si maja e Gjeravicës 1656m duke shkuar ne drejtim të trekufirit në Boriq 2330m dhe në majet shkëmbore në veriun e Shqipërisë si maja e hekurave, shkëlzeni. Këtu mund të futen në këtë fushë të turizmit edhe Maja e

Ropsit-2502m, Maja e Rusolisë-2381m, Kurvalla- 2303m, Maja e Strellcit-2377m, Maja e Qenit-2406m, Koprivnik(Kërshi i Çverlës)-2460m, Marjashi(Bagdash)- 2530m, Leqinati-2341m, Maja e Lumbardhit-2522m, Hajla-2400m, Gusan-2539, Kota 2130m, Maja e Bajrakut-2078m, Mali Kozhner-2107m etj.

Kushte mjaftë të përshtatshme ofron edhe territori i burimeve të Drini i Bardhë, mandej territori i liqenjëve të Leqinatit dhe disa terrene të tjera ku do të mund të zhvillohen kapacitetet për pushim veror dhe mjekim.

Gjithashtu, pos burimeve të lumenjëve si Drini i Bardhë, Bistrica e Pejës, Deçanit dhe burime të tjera me sasi me të vogël të ujit siq janë Vrella-Istog, Vrella-Vrellë, Gurra e Radavcit, Uji i Bardhë-Pejë, Uji i zi-Pejë, Vrella e Gubavcit-Pejë, Vrella e Lubeniqit-Lubeniç, Vrella e Jasiqit-Jasiç, Vrella e livadheve të mëdha-Jasiç, Vrella e Isposnicës(Bistrica e Deçanit), Vrella e Belajes(Bistrica e Deçanit), Vrella e Junikut-Junik, Vrella (Haxhaj) etj, si vëndburime uji të pastër dhe të shëndetshëm janë shumë atraktive dhe tërheqëse për vizitorë.

Turizmi dimëror: turizmi i till zënë një vënd të rëndësishme duke pasur parasysh terrene shumë të përshtatshme hapësinor, natyrore e klimatike për zhvillimin e shumë diciplinave të skitarisë. Sipas të dhënave në Bjeshkët e Nemuna janë rreth 31.500m dhe mund ti përballon deri në 30.000 skitarist. Terrene kryesore për skitari janë; Kopraniç, Maja e Rusolisë, Malet e Leqinatit dhe Bjeshkët e Moknës.

Studimet e deritanishëm janë bërë në Kopraniç që është hartuar programi investiv më titull “Qendra sportive rekreative turistike e Dukagjinit”.Gjatësia e tërsishme e shtigjëve të skitarisë në këtë territor është 29.513m.

Parakushte mjaftë të mira për zhvillimin e turizmit kanë edhe viset në territorin e Bogës,Kuqishtës, Bjeshkët e Lumbardhit, Moknës dhe disa terrene të tjera.

5.1.2. Turizmi vikend- shetitës

Atraktiviteti i territorit, e parasegjitash i Grykës së Rugovës, përmendoret kulturore historike në rrethinën e afert dhe të largët, vlerat tjera natyrore e raritetet, ka një ndikim të rëndësishëm në motivimin e turizmit vikendo-shetitor. Trashegimia e pasur kulturore-etnografike, vëndbanimet dhe fshatrat në viset e Rugovës(punëdoret, folklori i Rugovës) janë po ashtu motiv i madh për ardhje në këtë Park Nacional.

5.1.3. Turizmi tranzitor

Pozita e tij dhe kalimi i rrugës Pejë-Qakor (nëse asfaltohet) do të krijoj kushte që të kthehet rrjedha turistike nga drejtimi i jugut mandej kah territori i Adriatikut. Për turistet tranzitor nuk është e

nevojshme ndërtimi i ndonjë objekti të posaqëm, përveq ndonjë përmbajtje plotësuese të cilat do të sigurojnë nëvojat e këtyre turistëve.

Këto mund të llogariten pasi që është shpallur si Parkë Nacional, që po vërshohët dhe do të vërshohët edhe në të ardhmen nga ekskurzionet shkollore e universitare, puna arsimore e edukative, puna shkëncore e hulumtuese, manifestimet e ndryshme gjërë të ato tradicionale, pushimë në natyrë, shëtitjet, trangu i sportistëve, vizitat masovike te agjensive turistike dhe motivet tjera të ndryshme.

5.2. Gjuetia dhe peshkataria

Sa i përket vlerave të gjuetisë dhe ekonomisë së gjuetisë është një faktor më rëndësi për turizmin rekreativ duke pasur parasysh shumëllojshmerin e faunës të cilat shtrihen në zonat fushore, kodrinore dhe malore. Këtu jetojnë Ariu i murrëm(*Ursus arctos*), Dhia e egër(*Rupicapra rupicapra*), Kaprolli(*Capreolus capreolus*), Luqërbulli(*Lynx lynx*), Maca e eger(*Felix silvestris*), Dreri(*Cervus elaphus*), Derri i egër(*Sus scrofa*), Pula e eger(*Lyrurus tetris*), Ujku(*Canis lupus*), Dhelpra(*Canis vulpes*), Lepuri(*Lepus europeus*) etj. Në regjionin e Deçanit si në Kozhnjar, Roshkodol dhe në bjeshkë e Prilepit masivi i gjuetisë përfshin një sipërfaqe prej 1671.55 ha. kjo duhet të bëhet në suaza sa më të vogla dhe në sezona te caktuara sipas standardeve te gjuetisë, sepse në keto teritore jetojnë edhe lloje shumë të rralla siq është rrëqërbulli.

Peshkimi zënë një vënd të rëndësishëm për turizmin rekreativ çka kjo paraqet një motivim më rëndësi të ardhjës së vizitorëve e sidomos te qytetarëve që janë të pasionuar pas peshkimit në Parkun Nacional të Bjeshkëve të Nemuna. Në lumenjtë e bjeshkëve të Nemuna gjëndet trofta(*Salmo trutta*), që është peshk tipik i rrjedhave malore në uji të pastër.

5.3. Udhëzimet për ruajtjen e turizmit në Bjeshkët e Nemuna

Pasi që Bjeshkët e Nemuna paraqesin tërësi komplekse natyrore-gjeosistem malor me elemente burimore autentike, dhe atraktive të botës organike dhe inorganike me vlerë të papërseritshme ekologjike, shkëncore edukative sportive, shëndetësore-kurative, turistike me interes të gjërë shoqëror jo vetëm komunitetin lokal dhe Kosovën në tërësi por edhe me vlerë regjionale dhe ndërkombëtare, duhet një qasje serioze të mbrojtjes së kompleksit të maleve të Bjeshkëve te Nemuna për një turizem sa ma tërheqës dhe profitabil për ekonomin.

Aktivitetet dhe veprimtarit turistike-rekreative duhen vënë në kontekst të mundësive të gjëra të cilat ekzistojnë në Parkun Nacional që përfshinë komunat Pejë, Deçan, Gjakovë, dhe Burimi. Mundësit e tilla janë mjaftë të mëdha siq shihët në numrin më të mëdha të lokalitetëve. Andaj planifikimi i zhvillimit të

aktivitetëve turistike –rekreative dhe të kapacitetëve në Parkun Nacional Bjeshkët e Nemuna duhet të jetë komplekse. Është e domosdoshme që ato llojlojshmëri e posaqerisht biologjike dhe viset e pasura në masë më të madhe të mos shkatërrohen(varfrohen më ndërtim). Qasja e planifikuar e planifikimit integral hapësinor dhe e rregullimit të viseve të rëndësishme turistike e natyrore, nënkupton zbatimin e valorizimit të të gjitha kushtëve themelore të kompleksit të destinuar për aktivitetet rekreative turistike.

Pasi që kompleksët turistike- rekreative gjenden kryesisht në Pyje, qëllimi themelor i pylltarisë në ato terene duhet të jetë ruajtja dhe përparimi i përhershëm i të gjitha funksionëve të pyjëve(ekonomike dhe jo ekonomike). Nga ana tjetër pylltaria duhet të llogarisë në disa ndikime të konsiderueshëm negative më pyje, të cilat do t'i shkaktojnë ndërtimi i kapaciteteve turistike e rekreative(qendrat e skitarisë, rrugët, shtigjet e skitarisë etj.). Ndërtimi i rrugëve dhe i teleferiqëve e ashënsorëve të skijimit duhet të bëhet ashtu që në masë sa më të vogël ti dëmtojnë pyjet dhe bimët tjera.

Për tu arritur një turizëm vërtet atraktiv dhe të qëndrueshëm për të ardhmën e Bjeshkëve të Nemuna është e nevojshme që të punohet në disa drejtime që janë edhe vendimtare;

- Plani hapësinor i Parkut Nacional të Bjeshkëve të Nemuna,
- Planet dhe programet e të gjitha aktivitetëve në Parkun Nacional të Bjeshkëve të Nemuna në të cilën do të inkuadrohen edhe masat mbrojtëse.
- Mbrojtja individuale, e diferencuar e vlerave natyrore në Kompleksin malorë Bjeshkët e Nemuna siq janë p.sh edhe si të ruajtura (Gryka e Rugovës, Malet e Prilepit, Gubavci, Burimi i Drinit të Bardhë) etj.
- Mbrojtja e integruar e Kompleksit malorë Bjeshkët e Nemuna,
- IMNMK-JA, MAPH-JA, Komunitetet lokale, ojq etj, me aktivitetet e përbashkëta duhet të identifikojmë problemet kritike në Parkun Nacional,
- Mbrojtja, ruajtja dhe rregullimi i vlerave gjenetike natyrore pasi që këto tregojnë nivelin e civilizues, por edhe si njëri ndër standardet për integrimin në Bashkësinë Evropiane.

Udhëzimet e përgjithshme të IUCN rekomandojnë që në planin e administrimit të një parku Kombëtar të jepen drejtimit kryesorë të cilat mbështesin objektivat themelore dhe synimet që parashikohen të arrihen. Plani i administrimit asnjëherë nuk konsiderohet si një planifikim i thjeshtë për objektivat socialo-ekonomike, por një domosdoshmëri që të hudhet edhe një vështrim i përgjithshëm për të gjitha ndikimet e vecanta.

6. PYJET DHE SIPËRFAQET PYJORE

6.1. Resurset Pyjore, Rëndësia e tyre në propozimin e shpalljes së Bjeshkëve të Nemuna Park Nacional

Pyjet si në gjithë botën edhe në Kosovë konsiderohen si burim kryesorë i ruajtjes së natyrës dhe mbrojtjes së mjedisit .

Aftësia regjeneruese funksionet dhe mundësitë e përdorimit të shumëfishtë në etapa të ndryshme të zhvillimit të njeriut janë konsideruar me rëndësi egzistenciale.

Për këtë arsye dhe si sistem mjaft i ndërlikuar i natyrës kanë qenë dhe janë objekt i studimit dhe bisedimeve në nivelet më të larta botërore. Krejt kjo me synim të ruajtjes, zhvillimit dhe optimalizimit të përdorimit të shumëfishtë të tyre.

Lidhshmëria e njeriut me pyje daton nga kohrat më të vjetra dhe sotë në vazhdimsi është në rritje si vler që dukshem ka ndikim në zhvillimin ekonomik social dhe mjedisorë të nivelit kombëtar, global dhe rajonal.

Kosova në Europë zë vend të rëndësishëm për nga mbulueshmëria me pyje dhe toka pyjore me 42 % të teritorit tokësorë.

Aktualisht sipas disa vlerësimeve të mëhershme Kosova ka nevojë për zgjerimin e siperfaqeve pyjore për 10 % duke u bazuar në nevojat, mundësit, reliefin dhe pjerrtësinë e tokave pyjore.

Bazuar në shumë llojshmëri e reliefit bazes gjeologjike klimes dhe kushteve tjera të mjedisit Kosova sotë radhitet ndër vendet më të begatshme në rajon për nga shumëllojshmëria e florës dhe faunes në Ballkan.

Këto dhe shumë vlera të tjera na obligojnë të mendojmë dhe ndërtojmë një strategji afatëgjatë dhe të planifikuar për mënyrat e menaxhimit të tyre.

Kjo me arsyetim se resurset pyjore nuk na përkasin vetëm neve, por si gjenerat jemi të obliguar të trashëguaren ta ruajmë zhvillojmë dhe dorëzjome të avansuar gjeneratave të ardhshme.

Për këtë gjithsesi duhet të tejkalojmë mënyrën më të rëndë të gjertanishme të përdorimit dhe trajtimit të thjeshtë në atë gjithëperfshires të ruajtjes, mbrojtjes dhe zhvillimit të vlerave të përgjithshme të pyjeve.

6.1.1. Resurset Pyjore

Sipas të dhënave statistikore pyjet dhe tokat pyjore në Kosovë zënë një siperfaqe prej 429.121 ha ose 42 % të tër teritorit të sajë tokësorë.

Sipas strukture së pronësisë pyjet shtetërore shtrihen në 266.373 ha ose 62.1 %, kurse ato private në 162.748 ha ose 37.9 %.

Rafshi i Dukagjinit me Komunat : Peje, Deqan, Istog dhe Gjakovë bëjnë pjesë në rajonet që kanë mbulueshmëri të nivelit mesatarë të Kosovës.

Struktura e mbulushmërisë është e ndryshueshme, Deçani me 46 % ,Istogu me 42,7 % kanë mbulushmërinë më të lartë se mesatarja e Kosovës. Peja me një ndryshim të vogël me 40.8 % dhe Gjakova me vetëm 34.9 % kanë mbulueshmëri më të ulët se mesatarja.

Gjithsej pyje dhe toka pyjore në këto katër Komuna ka 81.122 ha ose 40.28 % të siperfaqes së përgjithshme të tyre tokësore.

Pjesmarrja e këtyre Komunave në nivelin kombëtarë të pyjeve dhe tokave pyjore është 18.90 %. Shiqur nga aspekti i pronësisë pyjet shtetërore janë 56.320 ha ose 69.43 % kurse në pronë private 24.802 ha ose 30.57 %.

Pyjet dhe tokat pyjore që gjenden në përbërjen e parkut nacional Alpet Shqipëtare në siperfaqe prej 50.000 ha ku shtrihen në territorin e Komunave : Pejë 32492.96 ha , Deçan 16632.96,34 ha, Gjakovë 1589, dhe Istog me 1805.43 ha.

Pjesën më të madhe të territorit e mbulon komuna e Pejës : me 32492,96 ha ku në pronë shoqërore janë: 26480,03 ha ose 81.50 % , ndërsa pronë private 6012,89 ha ose 18.0 %

Në krahasim me tërë siperfaqen e parkut nacional, Pyjet dhe tokat pyjore marrin pjesë me 59 % të siperfaqeve .

Të gjitha Pyjet shoqërore brenda kufijve të parkut nacional Alpet Shqipëtare i takojnë Agjencionit pyjor të Kosovës, zyra qendrore në Pejë.

6.1.2. Ekonomizimi i deritashëm me Pyje (Produktiviteti)

Shiquar nga këndvështrimi i potencialit prodhues pyjet në këtë rajon radhiten ndër burimet me rëndësi të zhvillimit ekonomik dhe social.

Sipas vlerës teknike bëjnë pjesë në pyjet me potencialin më të lartë të prodhimit të drurit teknik të halorëve dhe gjethorëve në Kosovë.

Volumi i tërsishëm i masës drunore sipas të dhënave statistikore është vlerësuar në rajonë të jetë 8.381.010 m³ ose 27.57 % të volumit të tërsishëm drunorë në Kosovë.

Sipas formës së rritjes Pyjet e larta farorët në rajon në dy sektorët përbejnë 37.513 ha ose 46.24 % të pyjeve kurse cungishtet dhe kategorit tjera përbejnë 53.76 %.

Deçani gjithsejt pyje dhe toka pyjore ka 16632.96 ha. Prej tyre pronë shtetërore janë 11.469.96 ha ose 68.95 % ndërsa në pronë private janë 5.163 ha ose 31.05 %. Volumi i përgjithshëm drusorë është i vlerësuar të jetë 2.945.522 m³.

Nga këto në pronësinë shtetërore 2.758.590 m³ ose 96.65 % kurse në atë private 186.932 m³ ose vetëm 6.35 %. Sipas këtyre të dhënave rrjedh se mesatarisht kemi nga 239.07 m³/ha me rritje vjetore prej 5.0 m³/ ha që rendit ato në pyje me produktivitet mesatarë më të lartë në Kosovë.

Nga 24.609 ha me pyje dhe toka pyjore në Komunën e Pejës që është paraprë të përfshihen në zonen e parkut të ardhshëm nacional në pronësinë Shtetërore janë 18.997 ha ose 77.19 % kurse në atë private 5.612 ha ose 22.81 %.

Volumi i tërsishëm drusorë në pronësinë shtetërore është 1.781.940 m³ ose 84.61 % kurse në atë privat është 324.211 m³ ose 15.39 % nga volumi i tërsishëm.

Mesatarja e volumit drusore në dy sektoret është vlerësuar të ketë qenë 85.58 m³/ha ose me rritje mesatare prej 2.74 m³/ha.

Në strukturën sipërfaqësore Istogu me 1.035 ha ose me 2.35 % dhe Gjakova me 1.589 ha ose 3.62 % bëjnë pjesë në komunat të cilat thuajse simbolikisht përfaqsohen për ndryshim nga Peja me 24.609 ha ose 56.01 % dhe Deçani me 16632.96 ha ose 38.02 % janë komunat të cilat participojnë me sipërfaqe më të mëdha të përfshirjes në propozimin e parkut nacional Alpet Shqipëtare .

6.1.3. Gjendja e trashëguar

Gjithsesi ajo nuk kënaq si pasojë e mënyrës së menaxhimit të mëhershëm administrativ. Kryesisht në atë kohë është aplikuar forma më e rëndë e shfrytëzimit me qëllim të përmbushjes së interesave aktuale shoqërore. Të gjitha këto të udhëhequr nën ndikimin e politikës në të shumtën e rasteve pa respektuar parimin e ruajtjes dhe zhvillimit të qëndrueshmërisë prodhuese të pyjeve.

Gjendja e përshkruar mesiguri ka patur ndikim në ndryshimin dhe në përbërjen e llojeve, kualitetin e bashkësive pyjore në shtrirjen horizontale dhe vertikale të këtyre kufijve nën ndikimin e veprimit të dëmshëm antropogjen dhe biotikë.

Dëmtimet antropogjene lehtë i vërejmë thuajse në tërë rajonin dhe llojet e bashkësive pyjore, posaqërisht më e theksuar është gjendja e bashkësive të dushqeve afër venbanimeve rurale të cilat rëndë janë të degraduara dhe shëndërrura në cungishte, shkurre apo sipërfaqe të zhveshura të potencialit të ulët prodhues.

Bashkësit pyjore të gështënjes nën ndikimin e faktorëve të dëmshëm biotikë dhe atij antropogjen kanë pësuar degradime të rënda dhe shëndërruar ato në bashkësi pyjore të degraduara të cungishteve me produktivitet të dobët kualitativ dhe kuantitativ.

Ndryshe nga këto bashkësit e ahut mvarësisht nga pronsia lokaliteti lartësia mbidetare boniteti ekspozicioni mënyra e menaxhimit janë të kualiteteve të ndryshëm. Ato i hasim në gjendje të mirë me dendësi të plotë të vjetërsive të ndryshme me prejardhje farore dhe cungishte të kualitetit të lartë teknikë deri te ato të devastuara nga prerjet ilegale me dendësi të rralluar me produktivitet të varfër kualitativ dhe kuantitativ.

Bashkësit e pastra të hormoqit dhe të përziera të bredhit hormoqit janë kategoria më e rëndë e dëmtuar e halorëve në këtë rajon. Dëme të rënda këto bashkësi pyjore të halorëve kanë pësuar posaqërisht gjatë menaxhimit të tyre pas aplikimit të masave të dhunshme të vitit 1990 nga Kuvendi i Serbisë në pylltarin e Kosovës. Për fat të keq në rrethanat e krijuara edhe pas mbarimit të luftës halorët janë llojet më të atakuara nga prerjet ilegale jo të kontrolluara.

Mungesa e organizimit të mirëfilltë të menaxhimit të pyjeve, nevojat e theksuara për dru teknik për rindertimin e shtëpive të shkatërruara nga lufta, vlera e tyre në treg dhe gjendja ekonomike e populates në tëresi kanë rënduar gjendjen e trashëguar jo aq të mirë në këto pyje.

Situata edhe më tepër është shqetësuese ku merret për bazë se shumica e prerjeve duket të është kryer pa asnjë kontrollë (zgjedhje pozitive) duke nxjerr exemplaret e shëndoshë të formuar mirë me rritje aktive pa asnjë kriter. Kjo negativisht në periudha të gjata do të manifestohet në bashkësit e mbetura me trungje jo të shëndoshë që i përkasin individëve me veti jo të mira trashëguese të rritjes aktive rezistencës ndaj faktorëve biotik dhe abiotikë që në radhë të parë pamundëson zhvillimin e bashkësi pyjore që përgjigjet kërkesave të ripërtritjes pranë natyrës përdorimit të shumëfishtë dhe qëndrueshmërisë prodhuese.

Gjthashtu brezi i të ashtuqujturave pyje të ulta të dushqeve dhe gështenjës jo më pak i rëndësishëm për nga vlera dhe shtrirja në rajon janë të atakuara në përmasa të mëdha dhe thuajse kanë pësuar ndryshim rrënjësorë të shëndrimit nga pyjet farorë kualitative në cungishte të varfëra për nga produktiviteti kuantitativ dhe kualitativ i prodhimit të masës drusore.

Në përpudhje më këtë mund të konstatojmë se situata e tanishme e pyjeve në këtë rajon nuk është e kënaqur si rrjedhojë e dobësimit të autoritetit shtetërorë në pyje. Si pasoj një sasi e konsiderushme e masës drusore është shfrytëzuar ilegalisht pa asnjë kriter dhe dukshem ka vështërsuar menaxhimin e qëndrueshmë të burimeve drusore të sigurimit dhe zhvillimit të funksioneve të tjera të shumëfishta të pyjeve.

Gjithsesi se kjo gjendje nuk do të tejkalohet lehtë, posaqërisht në pyjet e larta pas menaxhimit skandaloz të pyjeve nën administrimin e masave të dhunshme nga Kuvendi i Serbise.

Dëmet për fatë të keqe ende nuk janë vlersuar dhe saktësisht ato nuk dihen. Në mungesë të të dhënave të cilat do të rrjedhin pas kryerjes së inventarizimit të pyjeve që është në realizim e sipër. Megjithatë nuk do të gabojmë të vlerësojmë se ato janë të rënda dhe kërkohet kohë dhe punë e ngjeshur profesionale e mbështetur me investime të bollshme në periudhë të gjatë për evitimin e tyre.

6.1.4. Rëndësia e pyjeve

Përveq prodhimit të drurit pyjet kanë rëndësi për zhvillimin ekonomik dhe social të rajonit, por pyjet janë edhe burimi i vetëm për jetën dhe zhvillimin e shumicës së bimëve dhe shtazëve të egra. Roli i tyre mund të vlerësohet nga disa këndvështrime

- Si bazë të gjendjes së trashëguar dhe mundësive të përmbushjes së nevojave të shumëfishta aktuale ekologjike prodhuese dhe sociale, orjentimit dhe zhvillimit me qëllim të arritjes optimale të funksionit të pyjeve dhe produktivitetit të tyre.

- Si element kyq i ruajtjes dhe mbrojtjes së natyrës nga efektet e dëmshme të ndotjes në rritje
- Si burim i kushteve për jetë dhe vendstrehim i vetëm i jetës së shumë bimëve dhe shtazëve
- Si zonë kryesore e burimeve kryesore të ujit dhe krijimit të rezervave të ujit të pastër për jetën e njeriut
- Si element kryesor në ruajtjen e mjedisit nga temperaturat extreme dhe proqeseve erozive
- Si potencial i madhë i krijimit të kushteve për zhvillim dhe shumëzim të burimeve të dyta pyjore.

Këto dhe shumë funksione tjera përkundër aftësive vetërregulluese të pyellit nuk mund të arrihet pa ndërhyrjen artificiale të kujdeseshme të njeriut.

Gjithsesi se ndërhyrjet aktive të njeriut posaqërisht ato silvikulturale kanë rëndësin e arritjes së synimeve të përcaktuar të nevojave që duhet të plotësojnë bashkësite pyjore.

Ndërhyrjet mund të jenë të orjentuara në krijimin e bashkësive pyjore të llojit prodhues, mbrojtës ose estetiko rekreativ, ose pa ndonjë përcaktim të posaqëm thjeshtë janë të orjentuara në drejtim të krijimit të kushteve të zhvillimit të një pylli të shëndoshë të mirëmbajtur dhe i shumëllojshëm për përdorim të shumëfishtë.

Për arritjen e këtyre objektiva është i domosdoshëm ndërtimin i një politike menaxhuese afategjatë të menaxhimit të resurseve pyjore:

- Me përbërje dhe përzirje të specieve natyrore dhe të bashkësive pyjore që sigurojnë përmirësim të aftësive prodhuese dhe të ripërtritjes natyrore që krijojnë kushte të përshtatshme për ruajtje dhe zhvillim të llojeve të vlefshëm dhe të rrezikuar të florës dhe faunës dhe të shfrytëzueshmrisë së tyre.
- Me veti të mira mbrojtëse nga proqeset erozive, erërave të forta, mbrojtës nga zhurma pluhurit dhe roli i tyre pozitiv në rezervat dhe cilësinë e ujit të pastërt.
- Me veti të mira për zhvillimin e aktiviteteve rekreative, edukuese, argëtuese të turizmit dhe hulumtuese.
- Me veti që ruan dhe pozitivisht ndikon në përmirësimin e potencialit prodhues të tokave pyjore
- Me veti të krijimit të kushteve të favorshme për zhvillim dhe shumëzimin e produkteve të dyta jo drusore

Mungesa e ndërhyrjeve silvikulturale të lëna pas dore një kohë të gjatë në rrethana dhe qëllime të caktuara ka ndikuar dukshëm përveq tjerash edhe në gjendjen shëndetësore të llojet dhe bashkësitë e caktuara pyjore.

Kjo është vërtetuar në bazë të studimeve në pyjet e Kosovës të përfshirë në projektin ICP-programi ndërkombëtar për vlersimin dhe monitorimin e efekteve negative të ndotjes së ajrit në Pyje.

Të dhënat janë rrezultat i analizës në 333 sipërfaqeve experimentale të vendosura në rrjetin 4x4 km i ashtuqujtur Gaus-Krugerit. Rrezultatet e arritura në periudhen 1989-97 japin shifra shqetësuese si për halorët ashtu edhe për gjethoret. Sa për ilustrim Gështënja si lloji më i rrezikuar në Kosovë nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm të dëmshëm biotikë dhe abiotikë është i përfshir me dëmtime mesatare prej 74.42 %.

Në përgjithësi halorët me fazat e ndryshme të dëmtimeve janë të përfshier me 42.0 % kundrejt gjethorëve me gjithashtu nivel tejet të larte prej 28.95 %.

Mirëpo përkundër kësaj natyra në rastet më të vështira ka ndihmuar veten e prirë të luftojë për vetëegzistencën me ripërritjen natyrore të zonave të degraduara nga menaxhimi i pa kontrolluar.

Kjo dukshëm ka ndikuar në ruajtjen dhe mirëvajtjen e biodiversitetit natyror të shtrirjes së llojeve dhe bashkësive pyjore që dukshëm kontribuon edhe në stabilitetin ekologjik.

Në fakt këto kategori pyjesh të reja të regjeneruara nga natyra në rajon i hasim në faza të ndryshme të zhvillimit të cilat kanë nevojë të trajtimit silvikultural që në fazat e reja ti drejtojmë në krijimin e bashkësive pyjore për përmbushjen e funksioneve të caktuara dhe gjithëpërfshirëse.

6.2. Radhitja vertikale e bashkësive pyjore

Vegjetacioni pyjor në territorin e Alpeve Shqipëtare mund të vërehet qartë në profilin vertikal nëpër mes të disa brezave të cilët i ndërtojnë brezat e ekosistemeve me fitocenoza të përkatëse që janë karakteristike për këtë pjesë të Ballkanit. Në këta breza janë prezent edhe fitocenoza pyjore jobrezore.

Brezi i pyjeve të dushkut

Përfshinë pjesën e poshtme deri në 800 m. dhe përfshinë pyjet termofile të rrethës së Deqanit, Junikut dhe Lebushes.

Këto pyje në pjesën e poshtme të Alpeve Shqiptare si të vërteta dhe të ruajtura mirë janë të rralla dhe të lokalizuara .

Në mes të lartësisë mbidetare 640-810 m. bazen gjeologjike të tyre e përbëjnë shkëmbinjtë Aluvial, karbonatet etj. Mbulesa bimore sillet prej 90-100% ndërsa lartësia e edifikatorëve të brezit sillet prej 15-25 m.

Katin e drurëve e ndërtojnë llojet edifikatore si *Quercus cerris*, *Q. Petraea*, *Q. frainetto* por dallohen edhe *Fagus moesiaca*, *Sorbus torminalis*, *Tilia platophyllos* etj.

Katin e shkurreve e përbëjnë rreth 15 lloje e më të shpeshtat janë : *Carpinus betullus*, *Coryllus avellana*, *Roza canina*, *Acer tataricum*, *Evynomus europeus*.

Katin e bimëve barishtore e ndërtojnë llojet karakteristike për këto pyje ndër të cilat : *Heloborus odorus*, *Melica uniflora*, *Platanthera bifolia*, *Lathyrus niger*, *Festuca drymeia*, *Cardamine bulbifera*, *Carex sylvatika*.

Brezi i pyjeve të Ahut

Kati i pyjeve të Ahut është në vazhdim të atyre të dushkut dhe shtrihet në një lartësi mbidetare prej 900-1320 m. në të gjitha ekspozicionet me një mbulesë të përgjithshme pyjore prej 80-100 %.

Katin e drurëve në përgjithësi e përbënë ahu *Fagus moesiaca* e më rrallë haset edhe *Acer pseudoplatanus*.

Katin e drurëve të poshtëm e ndërtojnë : *Fraxinus ornus*, *Abies alba*, *Acer pseudoplatanus*, *Pinus heldrichii*.

Në katin e shkurreve hasen disa nga llojet e katit të poshtëm të drunjëve por edhe *Coryllus avellana*, *Acer hircanum*, *Hedera helix*, *Rubus hirtus* e cila tregon për procesin e degradimit

Katin e bimëve barishtore e përbëjnë 60 lloje bimore, e më të shpeshtat janë: *Cardamine bulbifera*, *Anemone nemorosa*, *Fragaria vesca*, *Melica uniflora*, *Trifolium pignanti*, *Lathyrus venetus* dhe *Heloborus odorus* etj.

Brezi i pyjeve të përziëra të dushkut dhe halorve

Shtrihet mbi katin e ahut në një lartësi mbidetare 1200-1540 m. Mbulesa pyjore është 80-100% ndërsa lartësia e katit drunor sillet prej 25-32 m.

Katin e drurëve e përbëjnë më së shpeshti ahu *Fagus moesiaca*, bredhi *Abies alba*, dhe hormoqi *Pinus abies* por edhe lloje të tjera. katin e drurëve të poshtëm e ndërtojnë : *Carpinus betulus*, katin e shkurreve e ndërtojnë : *Rubus ideaus*, *Vaccinium myrtillus*, *Fraxinus excelsior*, *Taxus baccata*.

Katin e bimëve barishtore e përbëjnë 75 lloje bimore në mesin e të cilave janë : *Cardamine bulbifera*, *Symphitum tuberosum*, *Euphorbia amugdaloides*, *Viola sylvestris*, *asperula odorata* etj.

Brezi i pyjeve të errëta halore

Karakterizohet me zvoglim të ngadalshëm të llojeve gjethore dhe dominim gradual të llojeve halore. Pyjet e errëta halore në numër më të vogël përbëhen nga bredhi si në katin e drunjëve po ashtu edhe të shkurreve.

Kjo përbërje shtrihet në 1750 m. Lartësi mbidetare ekspozicioni veriperendimor. Bazën gjeologjike e përbëjnë shkëmbinjtë e mermerit .mbulesa pyjore është rreth 80 % kurse lartësia e katit drunor sillet rreth 40 m. Me vjetërsi rreth 90 vjet.

Në katin e shkurreve përveq smrca gjenden edhe *Abies alba*, *Sambucus dracemosa*, *Daphne mesereum*. Kati i bimëve barishtore është mjaft i varfër dhe e përbëjnë gjithsejt 14 lloje. Pjesa tjetër e këtyre pyjeve me shtrirje shumë më të gjerë paraqesin pyjet me Pishë dhe Arnen *Piceo pinetum peuces* në një lartësi mbidetare prej 1460-1800 m. Mbulesa e vegjetacionit është nga 60-100 % ndërsa lartësia e tij është 25-45 m.

Baza e tyre gjeologjike është shkëmbore por edhe silikat. Katin e drurëve të lartë e përbëjnë : Hormoqi (*Picea abies*), molika (*Pinus peuce*), e më pakë bredhi (*Abies alba*), ahu (*Fagus moesiaca*), *Pinus heildreichi* etj.

Në katin e shkurreve ka pak lloje 9 ku më interesantë është *Pinus mugo* por edhe *Rubus ideus*, *Daphne mesereum*, *acer heildreichi*. Në katin e bimëve barishtore gjenden 56 lloje e ndër më kryesoret janë : *Luzula luzulina*, *veronica officinalis*, *Euphorbia amygdaloides*, *Anemone nemorosa*, *Oxalis acetosella*, *Fragaria vesca*, *Ajuga reptans*.

Brezi i pyjeve të rrobullit dhe Arnenit

Ky brez pyjor shtrihet në një lartësi prej 1850-1930 m. Në ekspozicionin juglindor, verilindor dhe veriperendimorë. Bazën gjeologjike e përbëjnë karbonatet, dollomitet etj. Mbulesa pyjore e tyre është prej 60-80 % me një lartësi të katit drunor prej 20-35 m.

Katin e drurëve të epërm e përbëjnë Molika *Pinus peuce* e shumë rrallë shfaqet edhe hormoqi *Picea abies*.

Katin e shkurreve e përbëjnë : *Juniperus nana*, *Pinus mugho*, *Daphne mesereum*, dhe *Sorbus aucuparia* si dhe boronica *Vaccinum myrtillus*.

Katin e bimëve barishtore e ndërtojnë 53 lloje bimore e më të shpeshta janë: *Luzula luzulina*, *veronica officinalis*, *potentilla aurea*, *Festuca heterophylla*, *Luzula nemorosa*, *Avellana flexoullusa*, *Aremonia agrimonioides*, *Homogyne alpina* etj.

Në këtë brez dallohen edhe pyjet me arnen *Pinus heldreichii* të cilët shtrihen në një lartësi mbidetare prej 1450-2000 m. Bazën gjeologjike e përbëjnë karbonatet.

Mbulesa e përgjithshme pyjore është 60-70 % ndërsa lartësia e katit drunor 15-25 m.

Katin drunor e ndërton arneni *Pinus heldreichii* por edhe *P. Peuce*. edifikator i katit të shkurreve është *Pinus mugho* por shfaqet edhe boronica *vaccinum myrtillus*. Katin e bimëve barishtore e

ndërtojnë 27 lloje e më të shpeshta janë :*Anemone nemorosa*, *hieracium murorum*, *Homogyne alpin*, *Dactylis hispanica*, *Helianthemum alpestre*, *Arctostaphylos uva – ursi* etj.

Brezi shkurre me *Pinus Mugo*

Ky brez shtrihet në lartësin mbidetare prej 1850-2050 m. Në të gjitha ekspozicionet. Bazën gjeologjike më së shpeshti e ndërtojnë karbonatet si dollomite, mermerë etj.

Mbulesa pyjore sillet prej 30-100 % me një lartësi 2.5 m. (në brezin me arnenin lartësia arrin deri 20 m.) . edifikator padyshim është lloji *Pinus mugho*.

Në katin e bimëve barishtore gjenden 55 lloje e më të shpeshtat janë :*Luzula sylvatica*, *Fragaria vesca*, *Valeriana montana*, *Hypericum alpigenum*, *Geranium sylvaticum*, *geum bullgaricum*, *Homogyne alpina*, *Gentiana asclepiadea*, *myosotis sylvatica* etj.

6.3. GJENDJA E TANISHME E PYJEVE DHE MASAT E PROPOZUARA

Për momentin në situatën e tanishme me rëndësi të veçantë është vendosja e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit të ndërsjell i të gjitha palëve të interesuara pa paragjykime të gjetjes së mënyrës së menaxhim gjithëpërfshirës optimal.

E gjithë kjo duke respektuar para së gjithash interesin kombëtar statusin ligjorë rëndësin ekonomike, ekologjike, përdorimin ambijental dhe interesin e fermerëve privat.

Me qellim të mbrojtjes përmirësimit të cilësisë stabilitetit dhe funksioneve gjithëpërfshirëse pavarësisht nga pronësia.

Të dhënat që posedojmë tani nuk sigurojnë as minimumin për të supozuar se cilla nga mënyrat e menaxhimit do të ishin optimale në përmbushjen e interesave gjithëpërfshirëse të shoqërisë Kosovare.

Në këtë situat nuk ka njeri që me të drejtë do të përcaktohet për përparësit e menaxhimit të rajonit si park nacional apo pyje prodhuese ekonomike me përdorim të shumëfishtë.

Në vend të kësajë për përcaktim duhet siguruar të dhëna të sakta nga inventarizimi i rajonit të resurseve pyjore. Me këto do të krijohet një bazë të të dhënave që siguron ndërtimin e një analize të përcaktimit të menaxhimit të ardhshëm të potencialit egzistues të flores dhe faunës.

E gjithë kjo duhet përcjell me aktivitete të: identifikimit të faktorëve të cilët rrezikojnë dhe mundë të rrezikojnë zhvillimin e shëndetshëm dhe përdorimin e shumëfishtë të pyjeve

- me përgaditjen e pikave të përbashkëta të pjesmarrësve për menaxhimin dhe përdorimin e shumëfishtë të pyjeve
- me përgaditjen e kriterëve për identifikimin dhe kategorizimin e pyjeve dhe bashkësive pyjore prodhuese, mbrojtëse, zonave të mbrojtura të kategorive të ndryshme dhe pyjeve me funksione të veçanta.
- me identifikimin e zonave me rëndësi të veçantë të florës dhe faunës dhe llojeve të rrezikuara dhe endemike për rajonin florën dhe faunen në tërësi.

LITERATURA

1. Grup autorësh (1985): *Studim mbi arsyeshmërinë e shpalljes së një pjese të Bjeshkëve të Nemuna në Komunën e Pejës për Park Nacional*, Enti Krahinor për Mbrojtjen e Natyrës, Prishtinë.
2. Grup autorësh (1975): *Lovni rezervati na "Prokletijama"* Enti për mbrojtjen e Natyrës, Prishtinë.
3. Grup autorësh (1984): *Arsyeshmëria Shoqërore për shpalljen e grykës së Rugovës si Përmendore të Natyrës*, Enti për mbrojtjen e Natyrës, Prishtinë.
4. Jankovic, M. M. et al. (1997): *Prokletije – Nacionalni Park*, ZZPS, Beograd.
5. Millaku, F. (1993): *Flora Planine Maja Rusolija*, Magistarski rad, Sveuceliste u Zagrebu, Zagreb.

6. **Millaku, F.** (1999): *Flora subalpike dhe alpike e Alpeve Shqiptare (Kosovë)*, Disertacion i doktoraturës, Universiteti i Prishtinës, Prishtinë.
7. **Muratagiq, M.** (1975): *Kontribut njohjes së përhapjes dhe kushteve ekologjike të Forsitisë evropiane (Forsythia europaea Deg. et Bald.) në Bjeshkët e Nemuna*, Enti Krahinor Për Mbrojtjen e Natyrës, Prishtinë.
8. **Muratagiq, M.** (1975): *Prokletije, staniste endemicnih i reliktnih vrsta biljnog sveta*, Enti Krahinor Për Mbrojtjen e Natyrës, Prishtinë.
9. **Rexhepi, F.** (1986): *Flora e maleve të larta të Kosovës*, ETMMK, Prishtinë.
10. **Rexhepi, F.** (1994): *Vegjetacioni i Kosovës (1)*, FSHMN, Prishtinë.
11. **Zeneli, L.** (1975): *Endemitët e ballkanit në florën e Bjeshkëve të Nemuna*, Enti Krahinor Për Mbrojtjen e Natyrës, Prishtinë.
12. **Ligji për mbrojtjen e Mjedisit** (2003), regullorja nr. 2003/9, Prishtinë
13. **Ligji mbi mbrojtjen e vlerave natyrore dhe vlerave të krijuara me punë të ambientit të njeriut** (1988) (“GZK” 39/88)